

1 E hënë, 27 mars 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e  
6 Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të  
8 nderuar Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori  
9 i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi gati që  
12 të vijojmë me dëshminë e Dëshmitarit W04147.

13 Le të mos ta thërrasim si fillim dëshmitarin.

14 Z. Ellis, do t'i kaloj fjalën Sekretares së seancës që të  
15 na flasë për disa nga provat materiale të ditës së djeshme.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të  
17 nderuar Gjykatës. Së pari, dje Mbrojtja e z. Krasniqi dorëzoi  
18 dy faqe nga DJK00751 deri në DJK00763. Këto faqe janë DJK00755  
19 dhe DJK00756 dhe do t'u jepet numri i provës materiale 4D43,  
20 së bashku me përkthimet në anglisht.

21 Ndërsa çështja e dytë, të nderuar Gjykatës, ka të bëjë me  
22 faktin që dje, në orën 11.20, Prokurori i ka dërguar një email  
23 të gjithëve në lidhje me provën materiale P93. Dhe vendimi i  
24 Gjykatës ishte që transkripti i P93 të shtohet dhe të  
25 zëvendësohet. Ndaj për këtë arsye dëshirojmë që t'i

1 përcaktojmë numra procesverbalit.

2 Pra, është transkripti me numrin ERN 01427-12-TR i  
3 Rishikuar 2 do të marrë numrin prova materiale P93 dhe  
4 gjithashtu prova materiale P93-TR.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
6 çaktivizuar]

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Më falni është 80,  
8 sepse kjo ishte gjuhën shqipe, është versioni i gjuhës shqipe  
9 i transkriptit. Ndërsa për anglishten 061427-12-TR i Rishikuar  
10 2-ET do të jetë prova materiale P93\_ET.

11 Dhe më pas 061427-12-TR i Rishikuar 2-ST do të jetë prova  
12 materiale P93\_SRP.

13 Faleminderit, të nderuar Gjykatës, për mundësinë që t'i  
14 sqaronim këto gjëra.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë këto  
16 tre prova materiale pranohen tashmë me numrat përkatës.

17 Po, mund të vijojmë.

18 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kam unë dhe një çështje  
19 logjistike për të folur. Sepse dje Mbrojtja e z. Veseli ka  
20 shtuar një video në prezantimet që ne kemi. Dhe nga  
21 përshkrimet, ne kuptuam që videoja ishte regjistruar në prill  
22 1999. Po kemi vështirësi që të kuptonim, pra, sesi dëshmitari  
23 mund të komentonte në mënyrë të konsiderueshme në lidhje me  
24 këtë çështje dhe në dëshminë e vet të mëparshme sepse tha që  
25 nuk e kishte parë z. Veseli në qershor 1999.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 3

1 Pra, kam dy pyetje. E para do të jetë se ndoshta do të  
2 ishte mirë, që të mos ndërprisnim në fakt edhe videon.

3 Dhe, e dyta, që në rast se videoja do të shfaqet dhe do  
4 të ketë pyetje në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit,  
5 atëherë do të donim që ju, i nderuar Gjykatës, të sqaronin në  
6 mënyrë të qartë, pra, që kjo të bëhet përpara shfaqjes së  
7 videos dhe në mungesë të dëshmitarit. Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Ka ndonjë gjë tjetër?

10 Në rregull atëherë. E nderuar Asistente ju lutem sillni  
11 në sallë dëshmitarin.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,  
15 z. Byrnes.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të vijojmë  
18 me dëshminë tuaj me kundërpjetet nga Mbrojtja e z. Krasniqi.  
19 Dhe tashmë fjala për z. Ellis.

20 Z. Ellis, fjala për ju.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.

22 DËSHMITARI: SHAUN BYRNES [Vijon]

23 Pyetje të palës tjetër nga Z. Ellis: [Vazhdim]

24 Z. ELLIS: [Përkthim]

25 PY. Mirëmëngjesi, z. Byrnes.

1 PË. Mirëmëngjesi.

2 PY. Thjesht që të dini edhe ju sesi do të shkoj puna sot. Ka  
3 më pak se gjysëm ore kohë në dispozicion për t'ju bërë pyetje.

4 Dje përfunduar ditën duke parë një dokument me numrin  
5 P00864, që ishin shënimet të OSBE-së për një takim në datën 23  
6 janar për lirimin e pesë civilëve të moshuar serb nga Likovci.  
7 Është e qartë nga ky dokument që lirimi i tyre ka ndodhur në  
8 23 janar, apo jo?

9 PË. Ashtu është.

10 PY. Dhe nuk ka asgjë në atë dokument që të sugjerojë që  
11 komandanti vendas nuk kishte dëshirë t'i lironte ata pesë  
12 serb, apo jo? Kështu e kuptojmë nga ajo që pamë?

13 PË. Nuk e kam dokumentin këtu përpara.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Është dokumenti P00864, ju lutem.

15 PY. Dhe në fakt dua që të shikojmë faqen e dytë të këtij  
16 dokumenti dhe paragrafin e dytë në këtë faqe. Këtu raportohet  
17 që komandanti i UÇK-së ka premtuar që do të liroheshin të  
18 burgosurit dhe, në fakt, mund të ishin liruar edhe një ditë më  
19 parë po që ai dëshironte që ata të liroheshin së bashku me  
20 OSBE-në.

21 Kështu thuhet, apo jo?

22 PË. Unë nuk e mendoj që kam qenë i pranishëm kur ka ndodhur  
23 kjo ngjarje.

24 PY. Dhe këtu në këtë dokument nuk thuhet që përmendet gjë z.  
25 Jakup Krasniqi apo Shtabi i Përgjithshëm?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 5

1 PË. Edhe një herë?

2 PY. Jakup Krasniqi ose Shtabi i Përgjithshëm apo ndokush nga  
3 Shtabi i Përgjithshëm?

4 PË. E kam lexuar dhe jam dakord me të.

5 PY. A do të ishte e saktë që përpara se të ktheheshin nëntë  
6 ushtarët e UÇK-së, ju morët në telefon z. Krasniqi për ta  
7 pyetur se ku duhet të ndodhte, të bëhej, pra, dorëzimi i tyre?

8 PË. Nuk e mbaj mend.

9 PY. E mbani mend që e keni pyetur z. Krasniqi për një vend në  
10 Likovc?

11 PË. Nuk e mbaj mend.

12 PY. A e patë sesi arriti z. Krasniqi atë ditë në Likovc?

13 PË. Jo, nuk e mbaj mend.

14 PY. Keni qenë i pranishëm kur u bënë deklarata të shkurtra me  
15 ata nëntë luftëtarët aty dhe me persona nga media atë ditë?

16 PË. Ajo që mund t'ju them, zotëri, është që unë kam qenë i  
17 pranishëm. Mbj mend që i kam përshëndetur të burgosurit. Mbj  
18 mend që media ka qenë e pranishme. Megjithatë, nuk mbaj mend  
19 që janë bërë deklarata, megjithatë bëhet fjalë për një ngjarje  
20 përpara 25 vitesh.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të vendosim në ekran  
22 dokumentin 007893, i cili është pranuar si provë me numrin  
23 P00515\_ET.16. Dhe nëse mund të kalojmë tek pjesa e poshtme e  
24 faqes. Thjesht po ju jepja pak kohë që ta shihnit këtë  
25 dokument, në fakt, vazhdon edhe tek faqja tjetër.

1 A e mbani mend që z. Krasniqi ka bërë këtë deklaratë me  
2 rastin e lirimit të të burgosurve?

3 PË. Jo, nuk e mbaj mend.

4 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Po të shikojmë datën në  
5 fakt, në fillim të faqes, si datë është çorientuese.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Nëse mund të shkojmë tek pjesa e  
7 poshtme.

8 PY. E mbani mend që z. Krasniqi ka dhënë deklaratë në Drenicë  
9 kur ndodhi ajo ngjarje, pra, kur u kthyen këto nëntë ushtarë?

10 PË. Jo, vërtetë nuk e mbaj mend.

11 PY. Ajo që mund t'ju them është që ajo që ka ndodhur është që  
12 z. Krasniqi e kanë çuar në Likovc, bëri deklaratën dhe ai u  
13 largua. Kjo ka qenë përfshirja e tij atë ditë?

14 PË. Çfarë ka qenë?

15 PY. Përfshirja e tij atë ditë.

16 E pashë që juve tundët kokën në miratim, jeni dakord, apo  
17 jo?

18 PË. Thjesht nuk e mbaj mend. Është e logjikshme kjo që thoni,  
19 po nuk e mbaj mend.

20 PY. Pra, është e mundur thjesht që ju nuk e mbani mend?

21 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kundërshtoj. Sepse është  
22 bërë kjo pyetje dhe është përgjigjur.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ai tha që nuk  
24 e mbante mend. Tha që është e mundur. Ndoshta ishte gabim nga  
25 ana juaj.

1 PY. Po. Në fakt, ishte gabim nga ana ime. Se po lodhem më  
2 shpejt se dëshmitari dhe të gjithë të tjerët në sallë me  
3 ç'duket.

4 PY. Pra, unë them që z. Krasniqi nuk e dinte për ndalimin e  
5 pesë civilëve serbë dhe nuk ishte ai që kishte urdhëruar z.  
6 Lushtaku që t'i linin ata të largoheshin atë ditë, në rast se  
7 i ka thënë dikush atij për ta bërë këtë gjë. Këtë po ju them  
8 juve, zotëri.

9 Ndërsa në përgatitje të deklaratës tuaj dhe për dëshminë  
10 që keni dhënë këtë javë, ju keni kaluar një sërë kablllogramesh  
11 të asaj kohe, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Nuk u janë treguar ndonjë kablllograme që tregonte për  
14 lirim të pesë civilëve serbë, apo jo?

15 PË. Për këtë ngjarje në veçanti?

16 PË. Po.

17 PË. Nuk e mbaj mend.

18 PY. Ju kanë treguar disa shkrime të z. Krasniqi dhe  
19 projeklibrat nga Prokuroria të z. Krasniqi, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe asnjë nga këto shkrime apo projeklibra nuk i  
22 referohen pesë serbëve të moshuar, apo jo?

23 PË. Me ç'mbaj mend nga leximi, ashtu është, keni të drejtë.

24 PY. Pra, ajo që po them unë është që nuk ka gjë në ato  
25 shkrime sepse nuk ka qenë i përfshirë z. Krasniqi në atë

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 8

1 ngjarje. A mund të jetë e saktë kjo?

2 PË. Po.

3 PY. Do të kaloj tani tek një çështje tjetër, temë tjetër.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të shfaqim në ekran

5 dokumentin P01069, ju lutem? A mund të kalojmë tek paragrafi

6 20 i faqes 075344?

7 PY. Ky është një nga kabllogramet tuaja në atë kohë dhe

8 identifikon faktin që UÇK-ja ka boshllëqe të mëdhaja

9 informacioni, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe në veçanti fakti ishte që ato kishin shumë pak

12 mundësi për të parë televizor apo për të lexuar gazeta, apo

13 jo?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe ju thoni që tek shumë udhëheqës të UÇK-së kishte

16 padituri për çështjet që po ndodhnin nëpër botë apo çfarë po

17 ndodhte në Prishtinë apo gjetkë në Kosovë. Këtë keni vënë re

18 përpara momentin, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, vlerësimi juaj ishte që kishte mungesë të rëndë

21 informacioni dhe që kjo pengonte mundësinë e udhëheqjes së

22 UÇK-së dhe siç vazhdohet në faqen tjetër edhe mundësinë e tyre

23 për të reaguar siç duhet në mjedisin politik, pra, kjo po i

24 pengonte ato?

25 PË. Po ky ishte vlerësimi im. Nëse ishte i saktë apo jo, nuk



1 e di. Por më lejoni të them edhe diçka tjetër, nëse mundem?

2 PY. Sigurisht.

3 PY. Për arsye të këtij vlerësimi, vlerësimet tonë, KDOM-i  
4 krijoi një praktikë që kurdoherë që një nga anëtarët tanë të  
5 ekipit tonë shkonte në Beograd apo në Shkup për atë pushim që  
6 mund të bënin ose për të bërë raportimet përkatëse sepse ne  
7 nuk kishim informacion të klasifikuar, atëherë zakonisht ata  
8 do të blinin, për shembull, do të blinin një gazetë, për  
9 shembull, ndërkombëtare tek hoteli, për shembull, ku rrinin  
10 dhe zakonisht mund të ishte një gazetë nga Gjermania dhe e  
11 sillnin me vete në Kosovë. Dhe ne ia dërgonim, ia jepnim  
12 udhëheqjes së UÇK-së, i jepnim këto gazeta. Në fakt, kjo nuk  
13 na u kërkua prej tyre, por ishte e qartë që ata e vlerësonin.  
14 Ishte një përpjekje nga ana jonë që të mbyllnim këtë hendekun  
15 në informacion.

16 PY. Pra, ju menduat që kjo ishte e dobishme sepse ata nuk  
17 kishin qasje në informacion nga ndonjë gjë tjetër?

18 PË. Po. Nuk është se ma kërkoi njeri në Uashington për ta  
19 bërë këtë gjë. Thjesht menduam që ta bënim.

20 PY. Në rastin e UÇK-së do të ishte e gabuar që të prezumonim  
21 që dikush tek Shtabi i Përgjithshëm apo në zonë apo në brigadë  
22 po bënte këtë gjë?

23 PË. Edhe një herë pyetjen, ju lutem?

24 PY. Pyetja është që ne nuk mund të prezumojmë që një person  
25 tjetër në Shtabin e Përgjithshëm do ta dinte që dikush në

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 10

1 brigadë apo në zonë kishte bërë diçka tjetër në Kosovë?

2 PË. Është një pyetje e vështirë kjo. Unë nuk isha në Shtabin  
3 e Përgjithshëm vetë.

4 PY. Në rregull. A mund t'u tregoj edhe një kabllogram tjetër,  
5 ju lutem?

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Ka numrin P01068. Paragrafi 18, në  
7 faqen 116698.

8 PY. Keni pasur mundësinë ta shihni këtë?

9 PË. Cili ishte numri i paragrafit?

10 PY. 18.

11 PË. E lexova.

12 PY. Për kontekst, ky është një kabllogram që është bërë pas  
13 lirimit të aktivistit të UÇK-së dhe gazetarëve të Tanjug-ut.

14 Z. Bashota ishte një person që ju keni thënë keni pasur  
15 marrëdhënie të mirë me të, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe ju e keni pyetur nëse UÇK-ja po mbante edhe persona  
18 të tjerë të rrëmbyer, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe me ç'dini ju, përgjigja e tij ishte që me ç'dinte ai  
21 UÇK-ja nuk po mbante pengje të tjerë po që do ta kontrollonte  
22 këtë gjë, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe ka patur raste kur ju e keni pyetur z. Bashota për  
25 ndonjë gjë dhe ai nuk e ka patur informacionin, ka thënë do të

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 11

1 largohem, do ta marrë vesh dhe do t'ju kthej përgjigje, apo  
2 jo?

3 PË. Po, ashtu është.

4 PY. Po sigurisht ajo që nuk e dinit ju është që ai duhet të  
5 shkonte pastaj dhe ta merrte këtë informacion pas bisedave që  
6 kishte bërë ju dhe t'jua jepte juve atë, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. A mund të kalojmë tani tek dëshmia juaj, tek deklarata me  
9 numrin P01066 në paragrafin 121 të saj?

10 Keni patur mundësinë ta lexoni?

11 PË. Po.

12 PY. A është e vërtetë, e saktë që në rastin e këtij gazetari  
13 serb në gusht të 1998, me ç'dini ju, ende nuk është zgjidhur  
14 kjo çështje, apo jo?

15 PË. Ashtu është.

16 PY. Këtu nuk identifikohet ndonjë takim specifik në të cilin  
17 ju thoni e keni ngritur këtë çështje me trojkën, apo jo?

18 PË. Po, ashtu është. Por më lejoni të shtoj, që unë kam folur  
19 për këtë çështje me trojkën shumë herë.

20 PY. E shikojmë në deklaratën tuaj që kur një çështje është  
21 ngritur, është folur me trojkën, mund të ketë qenë në ndonjë  
22 ditë të veçantë ose mund të ketë qenë me thirrje telefonike,  
23 apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe ju keni patur kontakt telefonik me z. Bashota, me z.

1 Buja, por edhe me z. Krasniqi, apo jo? Me të tre këta në raste  
2 të ndryshme?

3 PË. Kryesisht me z. Bashota, po.

4 PY. Dhe kur kishte takim me trojkën me të gjithë të  
5 pranishmit, besoj që do të prisnim që kjo gjë të ishte e  
6 pasqyruar në ditar, po dhe në ndonjë kabllogram duke bërë një  
7 përmbledhje të atij takimi, apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Ju përmendët të hënën në mëngjes për një pyetje që ju bë  
10 nga Prokuroria që ju menduat që në Likovc keni parë një ose dy  
11 të burgosur serb në pranverën e 1998. E mbani mend që e keni  
12 thënë këtë?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe në dëshminë tuaj ju më duket keni thënë që trojka  
15 mund të ketë qenë aty sepse kanë vajtur në Likovc për një  
16 takim të rëndësishëm. E mbani mend që e keni thënë këtë?

17 PË. Po.

18 PY. Po ama nuk është se e mbani mend në mënyrë specifike se  
19 kush ishte aty nga UÇK-ja atë ditë. Do të ishte e saktë ta  
20 thosha këtë në këtë formë?

21 PË. Në fakt kështu, në këtë moment nuk është se e mbaj mend  
22 se çfarë kam pasur të shkruajtur në ditarin tim.

23 PY. Po në rast se do të kishte pasur takim me trojkën në  
24 ditarin tuaj besoj do të ishte pasqyruar, apo jo?

25 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kundërshtoj. Sepse u bë kjo

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 13

1 pyetje dhe u përgjigj.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

3 Kundërshtohet.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Në fakt, kryesisht, po, kjo ishte  
5 praktika që ndiqja.

6 Z. ELLIS: [Përkthim]

7 PY. Dhe, në fakt, arsyeja sepse e bëj këtë pyetje është se  
8 nuk shikoj një të tillë të një takimi me trojkën në Likovc në  
9 gusht të 1998? Prandaj po ju pyes që mund të ketë qenë dikush  
10 tjetër në atë takim?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe është e vërtetë që ju ndenjët në kontakt me z.  
13 Krasniqi edhe pas konfliktit, apo jo, pasi përfundoi  
14 konflikti?

15 PË. Po, së bashku me disa anëtarë të tjerë të UÇK-së.

16 PY. A është e vërtetë që ju jeni takuar me familjen e z.  
17 Krasniqi?

18 PË. Po, është e saktë.

19 PY. Në marrëdhënien tuaj dhe në bisedat me z. Krasniqi, ju  
20 keni menduar që ai ishte dikush, një person i arsyeshëm dhe  
21 tek i cili kishit besim, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Ju nuk mendonit që ai ka qenë një person që është  
24 përfshirë në vepra penale, në krime, apo jo?

25 PË. Jo, nuk kam menduar që ai është një person që është i

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 14

1 përfshirë në krime.

2 PY. Faleminderit.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kam asgjë tjetër për të pas  
4 pyetje tjetër.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
6 z. Ellis.

7 Z. Emmerson.

8 Dëshmitar, z. Emmerson është Mbrojtja e z. Veseli dhe ai  
9 tashmë do t'ju bëj disa pyetje në lidhje me këto çështje.

10 Pyetje të palës tjetër nga Z. Emmerson:

11 Z. EMMERSON: [Përkthim]

12 PY. Z. Byrnes, ashtu siç sapo ju thanë, unë quhen z.  
13 Emmerson.

14 PË. Ju lutem --

15 PY. Nuk më dëgjoni?

16 PË. Po, nuk ju dëgjoj fort mirë.

17 PY. Atëherë ndoshta duhet të ndryshojë mikrofonin. Po tani më  
18 dëgjoni?

19 PË. Po, ju dëgjojmë.

20 PY. Ashtu, siç sapo ju kanë thënë, unë quhem Emmerson dhe  
21 përfaqësoj Kadri Veselin në Gjykatë. Dhe dëshiroj t'ju bëj  
22 disa pyetje në lidhje me njohuritë që ju keni ose sa njohuri  
23 keni në lidhje me z. Veseli, së pari.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të shfaqim në ekran --  
25 kemi një dokument që është në dokumentet që dëshirojmë të

1 japim ne. Me numrin 116181 deri në 116182. Nuk është pranuar  
2 ende si dokument.

3 PY. Këto janë shënime të një telefonate që është bërë në  
4 datën 13 tetor vjet, 2023, telefonatë ndërmjet z.  
5 Ferdinandusse dhe ju, ka qenë në lidhje me faktin që  
6 Prokuroria do t'ju bënte disa pyetje.

7 Dhe prandaj nëse mund të përqendrohemi, ju lutem, te  
8 paragrafi 3 i këtyre shënimeve të mbajtura. Shikojmë këtu që  
9 z. Ferdinandusse ju ka informuar ju, ky është numri juaj, ka  
10 qenë numri juaj në atë moment, që ishte kërkuar, vendosur në  
11 fakt nga Gjykata që t'ju bënte një pyetje. Dhe e shikojmë në  
12 fjalinë e dytë që ju pyeti nëse ju "kishit njohuri personale  
13 të aktiviteteve të jashtme të zbulimit, inteligjencës së z.  
14 Kadri Veseli ndërmjet nëntorit 1998 dhe fundit të luftës" dhe  
15 përgjigja juaj ka qenë që "jo nuk kishit njohuri".

16 Kështu që unë nuk është se do t'ju pyes me hollësi për  
17 njohuritë që keni ju për aktivitetet e jashtme të zbulimit, të  
18 inteligjencës, pra, të z. Veseli por në lidhje me gjërat që ju  
19 mund të na tregoni. Pra, së pari a e keni kuptuar pyetjen se  
20 çfarë do të thotë aktivitete të jashtme të inteligjencës ose  
21 aktivitete jashtë Kosovës që kanë të bëjnë me shërbimet e  
22 tjera inteligjente, të vendeve të tjera? E kuptuat që kjo  
23 ishte pyetje që ju bë juve?

24 PË. Në fakt nuk është se e kuptova në mënyrë të veçantë se  
25 çfarë i referohej Prokurori në atë kohë. Po, po ka kuptim kjo

1 gjë, është e logjikshme.

2 PY. Kur thoni që nuk e dinit, nuk e kuptuat?

3 PË. Unë e kuptova që do të thoshte mbledhje e informacionit  
4 të inteligjencës nga vendndodhja e tij në Shqipëri.

5 PY. Mbledhja e informacionit të inteligjencës jashtë Kosovës,  
6 jo ndërveprimi me agjenci të tjera të inteligjencës?

7 PË. Po.

8 PY. Kështu që a ju pyetën juve nëse roli i z. Veseli ka qenë  
9 edhe ndërveprimi me agjenci të tjera të inteligjencës në vende  
10 të tjera? A u bë kjo pyetje?

11 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kundërshtoj, i nderuar  
12 Gjykatës. Sepse është e qartë që shënimi, tepër qartë,  
13 pasqyron atë udhëzim që u dha nga ju, vendimi 1847 me anën e  
14 të cilit u krijua dhe një procedurë në lidhje me -- edhe një  
15 qëndrim që do të mbahej potencialisht që do të ishte i  
16 nevojshëm sipas rregullit 107 dhe unë do ta lexoj tani  
17 pikërisht atë që u tha që:

18 "I jepet urdhër ZPS-së që: Të pyesë sa më shpjet që të  
19 jetë e mundur dëshmitarin në lidhje me njohuritë që ai ka për  
20 aktivitetet e jashtme të inteligjencës të z. Veseli ndërmjet  
21 nëntorit 1998 dhe fundit të luftës dhe, në rast se do të jetë  
22 kështu, të verifikohet sipas rregullit 107 nëse kjo çështje  
23 është në fushëveprimin e çështjeve lidhur me dëshmitarin dhe  
24 cilin dëshmitar është autorizuar që të dëshmojë."

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Sigurisht, i nderuar Gjykatës, që



Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 17

1 kjo gjë është thënë edhe më përpara dhe unë nuk po i  
2 kundërvihem rregullit 107, thjesht po përpigem të shikoj nëse  
3 dëshmitari e ka kuptuar pyetjen në lidhje me atë urdhër që  
4 keni dhënë ju. Pra, jo thjesht nëse z. Veseli gjendej jashtë  
5 vendit por nëse është kuptuar që kishte të bënte me agjencitë  
6 e tjera.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po dalim pak  
8 nga kuadri i pyetjeve që kemi kërkuar të jenë në shënim. Unë  
9 për momentin po e pranoj kundërshtimin. Po ju mund ta bëni dhe  
10 një herë pyetjen. Dhe ta fokusoni pyetjen tuaj lidhur me atë  
11 që është thënë në shënim.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Që të jemi të qartë, është fjala  
13 "aktivitete të jashtme të inteligjencës", "e jashtme" është  
14 problemi për mua, mbase duhet të sqarojmë a e ka kuptuar  
15 dëshmitari çfarë ka dashur të thotë Prokurori me fjalën e  
16 jashtme.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
18 Mund të bëni disa pyetje lidhur me këtë, po jo pyetjen tamam.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ta sqaroj unë këtë pyetje  
20 atëherë.

21 PY. Para një çasti thatë që nuk e keni kuptuar se çfarë ju  
22 kanë pyetur. Atëherë t'i kthehemi një përgjigjeni që keni  
23 thënë pak më përpara.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, a  
25 mund ta pyesni se çfarë ka kuptuar ai.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitar, çfarë mendoni se kuptuat ju me pyetjen a keni  
3 dijeni personale lidhur me veprimtaritë e jashtme të  
4 inteligjencës së Kadri Veselit nga nëntori i 1998 deri në fund  
5 të luftës? Çfarë mendoni se pyetje ju bënë?

6 PË. Nëse po mblidhte informacion inteligjence në Shqipëri, më  
7 thanë që punonte atje lidhur me veprimtaritë serbe kundër UÇK-  
8 së.

9 Më lejoni ama të shtoj diçka më shumë. Unë nuk e kam  
10 njohur z. Veseli. As nuk e kam takuar ndonjëherë. Dhe si fakt  
11 as nuk e kam idenë se çfarë bënte. Ishin përhapur fjalë që ai  
12 ishte i përfshirë në veprimtari zbulimi apo inteligjence. Po  
13 përveç kësaj -- më lejoni pak të konsultohem.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
15 prisni një çast.

16 Besoj, Emmerson, se e dha përgjigjen e asaj që ka kuptuar  
17 ai dhe mendoj se duhet të kaloni tek pyetjet e tuaja të  
18 radhës.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull atëherë.

20 PY. Sa i takon një përgjigje që i dhatë z. Ellis sot  
21 paradite, ju thatë, besoj se ju thatë, lidhur me arsyet pse  
22 mund të keni qenë në Shkup, ju thatë, besoj se thatë, ju thatë  
23 "ne", domethënë, KDOM-i, "nuk kishim informacione të  
24 klasifikuara", kështu?

25 PË. Nuk kishim informacione, nuk mbanim informacione të

1 klasifikuara gjatë kohës që ishim në Prishtinë. Ama në Shkup  
2 mund të përdornim ambasadën dhe atje ishim në gjendje të  
3 mbanim informacione të klasifikuara që gjeneronim ne vetë.  
4 PY. Në rregull. Vazhdojmë. Në paragraf thuhet se ju keni  
5 thënë që s'e keni takuar asnjëherë z. Veseli deri në momentin  
6 që erdhi NATO-ja në Kosovë në qershor të 1999 dhe do flas dhe  
7 për rrethanat e këtij takimi.

8 Më tej thoni se ju, ne, ne thoni ju, e kam dëgjuar emrin  
9 e Veselit disa herë dhe se gjithashtu keni thënë se në vitet  
10 pasuese keni biseduar me personat e UÇK-së kur keni qenë në  
11 Kosovë shpesh si anëtar i bordit të Universitetit Amerikan të  
12 Kosovës, në cilësinë e anëtarit të bordit domethënë. Dhe keni  
13 përmendur disa nga personat me të cilët keni biseduar gjatë  
14 kësaj kohe. Një prej të cilëve besoj se ka qenë Sokol Bashota?  
15 PË. Po.

16 PY. Dhe keni qenë të afërt?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe një prej tyre, sikurse konfirmuat, ishte z. Krasniqi,  
19 po ma merr mendja ka pasur dhe tjerë?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe ju vijuat -- kalon tek faqja tjetër. Thatë që keni  
22 dëgjuar që z. Veseli nuk ka qenë në Kosovë gjatë konfliktit,  
23 por në fakt ka qenë në Shqipëri, ndonëse ju nuk keni pasur  
24 njohuri të drejtpërdrejt në lidhje me këtë?

25 PË. Kështu është. A mund të shtoj diçka? Me sa më kujtohet

1 mua kur isha në detyrë, si përfaqësues i KDOM-it të SHBA-së,  
2 ne kishim dëgjuar, e kishim dëgjuar z. Veseli si emër. Ka qenë  
3 një person shumë misterioz sepse na kishin thënë ose të paktën  
4 kishte të dhëna, se ai ishte shumë i afërt me Hashim Thaçin  
5 dhe se kishin qenë shokë të ngushtë që në kohën që ishin  
6 studentë në Universitetin e Prishtinës në vitet 1990, në  
7 fillim të viteve 1990. Dhe se ai ishte një person shumë i  
8 respektuar në rangjet e UÇK-së. Po kaq. Askush nuk fliste për  
9 funksionet dhe përgjegjësitë e tij. Shpresoj se ju sqarova  
10 ndopak.

11 PY. Po, po. Dhe besoj se nuk është habi për ju të mësoni që  
12 ai ka qenë i përfshirë në shërbimet e inteligjencës?

13 PË. Po.

14 PY. Por ama mesa keni kuptuar ju, ai këto aktivitete po i  
15 kryente nga Shqipëria, kështu?

16 PË. Po, kështu.

17 PY. Sa i takon takimit të parë që keni pasur me të, po shoh  
18 disa nga deklaratat tuaja të mëparshme, a është e vërtetë që  
19 për herë të parë e keni takuar personalisht shkurtimisht pas  
20 ardhjes së KFOR-it, kështu?

21 PË. Po, kështu.

22 PY. Dhe besoj se e keni takuar në Prishtinë në një takim të  
23 madh, ku ka qenë dhe ambasadori Walker, gjenerali Mike  
24 Jackson, kreu i forcave të KFOR-it edhe figura të tjera të  
25 spikatura të UÇK-së?

1 PË. Po.

2 PY. Ju kur keni folur për këtë takim keni thënë që nuk ishit  
3 të sigurt a ka qenë i pranishëm z. Thaçi?

4 PË. Nuk më kujtohet.

5 PY. Por në këtë takim keni takuar dhe z. Veseli dhe ka qenë  
6 thjesht i keni dhënë dorën njëri-tjetrit shkurtimisht?

7 PË. Po. Me sa më kujtohet ai u afrua dhe u prezantua.

8 PY. Si u prezantua?

9 PË. Tha "Unë jam z. Veseli".

10 PY. Nuk shpjegoi ndonjë rol, nuk e shpjegoi se çfarë roli  
11 kishte?

12 PË. Nuk më kujtohet, po nuk ma merr mendja.

13 PY. Dua t'ju pyes lidhur m enjë përgjigje që i keni dhënë z.  
14 Misetic më 25, para disa ditësh domethënë.

15 Kjo është në faqen 13650 të transkriptit, këtë e themi  
16 për referencë, fillon në rreshtin 8, z. Misetic ju pyet,  
17 lidhur me një pjesë të kabllogrameve diplomatike:

18 "A është e vërtetë që kjo nënkupton që mënyra si e kishit  
19 kuptuar ju ka qenë kontakti me Uashingtonin që bëri të mundur  
20 këtë përpjekje për të krijuar një strukturë më vertikale të  
21 UÇK-së?"

22 Dhe ju u përgjigjët në rreshtin e 11:

23 "Fola dhe më herët lidhur me këtë temë kur bëra komentin  
24 në përgjigje të pyetjes suaj lidhur me Shtabin e Përgjithshëm  
25 që shërbente, pra, kishte kryer ndonjëherë dhe rolin e

1 ministrisë së jashtme të UÇK-së. Me sa kam kuptuar unë, ata  
2 siç thashë më herët, ata kishin vendosur në Zvicër të dërgonin  
3 sërish persona në Kosovë, përfshirë dhe personat si Hashim  
4 Thaçi, Kadri Veseli dhe të tjerë në mënyrë që këta persona të  
5 krijonin një shtab të përgjithshëm të UÇK-së dhe të  
6 përpiqeshin ta organizonin UÇK-në, e cila në atë kohë ishte  
7 thjesht një grup i milicisë rajonale, nëse mund të shprehemi  
8 kështu dhe të shërbenin, të merrnin rolin e udhëheqjes së UÇK-  
9 së të faktorit diplomatik, pra, të shërbenin si kjo pjesë e  
10 UÇK-së në mënyrë që të komunikonin me komunitetin  
11 ndërkombëtar".

12 Ju kujtohet kjo?

13 PË. Po.

14 PY. Keni përmendur dhe emrin e z. Veseli këtu. Pse e keni  
15 përshkruar z. Veseli atëherë si një person që ishte pjesë e  
16 asaj, që sipas jush, ishte "ministra e jashtme që duhej të  
17 komunikonte me ndërkombëtarët"? Mund të na ndihmoni pse e  
18 përshkruat në këtë mënyrë?

19 PË. Mesa kisha kuptuar unë ai ka qenë pjesë e këtij grupi,  
20 grupi i personave që punonin në diasporë kryesisht në Zvicër -  
21 Xhavit Haliti ishte një prej personave të tjerë edhe shumë të  
22 tjerë syresh - për të cilët udhëheqja e LPK-së kishte vendosur  
23 t'i rikthente në rajon në mënyrë që të shfrytëzonin këto  
24 mundësi dhe të krijonin një formë udhëheqjeje, udhëheqje  
25 politike, për të -- udhëheqja ndaj këtyre ndaj milicisë

1 rajonale.

2 Pra, kjo ishte në thelb analiza jonë.

3 PY. Po kjo është analiza e KDOM-it të SHBA-së?

4 PË. Po, e KDOM-it. Dhe ne besonim, ne përpiqeshim nga këta  
5 persona të pabindur, pra, nga kjo milici të krijonim një  
6 ushtri koherente, tamam një ushtri, që do të ishte në gjendje  
7 të kontrollohej po dhe të përfaqësohej prej tyre përpara  
8 komunitetit ndërkombëtar.

9 PY. Ushtri koherente?

10 PË. Po, ushtri koherente por edhe një forcë politike  
11 koherente.

12 PY. Në rregull. Duke marrë parasysh dëshminë tuaj në tërësi,  
13 a është e drejtë nëse do të thonim që, në fakt, asnjëherë s'u  
14 arrit kjo strukturë e unifikuar e një ushtrie?

15 PË. Po, ashtu është.

16 PY. A mund të themi që në fakt, ju mendonit që në thelb mbeti  
17 një grup personash të pabindur apo milici që drejtohej nga  
18 komandantë zonash të cilët kishin shumë pak kontroll nga  
19 Shtabi i Përgjithshëm?

20 PË. Po. Po do të shtoj diçka që në fakt është analiza ime që  
21 mund ta kem pasuruar me informacione që kam marrë pas luftës  
22 nga persona që dinin më shumë seç dija unë, persona të zonës  
23 që dinin më shumë nga s'dija unë.

24 Po i themi zonat e milicisë, po i referohem si zonat e  
25 milicisë unë këtyre, kishin marrëdhënie të ndryshme me shtabin

1 e UÇK-së qendrorin. Këto marrëdhënie vareshin nga burimet.  
2 Veçanërisht, më kanë thënë dhe disa prej kolegëve të mi ju  
3 kanë thënë komandantët e zonës, komandantët zonës si Ramush  
4 Haradinaj, Remi në zonën e Llapit, se ata kishin burimet e  
5 veta. Kishin vet kishin financim që u vine nga donatorë. Nuk e  
6 di kush ishin këta dhe nga ishin, po kishin dhe armë.

7 Në zonën e Llapit, veçanërisht Remi dhe zëvendësi i tij,  
8 Nuredin Ibishi na kanë thënë se ata i blinin armët nga një  
9 kolonel, biles në Nish. Disa nga zonat e tjera nuk kishin të  
10 njëjtat mundësi qoftë për shkak të vendndodhjes gjeografike o  
11 për shkak se s'kishin financim nga donatorët.

12 Pra, nëse mund të shprehem kështu zonat e pasura ishin më  
13 të pavarura dhe më të shkëputura nga Shtabi i Përgjithshëm.  
14 PY. Do të doja ta shihnim pak më në hollësi dhe ta marrim  
15 zonë për zonë. Por ajo që po përshkruani ju në vija të  
16 përgjithshme ju po thoni që funksioni i dyfishtë që mendonte  
17 se kishte ky grup, përfshirë këtu z. Veseli, që e përmendi me  
18 emër, këta persona pra, u dërguan në Kosovë në mënyrë që të  
19 krijonin një lloj strukture koordinuese qendrore?

20 PË. Po.

21 PY. Që ju thatë s'u arrit tamam asnjëherë dhe varej nga zona  
22 në zonë?

23 PË. Unë do thoja që deri në mars të 1999, të paktën, ngeli në  
24 punë e sipër kjo gjë.

25 PY. E keni fjalën në kohën kur filluan bombardimet?



1 PË. Po.

2 PY. Do t'i shohim pak zonat, të paktën disa prej zonave dhe  
3 problematikave që kanë pasur ato pas një çasti.

4 Një funksion tjetër, ju thoni, që kishte ky grup ishte të  
5 kishin marrëdhënie me komunitetin ndërkombëtar?

6 PË. Funksioni tjetër i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së? Po.

7 PË. Dhe një nga punët e tyre ishte të prezantonin UÇK-në, ta  
8 tregonin UÇK-në si një organizatë më të unifikuar, më të  
9 strukturuar dhe më të fortë seç ishte në realitet, apo jo?

10 PË. Po, po. Kështu ka qenë.

11 PY. Madje ekzagjeronin numrin e forcave që kishin nëse e  
12 krahasonin me vlerësimin që kishit bërë ju për të treguar që  
13 ishte më e fort UÇK-ja?

14 PË. Ky ishte gjykimi ynë.

15 PY. Dhe ata në dokumentacione shpreheshin se ishin më të  
16 strukturuar na ç'ishin në realitet?

17 PË. Po, ky ishte gjykimi ynë.

18 PY. Dhe ata krijuan përshtypjen e një strukture vertikale ku  
19 në të vërtetë një strukturë e tillë nuk ekzistonte?

20 PË. Po. Po unë thashë kjo ishte në zhvillim e sipër. Kjo  
21 ishte analiza ime dhe analiza që i kam bërë unë asaj kohe po i  
22 qëndroj edhe sot e kësaj dite është që ekzistonin disa  
23 elementë të strukturës vertikale, por nuk ishin të plota,  
24 absolutisht jo.

25 PY. Kur thoni "disa elemente". Ju thoni në disa vende

1 ekzistonin disa elemente?

2 PË. Po, në disa zona. Në disa zona kishin marrëdhënie më të  
3 ngushtë operative krahasuar me zona të tjera.

4 PY. Në kohën e bombardimit të NATO-s, ishte e rëndësishme  
5 sigurisht për UÇK-në, dhe besoj se pajtoheni me mua, që t'i  
6 bindin, ta bindin komunitetin ndërkombëtar se ishin një forcë  
7 koherente që ishe në gjendje të merrte mbështetje ushtarake po  
8 dhe mbështetje tjetër, kështu?

9 PË. Po, kështu. Po do të theksoj këtu edhe mbështetjen  
10 politike, sepse ata kishin aspirata politike, sidomos për  
11 periudhën pas luftës. Dhe këtë e kemi parë të pasqyruar dhe  
12 kjo s'dukej në bisedat në vazhdimësi që udhëheqja e UÇK-së  
13 kishte me ambasadorin Hill dhe ambasadorin Petritsch.

14 PY. Dhe, sigurisht, kjo lidhet dhe me faktin që dhe ato ishin  
15 një mbështetje politike për krijimin e një Kosove të pavarur?

16 PË. Absolutisht po.

17 PY. Atëherë, po fokusohem tek roli i jashtëm, marrëdhëniet me  
18 komunitetin ndërkombëtar, pra, nëse ju keni të drejtë dhe që  
19 z. Veseli ka pasur një rol në fushën e inteligjencës jashtë  
20 Kosovës, parimisht, çfarë mendoni se roli do të kishte ky  
21 person në raport me komunitetin ndërkombëtar nëse ky person do  
22 kishte një funksion në fushën e inteligjencës?

23 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kundërshtoj. Kjo kërkon  
24 spekulim.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet,

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 27

1 Dëshmitari mund të përgjigjet nëse e di.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk kam ndonjë njohuri konkrete,  
3 unë mund t'ju them --

4 Z. EMMERSON: [Përkthim]

5 PY. Një mendim tuajin?

6 PË. Unë ma merr mendja që z. Veseli, nëse ka pasur kontakte  
7 me organizatat e huaja të inteligjencës gjatë kohës që ka qenë  
8 në Shqipëri, atëherë u jepte informacione lidhur me zhvillimet  
9 në vend dhe me UÇK-në sepse këto organizata ishin të etura për  
10 informacion. Uashingtoni ishte i etur për informacion. Na  
11 kërkonte informacione. Edhe ka të ngjarë që ai këto  
12 informacione i merrte, mbase e merrnin informacionin prej tij,  
13 po unë këtë nuk e di.

14 PY. Faleminderit. Flasim për suksesin mund të themi, suksesin  
15 që kishin zonat e ndryshme për të qenë të pavarura apo  
16 dallimet që kishin një zonë nga tjetra.

17 Së pari, na keni përshkruar disa herë UÇK-në si një  
18 institucion me drejtim të dyfishtë, me dy kre, me dy drejtime.  
19 E keni përmendur në disa nga deklaratat tuaja, por do t'ju bëj  
20 disa pyetje që të nuancojmë pak realitetin.

21 PË. Sigurisht që po.

22 PY. Pikë së pari, ne e dimë që në shkurt, pati rebelim nga  
23 një grup komandantësh zonash kundër qëndrimit që mbajtën  
24 delegatët e UÇK-së në Rambuje?

25 PË. Po, kështu është.

1 PY. Dhe askush në delegacionin e UÇK-së nuk ishte komandant  
2 zone në atë kohë?

3 PË. Po.

4 PY. Ta bëj dhe një herë pyetjen, asnjë prej tyre nuk ka qenë  
5 komandant zone?

6 PË. Kështu më kujtohet dhe mua

7 PY. Ju na thatë se ky grup që u largua nga Kosova dhe ishte  
8 me ju në avion, kryesisht ju aty ishit për arsye sigurie?

9 PË. Po, kështu ka qenë.

10 PY. Z. Veseli, s'ka qenë një nga këta persona, apo jo?

11 PË. Jo.

12 PY. Po ai ka qenë në Rambuje sepse erdhi nga një vend tjetër?  
13 Nuk ka qenë pjesë e delegacionit, por ama atje ka qenë?

14 PË. Nuk më kujtohet.

15 PË. Do shohim një kabllogram ku shpreheni se ka qenë një  
16 këshilltar, një nga këshilltarët për delegacionin?

17 PË. Më lejoni të them këtë, unë kam qenë në Rambuje vetëm një  
18 ditë e gjysmë. Nuk më -- e kisha takuar -- unë nuk e kisha  
19 takuar ndonjëherë - më falni - dhe nuk më kujtohet ta kem parë  
20 atje. E vetmja gjë që unë mbaj mend është kur ministri i  
21 jashtëm francez, Vedrine, çeli procedurat, bëri një fjalim  
22 edhe u largua.

23 PY. Nuk po them që e keni takuar. Por në një nga kabllogramet  
24 tuaja te KDOM-it, ju keni thënë se ka qenë një nga  
25 këshilltarët por jo pjesë e delegacionit në Rambuje, çka do të

1 thotë se KDOM-i e kishte këtë informacion?

2 PË. Po nëse ka qenë në kabllogramet tona, atëherë i qëndroj.

3 Po ka qenë kabllogram nga ambasada në Paris, kjo?

4 PY. Jo, jo. Do ta shohim kabllogramin. Është e KDOM-it.

5 PË. Nuk më kujtohet.

6 PY. Që të kursejmë kohë, do t'i marrim sipas radhës, por

7 është në kabllogramin, data -- ja më jepni një çast ta gjej

8 datën. Kemi tre kabllograme dhe është i fundit. 10 mars 1998.

9 Pra, rezultati përfundimtar dhe do të doja të më

10 ndihmonit në lidhje me këtë, në kohën kur u prish konsensusi

11 apo s'pati konsensus e thënë ndryshe mes komandantëve të

12 zonave dhe atyre që ishin në Rambuje, ndër personat që

13 kundërshtuan dhe u tërhoqën autoritetin negociues delegacionit

14 dhe, më korrigjoni nëse e kam gabim, ka qenë Sulejman Selimi

15 një, që ka qenë në fakt ish-komandant zone i Drenicës dhe në

16 atë kohë ishte shefi i Shtabit të Përgjithshëm, kështu?

17 PË. Kush?

18 PY. Salejman Selimi.

19 PË. E keni fjalën që atëkohë ai u bë shef shtabi.

20 PY. Ai kishte qenë më përpara komandant zone i Drenicës.

21 PË. Po i Drenicës.

22 PY. Dhe u zëvendësua nga Sami Lushtaku?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe të dy këta persona e kundërshtuan kushtet e

25 marrëveshjes së Rambujesë?

1 PË. Po.

2 PY. Ramush Haradinaj komandant i zonës së Dukagjinit po ashtu  
3 e kundërshtoi?

4 PË. Që ç'ke me të.

5 PY. Dhe kjo ishte e rëndësishme sepse zona e Dukagjinit ka  
6 qenë afër zonës, afër maleve në zonën perëndimore të Kosovës  
7 dhe në këtë pjesë vinin armët nga Shqipëria dhe kalonin përmes  
8 zonës së Dukagjinit dhe në thelb ai ishte personi që mund të  
9 kontrollonte dhe të shpërndante armët në zona të ndryshme të  
10 UÇK-së? Shoh që pohoni me kokë, por duhet ta thoi me zë për  
11 procesverbal.

12 PË. E the shumë bukur.

13 PY. Pra, zona e Haradinaj që ishte në male përmes të cilës  
14 kondrabortoheshin armët, ishte zona nga më të rëndësishmet.  
15 Çka do të do të thotë në qoftë se ai nuk donte që të kalonin  
16 armët diku tjetër, ato armë nuk kalonin diku tjetër?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe ju e dini që ai ju jepte armë atyre zonave që  
19 mendonte se ishin të shkëputura nga Shtabi Përgjithshëm, siç  
20 është rasti i Remit?

21 PË. Nuk e dija këtë po ka kuptim.

22 PY. E keni takuar ndonjëherë Haradinaj?

23 PË. Asnjëherë se kam takuar gjatë luftës, po e kam takuar pas  
24 luftës. Kam folur me të me telefon satelitor në disa raste, po  
25 ballë për ballë nuk jemi takuar asnjëherë deri pas luftës.

1 PY. Po ju dinit aq për të sa të thoni që ky është një nga  
2 personat më të shkëputur nga Shtabi i Përgjithshëm?

3 PË. Po. Po më duhet të shtoj që dija mjaftueshëm për të falë  
4 përpjekjeve të trupave të marinës, majorit të trupave të  
5 marinës së SHBA-së i cili kishte një stacion në zonën e Pejës.

6 PY. Që është në zonën e Dukagjinit?

7 PË. Po. Ai u afrua shumë me Haradinaj edhe tha, ta përdorë  
8 shprehjen që tha ai "e kam njohur duke pirë me mijëra filxhan  
9 çaji", kështu shprehej ai.

10 PY. Po.

11 PË. Pra, kështu kam mësuar unë rreth Haradinaj.

12 PY. Kolegu juaj që ishte atje në terren, a ju dha ndonjë ide  
13 ju, ju tregoi ndonjëherë sesi e shihte Haradinaj marrëdhënien  
14 e tij me Shtabin e Përgjithshëm?

15 PË. Nuk më kujtohet. Por ama ka theksuar pavarësinë, shpirtin  
16 e pavarur të Haradinaj.

17 PY. Të pavarur nga çfarë?

18 PË. Ai bënte çfarë i donte koka.

19 PY. E keni fjalën të pavarur nga komanda dhe kontrolli i  
20 jashtëm, këtë po thoni?

21 PË. Po.

22 PY. A ju ka thënë ndonjëherë ai ju që ai përdorte fjalën  
23 "turist" për Shtabin e Përgjithshëm se ata ishin jashtë  
24 Kosovës?

25 PË. Jo, është hera e parë që e dëgjoj.

1 PY. Në rregull. Po në një nga shënimet tuaj thoni që kishte  
2 shumë oficer të FARK-ut apo ish-oficerë të JNA në zonën e tij?  
3 Të cilët më pas u bënë pjesë e FARK-ut? Si Tahir Zemaj dhe  
4 brigada e tij dhe kishte pasur mosmarrëveshje mes Haradinaj  
5 dhe Tahir Zemaj. Ju kujtohet kjo?

6 PË. E di që kanë pasur mosmarrëveshje.

7 PY. Dhe ka qenë një mosmarrëveshje që lindi gjatë ofensivës  
8 serbe gjatë verës?

9 PË. Kështu më kujtohet dhe mua.

10 PY. A e dini ju që Tahir Zemaj e shkarkoi Haradinaj për një  
11 periudhë kohe si komandant të zonës?

12 PË. Jo, nuk e dija.

13 PY. Po ju ama e dini që, se e keni thënë në dokumentet tuaja,  
14 se Haradinaj në zonën e Dukagjinit operonte bazuar në --  
15 kishin një farë besnikërie?

16 Ju kërkoj falje. Ju kërkoj falje.

17 PËRKTHYESJA: Përkthyesit u kërkojnë folësve të  
18 ngadalësojnë.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim]

20 PY. Ju e dini që në zonën e Dukagjinit dhe në zona të tjera  
21 këto marrëdhënie sidomos në zonat pranë Shqipërisë, besa,  
22 funksiononin në bazë të besës, ishte një lloj marrëdhënie  
23 fisnore, domethënë, marrëdhëniet krijoheshin bazuar në një  
24 lloj besnikërie, në një strukturë mbështetur në besnikëri, që  
25 ka ekzistuar me shekuj të tërë?



1 PË. Ky sistem klanor fisnor ka qenë më i pranishëm në pjesën  
2 perëndimore të Kosovës. Dhe ka pasur shumë rivalitet mes  
3 këtyre grupeve dhe një prej këtyre grupeve ka qenë grupi  
4 Haradinaj, ju kërkoj ndjesë se nuk më kujtohet emri i fisit  
5 tjetër, po ka qenë në Pejë. Dhe ka pasur një rivalitet mes  
6 tyre që në fakt buronte nga breza me radhë.

7 Ne do bëjmë një pushim në orën 10.00, por mund t'i  
8 shpjegoni Trupit Gjykues kur thoni që ka qenë një shoqëri e  
9 mbështetur në marrëdhënie fisnore në pjesën perëndimore të  
10 Kosovës, sidomos në zonat më të largëta të vendit, pra,  
11 sidomos duke marrë parasysh Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe si  
12 shërbente Kanuni i Lekë Dukagjinit për të krijuar këto  
13 marrëdhënie në këtë zonë, për të kuptuar çfarë roli mund të  
14 ketë luajtur kanuni?

15 PË. Është e vështirë kjo të thuhet me një fjali.

16 PY. Nuk është nevoja të hyjmë në hollësi, po në thelb.

17 PË. Kanuni i Lekë Dukagjinit ka qenë një dokument që vinte  
18 nga mesjeta i krijuar nga Lekë Dukagjini dhe ky ka qenë një  
19 dokument ku paraqiste parimet sesi duhet të jetonin  
20 shqiptarët, që duhet të ndiqnin shqiptarët.

21 PY. Mjafton.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do  
23 bëjmë dhjetë minuta pushim. Do t'ju shoqërojë Asistentja për  
24 të dalë nga salla.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
2 pushim për dhjetë minuta.

3 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Dua t'ju jap disa  
4 informacione sa i takon statusit të provave materiale nëse do  
5 të jenë konfidenciale a publike. Po këtë mund ta bëjmë një  
6 moment që e konsideroni të volitshëm.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
8 çaktivizuar].

9 Do të marrim parasysh edhe komentin e z. Ferdinandusse  
10 lidhur me videon.

11 Do ta bëjmë këtë në fund kur të vijë momenti për ta  
12 përdorur videon.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, do ta  
14 diskutojmë këtë kur të vijë momenti i videos.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk e vë fare në dyshim  
16 besueshmërinë e dëshmitarit, këtë video dua ta përdor në  
17 kuadër të disa përgjigjeve që ka dhënë dhe dua ta përdorë për  
18 të dhënë kontekst.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
20 Bëjmë dhjetë minuta pushim.

21 --- Seanca ndërpritet në orën 10.03

22 --- Seanca rifillon në orën 10.13

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistente  
24 mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

25 Përpara sesa ta bëjmë këtë, z. Ferdinandusse, do ju

1 kërkoja që të na paraqisni listën tuaj tani.

2 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, juve më  
3 kërkuat që të shprehja mendimin tim lidhur me provën materiale  
4 1D00118. Klasifikimi duhet të jetë konfidencial për shkak të  
5 kufizimeve të caktuara të këtij dokumenti.

6 Më pas kemi disa prova materiale të ZPS-së të cilat mund  
7 të klasifikohen si publike. Bëhet fjalë konkretisht për  
8 dokumentet nga P01067 deri në P01082. P01086 si edhe versionet  
9 në anglisht dhe në shqip të këtij materiali, domethënë, të tri  
10 versionet në tri gjuhët ekzistuese. Si dhe dokumentin P01087  
11 në shqip dh enë anglisht.

12 Domethënë, me fjalë të tjera, këto janë të gjitha provat  
13 materiale të cilat mund të riklasifikohen si publike.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
15 Do klasifikohen si publike tanimë.

16 Znj. Sekretare, keni nevojë për ndonjë gjë tjetër përpara  
17 sesa të bëni riklasifikimin?

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.  
19 Ishte çdo gjë shumë e qartë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Duke përfituar nga rasti dëshiroj që  
22 të sqarojë diçka lidhur me një material që diskutuam dje.  
23 Është një provë materiale që është shënuar për identifikim që  
24 është DJK00746, sepse nuk e kemi caktuar me saktësi datën dhe  
25 do kërkoja që tani versioni në anglisht që ka datën e këtij

1 dokumenti të pranohet si provë materiale përderisa tanimë e  
2 kemi përcaktuar datën.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
4 Dokumenti DJK00746 është pranuar në fakt që dje. Nuk e kuptoj  
5 drejtë është dokument plotësues?

6 Znj. Sekretare, dëshironi t'i caktoni një numër të ri apo  
7 thjesht mund ta vendosim si dokument plotësues.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Numri i caktuar mesa  
9 kuptoj unë, është 4D39. Dhe numri është numër provizor i  
10 provës materiale. Thjesht duhet të sqarojmë që kë dokument  
11 duhet që të pranojmë në mënyrë të tillë që t'i caktojmë në  
12 numër përfundimtar të provës materiale.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
14 Në këto kushte e pranojmë dokumentin 4D39.

15 Znj. Asistente, ju lutem silleni në sallë dëshmitarin.

16 Z. TULLY: [Përkthim] Ndërkohë që sillet dëshmitari kam  
17 diçka që dua të them, nuk ka të bëjë me këtë dëshmitar,  
18 ndoshta në qoftë se do më jepni mundësinë përpara sesa të  
19 bëjmë pushimin e radhës ose deri në fund të ditës gjithsesi do  
20 jua sillja në vëmendje që kam diçka për të thënë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,  
22 a është e mundur që të përfundosh deri në orën 11.00? Nuk po  
23 të them që duhet të përfundosh, por thjesht duam të dimë sesa  
24 kohë do ju duhet.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Deri në 11.00 kam shkuar deri në

1 një orë, në qoftë se nuk gabohem, por do më duhet edhe pas  
2 orës 11.00 të vazhdoj. Ndoshta deri diku nga dreka do të më  
3 duhet që të vazhdojë me pyetjet e mia.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

6 Z. Emmerson, vazhdoni me pyetjet.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim]

8 PY. Z. Byrnes, po diskutonim përpara sesa të bënim pushimin  
9 nivelin e pavarësisë dhe rebelizmit që ishte shprehur përpara  
10 sesa të shkohej dhe deri në momentin kur u shkua në  
11 delegacionin e Rambujesë të grupeve të cilat ishin në një  
12 pozicion të tillë. Atëherë do vazhdojmë me zonën e Drenicës.  
13 Drenica, pra, zona e Drenicës e tërhoqi mbështetjen e vet?  
14 Ndërkohë që na thatë edhe juve, që z. Haradinaj ishte  
15 tërësisht kundër mbështetjes së tyre për grupin e Rambujesë.  
16 Remi, z. Mustafa, po ashtu e tërhoqi mbështetjen e vet apo jo,  
17 Dëshmitar?

18 PË. Ashtu e kam kuptuar unë.

19 PY. Drini që ishte i caktuar nga FARK-u në zonën e  
20 Pashtrikut, çfarë roli kishte Drini atje?

21 PË. Nuk jam shumë i sigurt. E njihja Drinin mirë dhe e  
22 konsideroja atë si person të moderuar, ndërkohë që kishte të  
23 tjerë që e konsideronin atë si radikal. Ka pasur raporte të  
24 cilat në fakt i kam lexuar për t'u përgatitur për seancën  
25 gjyqësore që ai ka qenë një prej komandantëve të zonës që e ka

1 kundërshtuar fort këtë lëvizje.

2 PY. Në rregull. Do të diskutojmë lidhur me Drinin pak në më  
3 shumë hollësi më pas. Por siç e thatë dhe juve, ju keni lexuar  
4 informacion që ai ka qenë pjesë e rebelizmit.

5 Ndërkohë që zona e Nerodimës ka qenë e drejtuar nga  
6 Shukri Buja. Edhe Shukri Buja ka qenë pjesë e rebelizmit, apo  
7 jo, e grupit të rebelëve me fjalë të tjera?

8 PË. Nuk e di. Nuk mund t'jua them këtë gjë. Megjithatë mund  
9 të them që ai ishte vëllai i vogël i Ramë Bujës, që ishte  
10 person i moderuar dhe që ishte përfaqësues në Rambuje.

11 PY. Çfarë do të thotë që pozicioni i tij ishte më i  
12 komplikuar sesa i të tjerëve, megjithatë edhe ky ishte person  
13 i cili ka tërhequr pëlqimin e tij për të vijuar negociatat në  
14 Rambuje.

15 PY. Nuk e di këtë gjë.

16 PY. Së fundi, Rrahman Rama në zonën e Shalës. Çfarë mund të  
17 na thoni lidhur me të, a mund të na thoni se çfarë pozicioni  
18 kishte ai?

19 PË. Ajo çfarë kam parë në kabllograme, atë mund t'ju them.

20 PY. Çfarë keni parë?

21 PË. Që ai ishte kundër.

22 PY. Pra, në thelb, kishim shtatë zona gjithsej, megjithatë  
23 kishe përpjekje për t'i shkurtuar numrin e zonave nga shtatë  
24 në tre, por anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm nuk arritën që  
25 ta bënë këtë gjë, apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe pse nuk arritën ta bënë këtë gjë komandantët, a mund  
3 të na thoni?

4 PË. Sepse ishte e pamundur.

5 PY. Po pse ishte e pamundur?

6 PË. Sepse do të humbnin kompetencat, do të humbnin fuqi pa  
7 diskutim fare.

8 PY. Tani ndërmjet komandantëve dhe ndërmjet këtyre shtatë  
9 anëtarëve të zonës, ata nuk ishin të gatshëm që të jepnin  
10 autorizim për anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm dhe personave  
11 të tjerë që ishin pjesë e UÇK-së që negocionin në Rambuje, apo  
12 jo?

13 PË. Kjo ishte në thelb marrëveshja.

14 PY. Ju kërkoj ndjesë. Ta shtjelloj pak më tepër. Domethënë,  
15 procesi i negociatës në vetvete ishte një proces i cili ishte  
16 i vështirë dhe përfshinte sa më shumë palë të ishte e mundur.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
18 flisni më ngadalë sepse gjithmonë e tepër po e shtoni  
19 shpejtësinë e të folurit.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

21 PY. Pra, kishim një situatë të tillë, kishte një përpjekje që  
22 të shkurtohej numri i zonave nga shtatë në tre, por, ndërkohë,  
23 kjo përpjekje dështoi plotësisht sepse komandantët e zonës nuk  
24 pajtoheshin me këtë?

25 PË. Po.

1 PY. Ata nuk merrnin asnjëfarë udhëzimi nga shtabi i

2 Përgjithshëm sa i takon organizimit të tyre, apo jo,

3 Dëshmitar?

4 PË. Po, kështu ka qenë.

5 PY. Sepse sikurse e thatë dhe ju, shumë prej tyre ishin  
6 funksionalisht tërësisht të pavarur, domethënë, kishin fondet  
7 e veta, kishin armët e veta dhe nuk kishin fare asnjë lloj  
8 nevojë për Shtabin e Përgjithshëm përveç ca njerëzve që të  
9 negocionin me komunitetin ndërkombëtar?

10 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kundërshtoj.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

12 Mund t'i përgjigjeni pyetjes, Dëshmitar.

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim]

15 PY. Tani ky ishte pozicioni në shkurt. Të shohim pak  
16 pozicionin nga mbërritja juaj, që ka qenë në mos gabohem, në  
17 gusht të 1998 dhe kohës në shkurt.

18 Të lëmë për një çast mënjanë rolet ndërlidhëse  
19 ndërkombëtare për tani dhe të përqipemi të përqendrohemi tek  
20 përpjekjet e brendshme për t'u ristrukturuar, na thatë më  
21 herët që plani fillestar nuk pi ujë, domethënë, plani  
22 fillestar nuk kishte më vlerë sepse nuk u miratua nga anëtarët  
23 e zonës, nga komandantët e zonës, apo jo? Por nga ana tjetër  
24 kemi pasur një ofensivë të madhe serbe gjatë verës që çoi në  
25 disa ndryshime brenda UÇK-së, apo jo, ka qenë një sulm që ka



Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 41

1 ndodhur në qendër të Kosovës, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Por sa i takon përpjekjes për riorganizim, përpjekjet për  
4 organizim më pas u udhëzuan mbështetur në sulmet me të cilat  
5 ishte hasur UÇK-ja në atëkohë, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Por gjatë këtij rrugëtimi, ju na keni thënë neve që  
8 Ramush Haradinaj dhe Tahir Zëmaj ishin oficerët e FARK-ut dhe  
9 kishin pasur një përplasje, apo jo?

10 PË. Kështu e kishim kuptuar ne. Po nuk është se dinim shumë  
11 lidhur me këtë përplasje.

12 PY. Po, në fakt, e keni përshkruar edhe në deklaratën e tuaj  
13 të dhënë si dëshmitar që keni përshkruar, le të themi, këtë  
14 përplasje ose këtë fërkim që ekzistonte midis Haradinaj dhe  
15 Tahir Zëmaj. Domethënë, me fjalë të tjera, do të doja t'ju  
16 pyesja në qoftë se ju jeni të informuar për faktin që oficerët  
17 të JNA-së dhe Tahir Zëmaj si pjesë e forcës së FARK-ut në atë  
18 kohë, ishin të përfshirë për shpërndarjen e anëtarëve të UÇK-  
19 së?

20 PË. Jo. Nuk di gjë lidhur me këtë.

21 PY. Tani do shohim një dokument, ka një dokument që është  
22 nënshkruar nga përfaqësuesit e fraksionit të Bukoshit dhe  
23 përfaqësues të UÇK-së në Shqipëri që po përpiqeshin që këto  
24 përplasje t'i sheshonin dhe që të bashkonin të dy kahet. A  
25 jeni të informuar për këtë marrëveshje të arritur në Shqipëri?

1 PË. Jo.

2 PY. A e dini ku ka qenë Halil Bicaaj në tetor? Nuk e di në  
3 qoftë se ju kujtohet emri, apo jo?

4 PË. A mund ta përsërisni edhe një herë emrin ju lutem

5 PY. Halil Bicaaj. A e dini se ku ka qenë ai në atë periudhë?

6 PË. Nuk e njoh fare këtë person.

7 PY. Domethënë, ju nuk dini asgjë sesi është zgjidhur ky  
8 konflikt, apo jo?

9 PË. E saktë, nuk di asgjë.

10 PY. Por ju e dini, apo jo, që në të gjithë këtë periudhë,  
11 pra, nga shtatori dhe në vijim, brenda Kosovës ka pasur zona  
12 të cilat zotëroheshin nga persona me shumë influencë të UÇK-së  
13 ose le të themi gardën e vjetër të UÇK-së, persona që kishin  
14 luftuar në terren që kishin qenë pjesë e anëtarëve të UÇK-së  
15 për vite të tëra me radhë dhe që kishin modelet e veta të  
16 tilla, si për shembull, Jashari dhe Haradinaj, domethënë,  
17 kishin modelet e veta të të luftuarit dhe të përfshirjes?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe ju dhe ata, domethënë, ju vinte keq për ndërhyrje të  
20 tilla që vinin si rezultat i zgjidhjes së konfliktit, apo jo?

21 PË. Nuk jam i sigurt lidhur me këtë. Nuk di çfarë t'ju them.

22 PY. Por ju do përshkruanit këto si luftëtarë që kishin qenë  
23 në Kosovë dhe kishin komanduar vetë edhe ata formonin një grup  
24 të UÇK-së, apo jo?

25 PË. Po. Pastaj kishin persona të tillë si Remi që ishin ish-

1 oficerë të ushtrisë jugosllave por megjithatë nuk kishin  
2 funksionuar në kuadër të FARK-ut por pretendonin ose premtan  
3 që të krijonin një UÇK të unifikuar dhe kjo përbënte  
4 kategorinë e dytë, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Megjithatë të dyja këto kategori, sikurse ju e thoni,  
7 ishin tërësisht të pavarura nga Shtabi i Përgjithshëm, apo jo?

8 PË. Po. Në çështje operative ishin tërësisht të pavarur nga  
9 UÇK-ja.

10 PY. Ndërkohë kishim zona të tjera si, për shembull, zona e  
11 Pashtrikut ku Drini vetë vazhdonte si oficer i FARK-ut dhe  
12 ishte luajal ndaj qeverisë së Bukoshit, apo jo, kishte  
13 besnikëritë e tij me z. Bukoshi?

14 PË. Me ju thënë të drejtën kjo është hera e parë që dëgjoj  
15 këtë përshkrim lidhur me të.

16 PY. Ju nuk e keni kuptuar që ai ka qenë pjesë e FARK-ut?

17 PË. Jo.

18 PY. Po ju nuk e dinit që tensionet që zienin ndërmjet FARK-ut  
19 dhe UÇK-së së vjetër shpërthenin herë pas here në vende të  
20 ndryshme në Kosovë, apo jo?

21 PË. E dija që shpërthenin, në veçanti në pjesën perëndimore  
22 të Kosovës midis Pashtrikut dhe zonës së Dukagjinit.

23 PY. Atëherë do kërkoja të kalonim në seancë private sepse  
24 dëshirojmë që të shikojmë një dokument të TPNJ-së.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem na

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 44

1 kaloni në seancë private, znj. Sekretare.

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 45

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 46

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 47

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 48

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 49

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 50

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
14 jemi në seancë publike.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Po flasim pak më ngadalë besoj për  
16 përkthyesit?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të  
18 numëroni deri në tre para se të jepni përgjigjen.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim]

20 PY. Problemi jam unë kryesisht, domethënë, unë nuk numëroj  
21 deri në tre përpara sesa të bëj pyetjen e radhës.

22 Atëherë, për ta përmbledhur. Në seancën private,  
23 mbështetur në dokumentin që e diskutuam në seancë të mbyllur  
24 dhe dua që ta konfirmoni këtë për procesverbal për publikun.  
25 Ju thatë që garda e vjetër e UÇK-së që kishin luftuar brenda

1 Kosovës për sa kohë deri në atë pikë ishin sikundër oficerëve  
2 të FARK-ut dhe ishin në përplasje me ta, por nga ana tjetër  
3 ishin kundër edhe grupit të studentëve të pamatur dhe  
4 papërvojë, sipas tyre, që vinin nga Zvicra dhe t'ju jepnin  
5 atyre udhëzime, kështu do ta përshkruani situatën?

6 PË. Kjo është një përmbledhje e drejtë e vlerësimit që kishim  
7 edhe ne në atë kohë. Mbase përmbledhja jonë ose mendimi që ne  
8 kishim nuk ishte i drejtë në atë kohë, por kështu mendonim,  
9 kështu. Absolutisht kështu siç e thatë dhe juve.

10 PY. Dhe i gjithë luftimi ndërmjet tyre, domethënë, kishte  
11 përplasje, kishte konflikte ndërmjet tyre, konflikte të cilat  
12 u rritën akoma më tepër në momentin kur shkon përfaqësia në  
13 Rambuje, domethënë, Shtabi i Përgjithshëm shkon në Rambuje dhe  
14 kjo përplasja midis tyre çoi në tërheqjen e autoritetit  
15 negociues ose në heqjen e autoritetit negociues ndërmjet tyre?

16 PË. Nuk jam i sigurt. Ju përdorni fjalën kishte "përplasje të  
17 ashpra", "luftime kundër tyre". Po unë do thoja që kishte  
18 thjesht mosmarrëveshje. Ato lloj mosmarrëveshjesh të cilat  
19 juve i thatë dhe më përpara, domethënë, ata ishin të pakënaqur  
20 me mënyrën sesi vinin armët nga Shqipëria dhe sesi ato  
21 shpërndareshin.

22 PY. Ishte faji im, u shpreha unë keq. E kisha fjalën për këto  
23 përplasjet e brendshme, nuk e kisha fjalën për luftimet në  
24 përgjithësi.

25 PË. Ishte e qartë që kishte pajtim të përgjithshëm në

1 kundërshtim me dokumentet që ishin të përgatitur që të  
2 nënshkruanin anëtarët e delegacionit në Rambuje.  
3 PY. Domethënë, me fjalë të tjera, në mendimin tuaj qasja më  
4 politike e delegacionit në Rambuje ishte që duhej njohur  
5 realiteti dhe mënyra më realiste e arritjes së zgjedhjes për  
6 sigurinë për popullsinë kosovare dhe pavarësisë së Kosovës do  
7 ishte përmes procesit negociues ndërkombëtar dhe jo përmes  
8 vijimit të luftimeve në terren, apo jo?  
9 PË. Po. Ky ishte një gjykim, ishte një vlerësim, një gjykim  
10 shumë herë më tepër realist. Më kujtohet, për shembull, që kam  
11 diskutuar me Jakup Krasniqin lidhur me këto tema.  
12 PY. Të ndalojmë këtu për një çast. Megjithëse thashë që nuk  
13 përdora fjalën e duhur kur thashë "luftime" ose "përplasje",  
14 megjithatë është e vërtetë, e drejtë apo jo, që kishte  
15 mosmarrëveshje sa i takon zonave të territorit që kontrollonte  
16 secila prej palëve, domethënë, që nuk kishin dakordësi sa i  
17 takon territorit të dy zonave që kontrolloheshin dhe kishte dy  
18 komandant zonash të cilët kishin probleme ose kishin paqartësi  
19 lidhur me territorin e kontrollit?  
20 PË. Në qoftë se mosmarrëveshje kishte të paktën paqartësi do  
21 thoja sa i takon shtrirjes, sipërfaqes që mbulonte zona e  
22 Pashtrikut ose mbivendosjes së zonës së Pashtrikut dhe zonës  
23 së Drenicës, në veçanti në zonën e Malishevës dhe Rahovecit.  
24 Pra, nuk ishte e qartë se çfarë territori përfshinte  
25 secila prej zonave dhe kishte ca paqartësi. Edhe ne vetë jemi

1 përpjekur që ta sqarojmë këtë situatë. Kemi bërë shumë pyetje  
2 dhe zona e Drenicës përfundonte në kufi në rrugën midis  
3 Prishtinës dhe Pejës dhe nuk ishte e qartë në qoftë se  
4 përfundonte këtu apo vazhdonte më tej, shtrihej më tej në jug  
5 të asaj rruge? Domethënë, për ne nuk ishte e qartë se deri ku  
6 ishte kufiri i zonës, nuk ishte e qartë as për neve as për ata  
7 pa diskutim.

8 PY. Po, gjithashtu edhe zonat malore në jug të zonës,  
9 domethënë, kishte paqartësi edhe sa i takon zonës malore, në  
10 qoftë se i takonte njërës tonë apo zonës tjetër, apo jo,  
11 Dëshmitar?

12 PË. Për këtë nuk e kam shumë idenë.

13 PY. Megjithatë pavarësisht situatës kaotike në terren ishte  
14 absolutisht e pamundur që të sigurohej një komandë e  
15 unifikuar, apo jo?

16 PË. Nuk do thoja që ishte situatë kaotike. Më shumë do thoja  
17 që ishte e paqartë. Megjithatë, në fund të ditës, kjo situatë  
18 e bëri më të vështirë komandën dhe kontrollin nga qendra, kjo  
19 ishte diçka që e përkeqësonte më shumë situatën.

20 PY. Dua t'ju bëj një pyetje edhe në lidhje me një përgjigje  
21 që ju dhatë dje për një pyetje që ju bëri z. Ellis për  
22 negociatat që u bënë në lidhje me lirim të disa oficerëve të  
23 ushtrisë jugosllave.

24 Dhe do ta gjejmë këtu tek transkripti, referenca në fakt,  
25 për ta gjetur është 13794 dhe po e lexoj pak pjesën,

1 fragmentin përkatës. Pra, z. Ellis ju bëri një pyetje dhe ju  
2 tha:

3 "Kjo nuk ishte asgjë tjetër përveçse një situatë  
4 politike, apo jo? Ishte diskutim i nivelit të lartë me  
5 ambasadorët përkatës por edhe me Shtabin e Përgjithshëm, e  
6 saktë?"

7 Përgjigja juaj ishte:

8 "Unë e shihja këtë si një çështje politike, çështje  
9 politike të nivelit të lart".

10 Pyetje:

11 "Pra, ajo lloj çështjeje të cilën ju duhet ta shihni si  
12 një çështje me të cilën mund të merrej Shtabi i Përgjithshëm,  
13 apo jo?"

14 Përgjigja juaj ishte:

15 "Po".

16 Dhe pyetja vijoi:

17 "Ndërkohë që, për shembull, ndalimi i një personi në  
18 terren do të ishte një gjë operative operationale dhe do të  
19 ishte një çështje me të cilën do të merreshin nivelet më të  
20 ulëta, apo jo?"

21 Dhe përgjigja juaj dhe pyetja ime për ju është kjo, ishte  
22 që:

23 "Prezumimi im i tillë është dhe e them dhe një herë është  
24 prezumim nga ana ime që ndalimet në terren ishin përgjegjësi  
25 ose kryheshin nën drejtimin e komandantëve të zonës".

1 Pra, thjesht doja t'ju bëj këtë për prezumimin që ju  
2 dhatë sepse përgjigja që ju dhatë ishte që personat që  
3 ndaloheshin dhe juve ju referuat sisa situatave të caktuara në  
4 të cilat ishin ndaluar civilë, për shembull, ose gazetarë, e  
5 të tjerë, me ç'kishit kuptuar ju ose vlerësimi juaj më saktë  
6 është që ato vendime merreshin në nivel, pra, ishin në nivel  
7 zone, pra, sepse mendimet operative nuk merreshin tek Shtabi i  
8 Përgjithshëm, apo jo?

9 PË. Më lejoni që të jem tejet i saktë dhe i qartë. Ne as edhe  
10 një herë nuk kemi patur ndonjë provë që të tregonte që Shtabi  
11 i Përgjithshëm i UÇK-së, Thaçi, Krasniqi, Ramë Buja, Xhaviti e  
12 të tjerë, kurrë nuk kemi patur prova që ata të kishin dhënë  
13 urdhër apo të udhëzonin që të merreshin peng, të rrëmbeheshin  
14 gazetarët serbë apo aktivistët e LDK-së. Kurrë nuk kemi patur  
15 prova të tilla.

16 PY. A po për ndonjë civil?

17 PË. Po. Apo për ndonjë civil. Dhe më lejoni që ta mbaroj  
18 përgjigjen time. Sigurisht që ne menduam që këto veprime, pra,  
19 prezumimi im ishte ky që këto veprime ndërmerreshin ose në  
20 formë të pavarur nga komandantët vendas të UÇK-së ose eprorët  
21 e tyre, pra, për shembull, komandanti i brigadës ose i zonës.

22 PY. Po fiks. Pra, ajo që dua ë them është që nuk ishte  
23 domosdoshmërisht në nivel të komandantit të zonës. Se mund të  
24 ishin dhe element të pabindur më poshtë se komandanti i zonës  
25 që merrnin këto vendime, apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Po nuk merreshin më lart se niveli i zonës, apo jo?

3 PË. Po, po ne nuk e dinim këtë. Po edhe një herë, ne nuk kemi  
4 parë prova që ishte Shtabi i Përgjithshëm ai që po jepte  
5 urdhër për rrëmbimin e këtij civil i apo e një aktivisti tjetër  
6 të LDK-së e të tjerë.

7 PY. Ju besoj e dini konceptin e përgjegjësisë komanduese  
8 besoj?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe që kjo kërkon njohuri, pra, që të ketë prova dhe  
11 njohuri të plota dhe të sakta që dikush po vendosë dhe po  
12 ndodhë diçka në terren ose, për shembull, diçka që nuk po  
13 merren, për shembull, masat e duhura në terren. Besoj e  
14 kuptoni?

15 PË. Po.

16 PY. Pra, ky është parimi bazë që ju do të vendosnit se kush  
17 ishte komandanti i zonës? Për të parë nëse dikush ishte  
18 përgjegjës dhe kush kishte përgjegjësinë në bazë komande?

19 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kjo është një çështje.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë mund ta bëj pyetjen edhe  
21 një herë.

22 PY. Në bazë të informacionit që kishit ju se çfarë po ndodhte  
23 në terren, a patë ndonjë provë që mund të mbështesë, për  
24 shembull, propozimin që ishte Shtabi i Përgjithshëm ai që  
25 kishte përgjegjësi komanduese në lidhje me ndalimet që po



1 bëheshin në zona?

2 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Në fakt unë kundërshtoj, i  
3 nderuar Gjykatës.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në fakt, unë nuk e kuptoj se  
5 përse ta kemi dëshmitarin këtu në rast se nuk mund t'i  
6 përgjigjet kësaj pyetjeje.

7 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
9 kundërshtimi. Dhe ndoshta duhet ta përsërisni pyetjen.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim]

11 PY. Atëherë, në bazë të njohurive shumë të sakta që kishit ju  
12 të asaj që po ndodhte në terren në Kosovë, a patë prova që  
13 mund të mbështesin propozimin që Shtabi i Përgjithshëm kishte  
14 përgjegjësi komanduese mbi çfarë po ndodhte, për shembull,  
15 ndalimet në zona, që, do të thotë, fuqi operative edhe për të  
16 dënuar, për shembull, për të parandaluar apo për të dënuar apo  
17 për të mos lejuar një gjë të tillë që të ndodhte, a patë diçka  
18 të tillë?

19 PË. Ishte një pyetje e ndërlikuar, por përgjigja ime e saktë  
20 do të jetë jo.

21 PY. A mund të kalojmë tek një temë tjetër tashmë.

22 Juve, z. Misetic ju tregoi një raport ose më saktë një  
23 artikull dhe dëshmia që ishte dhënë nga Zoran Stijovic, që  
24 ishte edhe shefi i RBD-së në gjyqin e Haradinaj në lidhje me  
25 shtrirjen që kishte ndërhyrja e serbëve tek UÇK-ja, e zbulimit

1 serb duke përfshirë edhe rangjet më të larta të kësaj

2 organizate, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe ju në fakt shprehët befasi që RDB-ja të kishte, sipas

5 vetë që e ka thënë, që ishte në krye të këtij shërbimi, që të

6 kishte rreth 200 burime në atë moment brenda për brenda UÇK-

7 së, përfshirë edhe krerët tek rangjet më të larta, apo jo?

8 PË. Po, u befasova.

9 PY. Dhe në fakt ju na treguat për një incident kur z. Sreten

10 Lukic ju tregoi edhe shtëpitë e një individi, pra, "ku do të

11 gjendej diçka", apo jo, se kjo ishte cilësia e zbulimit, e

12 inteligjencës, e informacionit që kishin ata, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Por, z. Miletic nuk ju tregoi atë pjesë të artikullit që

15 fliste për metodologjinë që është përdorur nga Stijovic dhe

16 dëshiroj që ta lexojmë këtë nëse është e mundur. Në artikull

17 thuhet që:

18 "Shkalla e besueshmërisë së informacionit varej nga

19 burimi dhe motivimi i personit që e ndante atë me RDB-në.

20 Motivet ishin të ndryshme' shpjegon Stijovic. 'Disa persona

21 morën informacion dhe e shisnin atë për para, me shifra si

22 disa mijëra apo dhjetëra mijëra markash gjermane, të tjerët

23 nuk ishin dakord me politikën e shqiptarëve në Kosovës, por

24 kishte edhe të tjerë të cilëve u ishte bërë shantazh për të

25 bashkëpunuar'".

1 Pra, u pyet për shantazhin dhe ai tha:

2 "Shoqëria shqiptare është shumë patriarkale dhe sjellja  
3 imorale nuk tolerohet. Prandaj shërbimi mbledh informacion  
4 edhe, për shembull, 'tradhti, për alkoolin që konsumohet' në  
5 mënyrë që ta keqpërdorin këtë informacion kundër atyre që e  
6 kanë këtë sjellje imorale sepse kjo sjellje është një mënyrë e  
7 mirë për t'i vendosur këta persona në një situatë e cila do  
8 t'i bëjë të veprojnë në mënyrën që do t'i që të veprojnë".

9 Pra, ky është edhe koncepti i njohur sovjetik i  
10 shantazhit?

11 PË. Po.

12 PY. Pra, që i vendos personat në një situatë ku ata kanë bërë  
13 diçka në jetën e tyre private për t'u bërë shantazh për të  
14 arritur atë që do ti?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe në rast se flasim, sipas këtij eksperti, për ata 200  
17 vetët, së bashku me dëshminë të takimit tuaj me z. Lukic, po  
18 merreshim këtu me një shërbim zbulimi kundërzbulimi serb shumë  
19 të sofistikuar e të lart nga e serbëve, apo jo?

20 PË. Absolutisht që po.

21 PY. Dhe që dua që këtë ta krahasojmë me ju, nëse është e  
22 mundur, me zbulim kundërzbulimin nga ana e UÇK-së, sepse ne e  
23 dimë që edhe pse z. Veseli ishte në Shqipëri, ai kishte rolin e  
24 vet pra, të caktuar në lidhje me zbulim kundërzbulimin apo  
25 inteligjencën.

1 Pyetja ime është si do ta bënit vlerësimin të strukturave  
2 krahasimore të inteligjencës brenda Kosovës nga ana e UÇK-së?  
3 PË. Si do ta vlerësoja?

4 PË. Po. Si do ta vlerësonit ju atë në krahasim me strukturat  
5 serbe, të cilën e përmblodhëm, pra, cili ishte niveli i  
6 operacioneve të zbulim kundërzbulimit brenda Kosovës nga ana e  
7 UÇK-së?

8 PË. Nuk kam informacion mjaftueshëm që të mund t'i përgjigjem  
9 kësaj pyetjeje në mënyrë të sigurtë.

10 PY. Vetëm që ju na thatë ama që as gazeta nuk kishin?

11 PË. Më falni?

12 PY. Ju na thatë që brenda për brenda Kosovës, personat me të  
13 cilët kishit ju lidhje nuk kishin mundësi as të dëgjonin  
14 lajmet e jashtme?

15 PË. Edhe një herë, ju lutem

16 PY. As gazetatat nga jashtë shtetit sepse ju i blinit ato në  
17 Maqedoni, apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe ju thatë në fazat më të fundit që kishte përpjekje  
20 nga UÇK-ja për të arritur, për të kapur, për të përgjuar, pra,  
21 --

22 PË. Më falni nga mikrofoni nuk ju dëgjoj dot.

23 PY. Pra, pyetja ime është duke patur parasysh gjithçka që ju  
24 na shpjeguat si një strukturë shumë më profesionale dhe shumë  
25 e zgjeruar dhe e shtrirë nga ana e serbëve, nga shënimet tuaja

1 janë shënuar disa përpjekje nga UÇK-ja për të arritur  
2 përgjime. Po me anën e këtyre dy gjërave a mund të bëni një  
3 vlerësim të asaj që po ndodhte në anën e Kosovës në krahasim  
4 me atë që po bënte Serbia?

5 PË. Përgjigja e shkurtër është jo. E vetmja gjë që mund t'ju  
6 them është që në fund të luftës unë kam parë në Lladrovç një  
7 gjë që dukej që ishte një qendër përgjimesh.

8 PY. A mund të na jepni muajin?

9 PË. Ju lutem si thatë?

10 PË. Muajin a mund të na e jepni?

11 PË. Besoj që ka qenë ndoshta një takim qershor, në qershor  
12 1999.

13 PY. Faleminderit.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Tani do të kaloj tek një temë  
15 tjetër megjithatë e shoh orarin.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Dëshmitar, tani do të bëjmë një pushim prej gjysmë ore.

18 Dhe Asistentja do t'ju shoqërojë që të dilni nga salla dhe do  
19 të rikthehemi të gjithë në sallë në orën 11.30.

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] atëherë

22 seanca shtyhet deri në orën 11.30.

23 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] A mund të kërkojmë se kur do  
24 të mbarojë z. Emmerson, vetëm thjesht për të planifikuar?

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Deri në pushimin e drekës do ta

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 62

1 kem kryer seancën e kundërpyetjeve.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 --- Pauza fillon në orën 10.58

4 --- Seanca rifillon në orën 11.30

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistente,

6 mund të sillni sërish dëshmitarin në sallë.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do

9 të vijojmë me kundërpyetjet e Avokatit të Veselit.

10 Z. Emmerson, fjala është për ju.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim]

12 PY. Pata mundësinë të merrja disa udhëzime sa i takon pikës

13 së fundit të dëshmisë, sa i takon përgjimit në Lladrovc rreth

14 19 qershorit, kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Në lidhje me këtë, në atë kohë, KFOR-i kishte hyrë, se ka

17 hyrë më datë 12, më datë 12? Në zonën rreth Lladrovcit kishte

18 shërbime inteligjente të KFOR-it edhe forcat që kishin

19 avancuar dhe që po bashkëpunonin dhe komunikonin me UÇK-në,

20 keni dijeni për këtë?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe pajisjet që keni parë ju te kjo qendra e përgjimit në

23 fakt ishin përgjime të KFOR-it që përgjonin komunikimet që u

24 ishin dhënë UÇK-së, a keni dijeni për këtë?

25 PË. Jo.

1 PY. A thoni që nuk e dini, apo s'ka qenë kështu?

2 PË. Nuk e dija këtë gjë.

3 PY. Në rregull. Tani le të flasim shkurtimisht për disa nga  
4 kabllogramet që keni çuar, ose diptel ndryshe, që keni çuar  
5 Uashingtonit, por do t'i marrim në rend kronologjik, sepse  
6 mund të jetë relevante kjo për ne.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dokumenti i parë është P1069 dhe  
8 përmban datën 18 dhjetor 1998. Lutem që të shfaqet në... Ju  
9 lutem, të shohim tek dokumenti origjinal lart djathtas, është  
10 322. Kjo është faqja pra që nevojitet.

11 PY. Z. Misetic ua tregoi një herë këtë paragraf, por unë do  
12 ju lutesha të shikonit paragrafin 6.

13 "UÇK-ja po përfiton nga armëpushimi i vështirë në Kosovë,  
14 në mënyrë që përpiqet të fitojë kontroll mbi njësitet e veta."

15 Jemi më 18 dhjetor këtu, kur po bëhet edhe riorganizimi.  
16 Thuhet që:

17 "Mbetet e organizuar në shtatë zona, shumica e të cilave  
18 kanë komandant politik dhe ushtarak, dhe mbi të cilët është  
19 Shtabi i Përgjithshëm që përbëhet nga 10 apo 15 persona.  
20 Shtabi i Përgjithshëm sipas kontakteve që kemi atje, po  
21 përpiqet të krijojë një zinxhir komandues ushtarak vertikal në  
22 mënyrë që të ketë kontroll më të fortë përkundrejt  
23 komandantëve ushtarakë. Sidoqoftë janë ndeshur në rezistencë  
24 dhe riorganizimi është shumë mbrapa. Kundërshtimi vjen nga  
25 komandantët si Ramush Haradinaj, shefi i zonës së Deçanit, i

1 cili nuk do të heqë dorë nga pavarësia që ka pasur gjatë  
2 verës, kur UÇK-ja u përpoq të vetorganizohej, dhe shtabi ka  
3 qenë jashtë vendit dhe ka qenë në kontrollin e diasporës.  
4 Haradinaj ka qenë kundër UÇK-së edhe kur ka qenë në Shqipëri  
5 për gjatë gjithë verës. Sipas burimeve të UÇK-së, ata  
6 pretendojnë se ai nuk ka respektuar urdhëresat e Shtabit të  
7 Përgjithshëm duke sulmuar Deçanin dhe është përpjekur të  
8 ndërpresë rrugën Pejë-Deçan në fillim të kësaj vere. Në  
9 nëntor, nuk ka respektuar urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm  
10 duke sulmuar rregullisht patrullat e policisë serbe në lindje  
11 të Deçanit. Sipas oficerit të Shtabit të Përgjithshëm, Shtabi  
12 i Përgjithshëm po përpiqet ta zëvendësojë Haradinajn kryesisht  
13 se nuk merr urdhra dhe për shkak të faktit se është anëtar i  
14 FARK-ut.”

15 Ky komenti i fundit besoj se diskutuam që ka qenë gabim,  
16 se Haradinaj s’ka qenë ndonjëherë pjesë e FARK-ut.

17 PË. Po.

18 PY. Por me përjashtim të këtij gabimi, është shprehur, është  
19 kështu kjo që është thënë në këtë paragraf, kështu ka qenë në  
20 të vërtetë?

21 PË. Unë e kam shkruar dhe i qëndroj, por nga sa më kujtohet,  
22 ose më ndryshe, nuk më kujtohet tamam. Më kujtohet që ishte  
23 problematik sepse donte të ndërpriste këtë rrugën, mes Pejës  
24 dhe Deçanit, dhe Prizrenit. Gjakovë-Prizren. Me singeritet nuk  
25 më kujtohet, se kanë kaluar dhe 25 vite. Por nuk më kujtohet



1 që Shtabi i Përgjithshëm të jetë përpjekur ta zëvendësojë.

2 PY. Shumë e qartë kjo, sepse kjo mund të jetë njësoj si  
3 gabimet që keni bërë me FARK-un, mund të jetë një paqartësi.

4 PË. Nuk më kujtohet në fakt, unë e kam shkruar këtë.

5 PY. Unë po ju them që ka qenë e pasaktë kjo që është thënë  
6 këtu, dhe në fakt mosmarrëveshja u zgjidh në tetor në Shqipëri  
7 mes Tahir Zemajt në atë zonë që ka qenë vërtet i FARK-ut dhe  
8 Ramush Haradinajt që nuk ka qenë i FARK-ut.

9 PË. Po.

10 PY. A përputhet më shumë kjo me atë që ka ndodhur në të  
11 vërtetë?

12 PË. Po.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpiguni të  
14 mos flisni njëherazi, bëni një pauzë mes pyetjeve dhe  
15 përgjigjeve.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Faleminderit. Edhe një herë,  
17 shohim paragrafin 7 që është në fillim të faqes tjetër.

18 PY. Këtu ju po flisni në kohën e tashme më 18 dhjetor. Ju  
19 thoni:

20 "Vetë Shtabi i Përgjithshëm është relativisht inkohorent  
21 sepse është gjithnjë e në lëvizje dhe se anëtarët rrallë herë  
22 takohen me njëri-tjetrin. Në të vërtetë, shumica e Shtabit të  
23 Përgjithshëm aktualisht është jashtë vendit, por pritet që do  
24 të kthehen në Kosovë deri në fund të vitit, sipas burimeve të  
25 UÇK-së."

1 Dhe vijoni më poshtë dhe thoni, flisni për përpjekjet që  
2 ishin bërë për të identifikuar anëtarë të kësaj njësie që nuk  
3 ishte ndonjë vend dhe nuk takoheshin bashkë, pra që ishin  
4 jahte Kosovës. Përmendni këtu z. Thaçi, z. Selimi, Ramë Bujën.  
5 Këta tri persona, por ama këtu nuk keni identifikuar z.  
6 Veseli, kështu?

7 PË. Po.

8 PY. Pra, në këtë fazë ju nuk e kishit emrit e z. Veseli në  
9 shërbimet tuaja, në informacionet tuaja të inteligjencës.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Vazhdojmë dhe shikojmë një  
11 paragraf tjetër që jua tregoi z. Roberts, që është Avokati i  
12 z. Selimi, 075330. Kjo është. Lexojmë paragrafin 14 ku është  
13 ky titulli "konfidencial".

14 PY. "Sipas anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm", dikush pra  
15 nga Shtabi i Përgjithshëm ju jepte ju informacion të  
16 përpunuar, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Nuk po ju them të përgjigjeni në lidhje me këtë, sepse ka  
19 një shënim këtu "konfidencial", por a e dini kush ishte ky  
20 person?

21 PË. Nuk e di.

22 PY. "Shtabi i Përgjithshëm", thuhet këtu, "ka pasur kohët e  
23 fundit...", e shikoni dot, është LPK apo LVK?

24 PË. Është LPK.

25 PY. Pra "Shtabi i Përgjithshëm kohët e fundit ka pasur

1 probleme me LPK-në", kështu? "Shtabi i Përgjithshëm ka pasur  
2 probleme me LPK-në".

3 PË. Po.

4 PY. "... dhe ky person i Shtabit të Përgjithshëm thotë që i  
5 kërkohet LPK-së -- LPK-ja i kërkon Shtabit të Përgjithshëm të  
6 marrë një qëndrim më radikal në mënyrë që t'i luftojë më shumë  
7 forcat e sigurisë serbe."

8 Në fakt, këtu s'e di LDK apo LPK duhet të jetë?

9 PË. LPK duhet të ishte edhe këtu.

10 PY. Vetëm për LPK-në flitet këtu.

11 "... sipas këtij burimi, LPK-ja nuk do të japë para nga  
12 fondi "Mëmëdheu Thërret" deri në momentin që UÇK-ja do të  
13 përdorë taktika më agresive."

14 Vijon:

15 "Thaçi ka qenë në Perëndim, bashkë me Rexhep Selimin dhe  
16 anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm, dhe janë  
17 përpjekur të argumentojnë vendimin e Shtabit të Përgjithshëm  
18 që t'i japin një shans aspektit politik dhe të kërkojnë më  
19 shumë para."

20 Pastaj flitet që Thaçi është përpjekur të kontaktojë me  
21 z. Bukoshi, por kjo ka qenë e pasuksesshme.

22 Ndalojmë këtu. Ne dëgjuam në kundërpjetjet e z. Roberts  
23 që fakti që Rexhep Selimi ka qenë në Perëndim gjatë kësaj  
24 periudhe kohore ka qenë gabim. Dhe ju e pranuat këtë, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Pra, z. Thaçi ka qenë në Perëndim, e heqim Rexhep Selimin  
2 këtu, dhe gjithë anëtarët e tjerë. Tani unë ju pyes, një nga  
3 këta anëtarët e tjerë, a e dini mos ka qenë z. Veseli?

4 PË. Jo, nuk e di këtë gjë.

5 PY. Kalojmë te 4 shkurt 1999. Jemi gjatë ose rreth periudhës  
6 së procesit të Rambujesë, që po zhvillohet procesi i  
7 Rambujesë.

8 PË. Po.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është prova materiale P1074. Na  
10 nevojitet faqja 13 ose 75340. Më falni, më mirë të shkojmë tek  
11 faqja pararendëse për të kuptuar kontekstin, që përfundon me  
12 339.

13 PY. E shihni këtu, në vija të përgjithshme në këtë faqe, ju  
14 po përshkruani rolet e ndryshme që patët mundësi të  
15 evidentoni, politika, Hashim Thaçi, logjistika, ato që njihnit  
16 ju. Xhavit Haliti, edhe kështu me radhë. Kaq dinit ju për  
17 këta. Në fund të faqes tjetër, ajo që mbaron me 340. Ju kërkoj  
18 ndjesë, desha të thoja në fillim të faqes, dhe pika 2:

19 "Informacion/shërbim -- informacion i përpunuar:"

20 "Nuk kemi qenë në gjendje të identifikojmë drejtuesin."

21 Kjo ishte pozicioni juaj?

22 PË. Asokohe, po.

23 PY. Ju kujtohet çfarë date keni shkuar në Rambuje?

24 PË. Po të kisha ditarin, mund t'jua thoja, por tani nuk ua  
25 them dot datën.

1 PY. Do flasim më vonë, se kemi evidenca për datën. Por  
2 sidoqoftë, data e këtij dipteli, e këtij kabllogrami, pra, do  
3 të thotë sipas datës që ju në atë kohë nuk e dinit kush ishte  
4 shefi apo shefat e inteligjencës?

5 PË. Po.

6 PY. Shohim paragrafin 6 të kësaj faqeje.

7 "Sipas oficerëve të Shtabit të Përgjithshëm, Shtabi i  
8 Përgjithshëm kohët e fundit ka vendosur kundër konsolidimit të  
9 shtatë zonave ekzistuese nga shtatë në tre. Burimet tona të  
10 UÇK-së pretendojnë se Shtabi i Përgjithshëm doli në  
11 përfundimin se konsolidimi do të pakësonte efektivitetin e  
12 UÇK-së në planin afatshkurtër, dhe ne dyshojmë se konsolidimi  
13 i zonave në fakt rezultoi të ishte shumë i vështirë..." Është  
14 më poshtë në faqe.

15 "... se duhet të ishte shumë i vështirë. Në kohën ku  
16 Shtabi i ri i Përgjithshëm po përpiqej të përfshinte elemente  
17 të ndryshme të UÇK-së në disa, dhe të krijonte një organizatë  
18 ushtarake koherente, dhe në veçanti të ushtronte autoritetin e  
19 vet virtualisht përkundrejt drejtuesve ushtarakë të pavarur të  
20 zonave, ishte politikisht e pamundur t'u kërkohej disa  
21 komandantëve të zonave që t'ua kalonin disa nga trupat e veta  
22 zonave të tjera. Ka shumë të ngjarë që Shtabi i Përgjithshëm  
23 vendosi të pranonte strukturën ekzistuese dhe të zonave, por  
24 në shkëmbim të kishin më shumë kontroll ndaj komandantit të  
25 zonave."

1 Kjo ka qenë mënyra si e kuptuat ju këtu në vitin 1999?

2 PË. Ky ka qenë një analizë e jona. Ne po përpiqeshim të  
3 jepnim një panoramë të situatës.

4 PY. Dhe kjo përputhet dhe me dëshminë që keni dhënë sot.

5 PË. Çfarë?

6 PY. Përputhet me dëshminë që i keni dhënë në pyetjet tona.

7 PË. Nuk ju dëgjoj nga mikrofoni.

8 PY. Ju kërkoj falje. Pra, edhe një herë. Ky shënim në këtë  
9 kabllogram përputhet dhe me dëshminë që dhatë ju sot paradite  
10 kur thatë pse nuk u realizua ky plan i riorganizimit. Shohim  
11 fjalinë e parë të plotë në këtë paragraf. Ky është vlerësimi i  
12 KDOM-it dhe besoj se pajtoheni me mua, ka qenë që në shkurt të  
13 1999, përpara bombardimit të NATO-s. Situata ka qenë e këtillë  
14 që "Shtabi i Përgjithshëm po përpiqej të krijonte një  
15 organizatë ushtarake koherente me elementë të UÇK-së", kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Kjo është situata e shkurtit, po ama akoma nuk ka pasur  
18 ndonjë, as nuk është formuar kjo strukturë koherente.

19 PË. Po.

20 PY. Po ashtu, Shtabi i Përgjithshëm po përpiqej dhe nuk po ia  
21 dilte mbanë "të ushtronte autoritetin e vet ndaj këtyre  
22 drejtuesve ushtarakë të zonave", kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Pra, këtë tablo deshët t'i përcillnit ju Uashingtonit sa  
25 i takon pushtetit relativ që kishte Shtabi i Përgjithshëm ndaj

1 këtyre drejtuesve ushtarakë të pavarur, në gjithë Kosovën. Kjo  
2 ka qenë panorama që u keni treguar atyre, që u keni dhënë  
3 atyre?

4 PË. Po. Por, z. Emmerson. Do të doja dhe unë të komentoja pak  
5 pse dolëm ne në këto përfundime. E di që mbase kjo do ta  
6 zgjasë pak diskutimin, mbase. UÇK-ja operonte në një mjedis  
7 tepër të vështirë. Në ato momente shumë zona nuk i  
8 kontrollonin. Nuk mund të lëviznin lirisht në rrugë.  
9 Përshtypja jonë ishte që kishin komunikim shumë të kufizuar  
10 dhe të pasigurt. Komunikonin me ato telefonat e hershëm, me  
11 radio-dore dhe kishin disa telefona satelitorë. Dhe, ishin  
12 shumë në presion nga forcat e sigurisë serbe.

13 Siç thuhet dhe në kabllogram, ata lëviznin nga një vend  
14 në tjetrin. Shtabi, të paktën siç e kishim kuptuar ne, çfarë  
15 na kishin thënë, shtabi nuk ishte në një vend gjithmonë. Dhe  
16 anëtarët të cilët nuk i kemi identifikuar të gjithë, por  
17 anëtarët ishin të shpërndarë në gjithë vendin. Ka qenë shumë e  
18 vështirë për ta të krijonin një organizatë koherente, për këtë  
19 arsye që sapo citova. Dhe ne prandaj dolëm në këto përfundime.

20 PY. Dhe në veçanti, sa i takon z. Veseli, sa i takon pra z.  
21 Veseli, në këtë periudhë kohore, ju me sa keni ditur ky person  
22 s'ka qenë fare në Kosovë, por ka qenë në Shqipëri.

23 PË. Po, kështu.

24 PY. Në rregull. Dhe komenti që thatë ju për kontrollin  
25 efektiv, dhe gjitha vështirësitë në mungesë të komunikimeve të

1 sigurta, të sofistikuara, sigurisht që kjo e bën shumë të  
2 vështirë që nga Shqipëria të punosh apo të realizosh diçka në  
3 terren në Kosovë?

4 PË. Po.

5 PY. Do thonit e vështirë, apo e pamundur?

6 PË. Do të ishte e pamundur pa mjete komunikimi të sigurta, të  
7 diskutoje çështje delikate, veçanërisht ushtarake, sa i takon  
8 transportit të armëve dhe gjëra të këtij lloj, sepse serbët,  
9 siç e thamë më herët, kishin operacione shumë të sofistikuara  
10 dhe udhëheqja e UÇK-së ishte në dijeni për këtë.

11 PY. Nga rendi kronologjik, shohim kabllogramin e tretë, që  
12 është 10 marsi 1999, që është pas Rambujesë. Nëse është e  
13 mundur, do të doja të shihnim një a dy paragrafë të këtij  
14 kabllogrami.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Materiali P1080. Më jepni një  
16 çast, ju lutem. Lutem të shkojmë në faqen 3 në fund.

17 PY. Shohim dy paragrafët e fundit. I pari s'ka numër, por  
18 tjetri ka 5. Ka të ngjarë që paragrafi pararendës të jetë në  
19 vazhdim të paragrafit të faqes tjetër. Për ta përfunduar  
20 fjalinë, tre fjalët e para janë:

21 "Zëvendësimi i..."

22 Pra, është kështu:

23 "Zëvendësimi i Azem Sylës si komandant i UÇK-së nga  
24 Sylejman Selimi është nga manifestimet, manifeston pra  
25 mosmarrëveshjet e brendshme. Për më tepër, Krasniqi dhe



1 anëtarët e tjerë të krahut politik kanë ardhur të përfaqësojnë  
2 UÇK-në në sytë e botës, Selimi dhe Remi dhe anëtarë themelues  
3 të tjerë UÇK-së që kërkojnë vëmendjen e medias. Një nga  
4 problematikat më të mëdha është ajo që UÇK-ja kërkon që është  
5 riorganizimi, por në fakt në të vërtetë, kjo është një  
6 përpjekje e udhëheqjes për të krijuar një Shtab të  
7 Përgjithshëm efektiv për të kontrolluar këto njësite, apo këto  
8 formime të UÇK-së të shpërndara në të gjithë Kosovën. Pra,  
9 përpjekjet duken të kenë qenë vetëm pjesërisht të suksesshme  
10 sepse komandantët e zonave e kanë bërë të qartë që duan të  
11 kenë pavarësi operacionale”.

12 Tani, a pajtoheni me mua që jemi në periudhën e marsit,  
13 është 14 ditë para bombardimit të NATO-s, dhe sipas vlerësimit  
14 të KDOM-it ka rezistencë të konsiderueshme nga ana e  
15 komandantëve të UÇK-së që të pranojnë autoritetin e Shtabit të  
16 Përgjithshëm atëherë? Pra, po shoh çfarë keni thënë. Ju keni  
17 thënë që:

18 “... Krasniqi dhe anëtarë të tjerë të krahut politik kanë  
19 ardhur të përfaqësojnë UÇK-në në sytë e botës, diçka që  
20 zemëron Sylejman Selimin, Remin dhe themelues të tjerë të UÇK-  
21 së të rinj që kërkojnë vëmendjen e medias”. Vazhdon pastaj,  
22 “problemi tjetër është që UÇK-ja kërkon riorganizim,” por  
23 pastaj thuhet, “edhe atëherë, komandantët e zonës nuk ishin të  
24 kënaqur me mënyrën se si Shtabi i Përgjithshëm komunikonte me  
25 ndërkombëtarët, sepse ata në terren mendonin se ata ishin

1 personat që po e bënin luftën e vërtetë.”

2 PË. Nuk po ju kuptoj.

3 PY. Ajo që keni thënë ju në pjesën e parë të këtij paragrafi,  
4 është dhe, nuk e di a pajtoheni me mua, ju keni thënë që  
5 komandantët në terren, komandantët e zonave në terren, nuk  
6 ishin të kënaqur që të ishte Shtabi i Përgjithshëm, t'i  
7 përfaqësonte ata në sytë e komunitetit ndërkombëtar dhe t'ju  
8 njihej kjo kur në të vërtetë ata ishin personat që po e bënin  
9 luftën operative në terren, a pajtoheni me mua për këtë?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe në pjesën e dytë të paragrafit ju po thoni që,  
12 ndonëse UÇK-ja pretendon se është në proces “riorganizimi”,  
13 dhe kjo është në thonjëza, në të vërtetë, ajo që ka ndodhur në  
14 realitet është që Shtabi i Përgjithshëm po përpiqet të krijojë  
15 dhe të jetë efektiv dhe të kontrollojë, ajo që ju përshkruani  
16 “formacione të shpërndara të UÇK-së në gjithë Kosovën”,  
17 pajtoheni?

18 PË. Po.

19 PY. Pra po përpiqeshin, por jo se ia dolën mbanë, kështu?

20 PË. Nuk ia dolën mbanë tërësisht.

21 PY. Dhe ju vazhdoni dhe thoni që, kjo përpjekje ka qenë vetëm  
22 pjesërisht e suksesshme, sepse është e qartë që komandantët e  
23 zonave kanë ruajtur pavarësinë operative, kështu?

24 PË. Po, kështu.

25 PY. Dhe tani afrohemë tek bombardimet e NATO-s, kështu?

1 PË. Më lejoni të bëj një shtjellim. Po ashtu ka pasur një  
2 lloj zemërimi apo pakënaqësi, mes disa komandantëve të zonave  
3 për faktin se Shtabi i Përgjithshëm dhe figurat e tyre  
4 udhëheqëse po bëheshin shumë të njohur në Prishtinë, po  
5 bëheshin pjesë e elitës në shoqërinë e shqiptarëve të Kosovës,  
6 dhe kjo shoqëri, mendoj unë, nuk i njihte të gjithë anëtarët e  
7 Shtabit të Përgjithshëm, por ama gazetarët edhe gazeta  
8 kryesore *Koha Ditore*, dhe gazeta të tjera si *Zëri*, mbulonin  
9 UÇK-në në mënyrë shumë efektive, dhe kishin lidhje shumë të  
10 ngushta me UÇK-në dhe e njihnin mirë UÇK-në. Dhe po flisnim me  
11 persona në drejtorinë politike, se drejtoria politike ishte  
12 ajo që komunikonte me ndërkombëtarët.

13 Dhe sigurisht, në atë moment kohor, ndërkombëtarët nuk  
14 ishin vetëm KDOM-i i SHBA-së apo i BE-së. Ndërkombëtarët ishin  
15 edhe MVK-ja, Misioni i OSBE-së pra, i Dërguari i Posaçëm i BE-  
16 së, apo i Dërguar i Posaçëm i SHBA-së.

17 PY. A e dini nëse kishte komunikime në atë kohë me NATO-n të  
18 drejtpërdrejta, flas mes UÇK-së dhe NATO-s?

19 PË. Kam dëgjuar diçka të tillë, por nuk mund të flas me  
20 siguri.

21 PY. Por tani, kur e kthen kokën pas, a është diçka që do ta  
22 pranoje?

23 PË. Po, po. Do ta pranoja. Besoj se kjo ka ndodhur ose në  
24 Shqipëri, ky komunikim, ose në Perëndim.

25 PY. Dhe me sa kuptoni ju, gjatë kësaj kohe, z. Veseli ka qenë

1 jashtë Kosovës, ku ushtronte funksionin e vet në lidhje me  
2 komunitetin ndërkombëtar, kështu?  
3 PË. Po.  
4 PY. Faleminderit. Kalojmë te paragrafi 6. Z. Krasniqi, z.  
5 Buja, z. Bashota, dhe thoni Zyrap, ka një gabim emri këtu,  
6 ortografik. Kanë thënë që "problemi kryesor është për të marrë  
7 pëlqimin për marrëveshjen e Rambujesë, është çështja e të  
8 ardhmes së UÇK-së. Kundërshtimi që bëjnë komandantët e zonave  
9 për Rambujenë si Remi dhe Lushtaku", po këtu mund të shtojmë  
10 dhe Haradinaj, dhe të tjerë, "mbase buron për shkak të frikës  
11 së që kanë ata se mbase demobilizimi do të kushtojë influencën  
12 që kanë dhe pushtetin. Ndërsa personat si Thaçi, Krasniqi dhe  
13 Buja që janë të kahut politik, mund të mbështeten në punën e  
14 kompetencat dhe influencës si anëtarë të lartë të qeverisë së  
15 përkohshme të Kosovës, komandantët e zonave -- kanë frikë se  
16 do të humbasin pushtet në momentin që do të dorëzojnë armët.  
17 Sepse ata duan të vazhdojnë të kenë një organizim të UÇK-së,  
18 mbase ata nuk -- anëtarët e kahut politik si Krasniqi dhe  
19 Buja, të UÇK-së, po përpiqen të gjejnë një kompromis që do të  
20 ruajë, që do të mundësojë bashkimin e UÇK-së sidomos pas  
21 grushtit që ka ndodhur gjatë Rambujesë."

22 Ndalojmë këtu, sepse këtu ka shumë informacion në këtë  
23 paragraf. Megjithatë, në përmbledhje të këtij paragrafi, që  
24 sapo lexova, dhe në thelb ajo çfarë thuhet është që ju po  
25 përshkruani atë çfarë ka ndodhur në Rambuje si një grusht nga

1 komandantët e zonës në mënyrë të tillë që të hiqte autoritetin  
2 ose kompetencat Shtabi i Përgjithshëm si përfaqësues ose  
3 ndërlidhës me bashkësinë ndërkombëtare, këtë thoni, domethënë,  
4 ka qenë një grusht i përbashkët i komandantëve të zonave.  
5 PË. Motivimi për grushtin nga komandantët e zonave, ishte  
6 kundërshtimi i tyre, pra i komandantëve të zonave që të  
7 hartonin tekstet që kishin parë përpara Rambujesë, dhe që  
8 ishin tekste të cilat ishin hartuar kryesisht nga Chris Hill,  
9 që nuk çonte në pavarësinë e Kosovës, por që e poziciononte  
10 Kosovën si brendapërbrenda Serbisë, si një njësi  
11 vetëqeverisëse, me kompetenca dhe me autoritete për menaxhimin  
12 e vetes.

13 Kishte shumë komandantë të zonave të cilët pajtoheshin me  
14 Adem Demaçin, i cili ishte një figurë shumë ikonë e shoqërisë  
15 së Kosovës, për shkak të asaj çfarë ai kishte bërë ndër vite  
16 dhe për vuajtjet e tij për vite të tëra në burgje. Ata besonin  
17 se duhet që të vazhdonin që të luftonin dhe besonin që  
18 pavarësia e Kosovës duhet që të sigurohej përmes forcës së  
19 armëve dhe jo përmes negociatave, kryesisht për faktin se ata  
20 në të vërtetë nuk është se e besonin bashkësinë ndërkombëtare.  
21 Për shembull, në qoftë se do të lexoni gjithë tekstet e  
22 kabllogrameve, besoj që do të gjeni ndërmjet të tjerash edhe  
23 disa prova lidhur me këtë. Domethënë, ata nuk është se ishin  
24 plotësisht të bindur që edhe Shtetet e Bashkuara do i shkonin  
25 deri në fund kësaj çështjeje dhe do e mbështesnin Kosovën deri

1 në pavarësinë e plotë të saj, dhe sipas tyre, garancia më e  
2 mirë për të siguruar pavarësinë ishte që të dëboheshin serbët  
3 nga Kosova me forcën e armëve.

4 PY. Këtë mendonin komandantët e zonave që i përkisnin këtij  
5 grupi, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Ndërkohë që ata që ishin të përfshirë në negociatat  
8 politike e kishin të qartë, e kishin kuptuar, që pa  
9 mbështetjen e Amerikës lufta për pavarësi ishte thujse zero,  
10 apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Domethënë me fjalë të tjera, amerikanët kishin epërsi ose  
13 kishin rol vendimtar sa i takon pavarësisë së Kosovës?

14 PË. Përgjithësisht jam dakord me juve.

15 PY. Megjithatë, individët brenda Shtabit të Përgjithshëm  
16 ishin në një vend të vështirë, ishin mes zjarrit, nga njëra  
17 anë kish komandantët e zonave, nga ana tjetër kishin  
18 komunitetin ndërkombëtar?

19 PË. Besoj se është e drejtë të thuhet që në Shtabin e  
20 Përgjithshëm personat e tillë si z. Thaçi, persona shumë të  
21 zgjuar, e kishin kuptuar që diskutimet, bisedat në Rambuje  
22 përpara takimit përfundimtar në fund në Paris, ku u nënshkrua  
23 kontrata, e kishin kuptuar drejt se cila ishte rruga përpara.

24 PY. A mund të vazhdojmë në faqen 7 të këtij dokumenti, sepse  
25 kjo është hera e parë ku në kablllograme përmendet Kadri

1 Veseli. Duket që edhe këtu ju nuk e keni informacionin që  
2 ishte, që çfarë funksion kishte. Ju thoni këtu që e dini:  
3 "... vetëm se ai ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm  
4 dhe shërben si, ka shërbyer si ekspert në konferencën e  
5 Rambujesë".

6 Apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Ju jeni personi që e keni shkruar këtë kabllogram, apo  
9 jo?

10 PË. Po.

11 PY. Pra, ju e dinit që edhe pse z. Veseli nuk kishte ardhur  
12 nga Kosova për në Rambuje, por kishte udhëtuar nga një vend  
13 tjetër drejt Rambujesë, ju e dinit që roli i tij ishte  
14 këshillues sa i takon konflikteve që, dhe vështirësive që  
15 kishte Shtabi i Përgjithshëm që t'i mbanin nën kontroll  
16 komandantët e zonës ndërkohë që merrnin pjesë në negociata me  
17 trojkën, me Shtetet e Bashkuara, e të tjerë?

18 PË. Z. Emmerson, kam përshtypjen që po shkoni shumë larg me  
19 këtë çfarë po thoni. Unë nuk e dija sot dhe nuk e dija as  
20 atëherë, se çfarë roli këshillues kishte ai në Rambuje.

21 PY. Ajo çfarë po them unë është që ju e dini që delegacioni  
22 pra, anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, të delegacionit,  
23 ishin në një pozicion të vështirë. Se nga njëra anë ishin  
24 komandantët e zonës, nga ana tjetër ishte bashkësia  
25 ndërkombëtare, që po ushtronin tryzni për një zgjidhje përmes

1 negociatave.

2 PË. Po.

3 PY. Dhe ju thoni në kabllogram që ata ishin në një vështirësi  
4 faktike reale në mënyrë të tillë që të mos shpërbënin unitetin  
5 ose të mos ta shpërbënin gjithë UÇK-në.

6 PË. Po.

7 PY. Megjithatë, në këtë kohë ju e dinit që Kadri Veseli,  
8 këshillonte, pra jashtë dhomës së negociatës, jashtë vendit ku  
9 bëheshin negociatat, domethënë, ai thjesht këshillonte. Dhe  
10 sipas kabllogramit i takon që ju e dinit që ai ka qenë aty,  
11 apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Po nga e more vesh ti këtë gjë? Nga e keni marrë vesh që  
14 z. Veseli ka qenë në Rambuje?

15 PË. Më është thënë nga një nga anëtarët e delegacionit.

16 PY. Nga anëtari i delegacionit të UÇK-së apo amerikan?

17 PË. Nga anëtarët e delegacionit të UÇK-së.

18 PY. A e dini ju në qoftë se ka pasur këshilltarë nga ana  
19 amerikane?

20 PË. Po.

21 PY. A e dini ju që këshilltarët nga ana amerikane kanë folur  
22 me këshilltarët e UÇK-së?

23 PË. E dija, megjithatë më lejoni të them dhe një herë tjetër  
24 që unë nuk kam qenë gjatë gjithë kohës në Rambuje.

25 PY. Megjithatë, përderisa ju thoni që z. Veseli ka pasur



1 funksion këshilltari, i takon që besoj që ka pasur dhe Amerika  
2 persona që kanë luajtur këtë rol, domethënë që kanë qenë  
3 këshilltarë?

4 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kundërshtoj.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim]

7 PY. A e pranoni që edhe amerikanët kishin këshilltarë? Na e  
8 thatë këtë gjë më përpara?

9 PË. Sigurisht që po.

10 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kundërshtojmë, sepse e  
11 kërkon për spekulime.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
13 bëjeni ndryshe pyetjen.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim]

15 PY. Delegacioni amerikan, a kishte këshilltarë? Po, apo jo?

16 PË. Sigurisht që kishte.

17 PY. Dhe këta këshilltarë, a ishin persona që përfshinin  
18 njerëz që kishin njohuri për çështjet e zbulim-kundërzbulimit?

19 PË. Nuk e di këtë gjë.

20 PY. Pra, ju nuk e dini në qoftë se këshilltarët amerikanë  
21 kanë ndërvepruar me këshilltarët e UÇK-së jashtë dhomë, ose  
22 jashtë vendit ku bëheshin negociatat?

23 PË. Nuk e di, nuk kam qenë aty.

24 PY. Në rregull. Nuk ka problem. Megjithatë, domethënë  
25 pritshmëria e zakonshme do ishte që të kishin folur këta

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 82

1 njerëzit që kanë qenë në pozicione këshilluese, apo jo?

2 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kundërshtoj.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Le të kalojmë në seancë private  
5 për pak.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

7 Sekretare, na kaloni në seancë private për mbrojtjen e  
8 dëshmitarit.

9 [Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 83

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 84

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 85

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 86

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 87

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 88

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
10 jemi në seancë publike.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim]

12 PY. Atëherë, në transkript thuhet më 5 qershor, sipas pyetjes  
13 së Misetic, megjithatë Pentagoni parashikonte që ndërkohë që  
14 700.000 pak a shumë shqiptarë të Kosovës që ishin detyruar që  
15 të dilnin nga kufijtë e vendit dhe ishin detyruar që të  
16 shkonin në Shqipëri, në Mal të Zi, në Maqedoni, Pentagoni  
17 parashikonte që kur ata të ktheheshin mbrapsht serbët nuk do e  
18 kishin të thjeshtë që të jetonin në rajonet përkatëse. Dhe  
19 kishte mundësi që serbët të largoheshin, sepse do të kishin  
20 frikë nga hakmarrja, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Domethënë, kështu e kuptonte situatën Pentagoni, dhe këtë  
23 priste që të ndodhte, apo jo?

24 PË. Po. Më lejoni të shtoj edhe këtë. Për shembull për mua  
25 pritshmëria ose parashikueshmëria që do të ndodhte kjo ishte

1 mbështetur në përvojën e Bosnjës pas marrëveshjes së Dejtonit,  
2 kur njerëzit u kthyen në shtëpitë e tyre. Dhe duke marrë  
3 parasysh nivelin e jashtëzakonshëm të shkatërrimit, duke marrë  
4 parasysh nivelin e asaj çfarë kishin shkaktuar forcat e  
5 sigurisë serbe, dhe madje edhe vrasjet, bastisjet, po ashtu  
6 edhe vrasjet e kafshëve, ishte absolutisht shumë e vështirë që  
7 të mendohej që personat që kishin vuajtur mbi kurrizin e tyre  
8 tmerre të tilla dhe që ishin detyruar që të shkonin ose nëpër  
9 male, ose të kalonin kufijtë dhe të shkonin në këto tre shtete  
10 që ju përmendët më herët, do ishte e pamendueshme që kur të  
11 ktheheshin pas këta njerëz, pas gjithë atyre që kishin kaluar,  
12 nuk do të merrnin hak në qoftë se do t'u jepej mundësia. Në  
13 veçanti, ndaj komshinjve ose fqinjëve serbë që ata besonin që  
14 kishin përfituar prej tyre, ose kishin marrë pjesë në tmerre  
15 të tilla, ose që kishin ndihmuar forcat e sigurimit serb.

16 Kështu që do ishte absolutisht diçka e kuptueshme në  
17 situata të tilla, një reagim i tillë. Pra, ndërkohë në  
18 bashkësinë ndërkombëtare, njerëzit e KFOR-it, të gjithë të  
19 tjerët e prisnin një gjë të tillë dhe mendonin që kjo do ishte  
20 situata.

21 PY. Faleminderit. Z. Misetic ju pyeti që pse mendonit që do  
22 ishte kjo situata. Dhe ju në përgjigje thoni:

23 "Kryesisht për shkak të faktit që forcat serbe dhe  
24 paramilitarët serbë për vite të tëra, nën komandën e  
25 drejtpërdrejtë të Milosheviqit kishin kryer politika brutale

1 të tmerrshme kundër popullsisë shqiptare, duke djegur fshatra  
2 të tërë, duke plaçkitur shtëpitë e tyre dhe duke vrarë njerëz.  
3 Objekti ishte i qartë, ishte objekti i Milosheviqit ishte që  
4 të detyronte shqiptarët që të largoheshin dhe të krijonte një  
5 situatë demografike të balancuar që do ta bënte më të thjeshtë  
6 për serbët që të kishin kontroll mbi Kosovën.

7 Megjithatë, më lejoni të them edhe një herë që, që prej  
8 vitit 1989 se situata ishte absolutisht e tmerrshme. Ne e  
9 kishim parashikuar që kur NATO-ja të futej në territorin e  
10 Kosovës, ekzaktësisht e njëjta hakmarrje të mund të përdorej  
11 edhe nga shqiptarët e Kosovës ndaj serbëve.”

12 Tani, do t'ju kërkoj që të më bëni disa sqarime nëse  
13 është e mundur. Për t'ju dhënë pak kontekst sa i takon  
14 kronologjisë së mëvonshme. Nuk e kam fjalën këtu për atë çfarë  
15 ka ndodhur para dhjetë viteve, por dy vite nga konflikti. Për  
16 këtë e kam fjalën kryesisht.

17 Atëherë, së pari, ka një lloj mosmarrëveshje sa i takon  
18 përshkrimit të Operacionit Paktoi, në qoftë se përshkrimi për  
19 këtë operacion formal ishte i saktë apo jo. Ka pasur ca  
20 mosmarrëveshje besoj përmes sa i takon inteligjencës  
21 australiane në qoftë se ekzistonte ky operacion, ose si ishte  
22 organizuar ky operacion, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Ka pasur ca mosmarrëveshje sa i takon serbëve të cilët  
25 kanë përdorur formacionin e patkoit nga pjesa verilindore, në

1 mënyrë që të vazhdonin fshat pas fshati për të shkaktuar  
2 terror për të shkaktuar probleme, shkatërrime, me njerëzit të  
3 cilët do kalonin në kufijtë e Shqipërisë, Kosovës [Sipas  
4 përkthimit], Malit të Zi, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe ata i quajtn ato operacione Operacioni Patkoi,  
7 thjesht për të kategorizuar ose për të përshkruar një fushatë  
8 sistematike të krimeve, apo jo?

9 PË. Po.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E përmendët  
11 një herë këtë, z. Emmerson. Nuk ia vlen të vazhdojmë të  
12 diskutojmë një çështje të cilën e kemi trajtuar.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] E kemi përmendur, por nga ana  
14 tjetër nuk kemi bërë ndonjë krahasim në mënyrë të tillë që  
15 juve ta keni të qartë në qoftë se nuk ka ndonjë tjetër arsye,  
16 një shpjegim i tillë, që të shikohen datat, pjesët, njëra pas  
17 tjetrës, në mënyrë të tillë që të kemi një panoramë më të  
18 qartë të situatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është e  
20 nevojshme që të mund të përsëriten gjërat.

21 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam një  
22 koment për procesverbalin. Do kemi diskutime pak më vonë, sa i  
23 takon efikasitetit të gjykimit përsëri. Sepse një pjesë e mirë  
24 e pyetjeve që po bëjnë kanë të bëjnë me fakte që janë të  
25 gjykuara.

- 1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull. Vazhdojmë më andej.
- 2 PY. Pas masakrës së Reçakut, ka qenë politikë e Departamentit  
3 të Shtetit Amerikan, siç është deklaruar në mënyrë publike nga  
4 Madeleine Albright, që prej marsit të 1998, dhe do të citoj  
5 këtu, ta shohim në qoftë se ju kujtohet kjo, ky citim apo jo,  
6 që: "Ne nuk do të qëndrojmë duarkryq dhe nuk është se do  
7 shikojmë autoritetet serbe të bëjnë në Kosovë atë çfarë kanë  
8 bërë në Bosnjë." Ju kujtohet kjo, apo jo?
- 9 PË. Unë e kam thënë këtë?
- 10 PY. Jo, jo. E ka thënë Madeleine Albright, a ju kujtohet kjo?
- 11 PË. Po, më kujtohet.
- 12 PY. Pra, është e qartë për të gjithë besoj, që Shtetet e  
13 Bashkuara po shikonin me sy hapur, ishin vigjilentë ndaj asaj  
14 çfarë po ndodhte, dhe sigurisht që shpata e Demokleut ishin  
15 mbi kokat e serbëve, apo jo?
- 16 PË. Po.
- 17 PY. Dhe shpata e Demokleut ishte ndërhyrja e NATO-s në  
18 Kosovë, apo jo?
- 19 PË. Po.
- 20 PY. Në rregull. Tani, fushata serbe fillimisht u krye në  
21 mënyrë të tillë që të promovoheshin objektivat e Serbisë pa  
22 provokuar ndërhyrje të drejtpërdrejtë të NATO-s?
- 23 PË. Po.
- 24 PY. Domethënë, midis Milosheviqit dhe komandantëve po  
25 mundoheshin si fillim, domethënë, që të mund të krijohej një

1 lloj rrugëdaljeje.

2 PË. Po, kishte një përshkallëzim të ngadaltë.

3 PY. Ndërkohë që po afrohej bombardimi i NATO-s, na e  
4 shpjeguat këtë më përpara në fakt, megjithatë do t'i kthehemi  
5 dhe një herë taktikave që janë përdorur. Megjithatë, me pak  
6 fjalë, JNA-ja bombardonte një fshat të caktuar, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Pastaj linin një korridor të caktuar për fshatarët për  
9 t'u larguar, dhe pastaj PJP-ja dhe forcat paraushtarake të  
10 parregullta, qoftë ato zyrtarë dhe jozyrtarë, futeshin --

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,  
12 këto pyetje nuk ka lidhje fare me dëshminë e dhënë nga ky  
13 dëshmitar, nuk kanë të bëjnë fare as me pyetjet që ka bërë  
14 Prokuroria. Këto janë kundërpjetje, kështu që pyetjet tuaja  
15 duhet të kenë lidhje me pyetjet e Prokurorit.

16 E kemi dëgjuar një herë këto gjëra, nuk është e nevojshme  
17 t'i dëgjojmë për të disatën herë. Po bëni pyetje të cilat nuk  
18 kanë lidhje me pyetjet e Prokurorisë. Ai ka dhënë dëshmi për  
19 shumë gjëra të tilla, por jo pikërisht për këtë që po pyesni  
20 juve, z. Emmerson.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do përfundoj deri në orën 13.00.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju siguroj që nuk po humb kohë  
24 kot.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E vendosim ne

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 95

1 në qoftë se po humbni kohë kot apo jo.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë, thjesht për të qenë të  
3 qartë --

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mikrofoloni  
5 juaj është i fikur.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, ky mikrofoloni tjetër është i  
7 ndezur, po ndoshta nuk më dëgjoni. Po ndez mikrofolonin tjetër.  
8 Më dëgjoni tani?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të gjitha kundërpyetjet kishin të  
11 bënin me komentet që ka bërë dëshmitari, pra deri në ç'skallë  
12 kur u kthyen personat, ata do të kishin mundësi, do të bënin  
13 të mundur që të ndodhnin, për shembull, ndëshkime ose të  
14 përdornin dhunë kundër serbëve. Pra, një që pa patur nevojën  
15 për bashkërendimin e UÇK-së. Kjo është puna, kjo është gjëja  
16 të cilën unë po them tani. Pra, ishte i justifikuar apo jo,  
17 dhe kjo nuk ka të bëjë dhe nuk mund të jetë e kufizuar me atë  
18 që ka thënë ose jo dëshmitari në dëshminë e vet.

19 Por gjithsesi, kjo çështje është shumë e rëndësishme dhe,  
20 me gjithë respektin ndaj jush, ne nuk mund ta themi që kjo nuk  
21 është relevante, por është edhe pjesa e asaj gjëje që kemi  
22 thënë. Pra, edhe e kemi dëgjuar dhe mos na humbisni kohën, dhe  
23 nga ana tjetër që nuk është relevante. Kështu që -- apo e  
24 rëndësishme, kështu që ju lutem më shpjegoni.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka mundësi

1 që t'i mbyllni kundërpyetjet tuaja se e keni zgjatur shumë?

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kam thënë shumë herë që do ta  
3 përfundoj deri në pushimin e drekës.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe ju kemi  
5 dhënë shumë kohë për të cilën nuk besoj që keni patur nevojë.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do të mbaroj ndoshta për 15  
7 minuta.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, 15  
9 minuta kohë keni.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në fakt është shumë e rëndësishme  
11 se jemi dhe në seancë publike dhe dëshmitari mund të na japë  
12 data dhe fakte në lidhje me këto detaje se ka informacionin.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Detajet po i  
14 jepni ju, jo dëshmitari.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë po i shpjegoj gjërat dhe ai  
16 mund të na thotë nëse është apo jo dakord me atë që them unë  
17 se pse këto gjëra pikërisht ndodhin në kundërpyetje.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni 15  
19 minuta kohë.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim]

21 PY. Gjatë asaj periudhe, siç e thashë përpara se të më  
22 ndërprisnin, pra, ata rrethonin një fshat, e bombardonin, dhe  
23 pastaj dërgonin të gjithë paramilitarët që të vrisnin gjithë  
24 gjënë e gjallë, të digjnin të gjithë shtëpitë, të gjithë arat,  
25 të prishnin makineritë e ndryshme, pra çdo gjë që kishin



1 fermerët, bujqit, apo jo? Pra çdo lloj jete që ekzistonte?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe ka në fakt dokumente të qarta të ushtrisë serbe që  
4 synimi i tyre dhe konfirmon që politika e tyre ishte që t'i  
5 digjnin, të bënin shkumb e hi të gjitha fshatrat, apo jo?

6 PË. Ashtu është.

7 PY. Dhe me ç'kuptuat ju, ata e bënin këtë në një fshat, dhe  
8 pastaj kalonin te fshati tjetër që të bënin pikërisht të  
9 njëjtën gjë, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe kjo në mënyrë që njerëzit të largoheshin.

12 PË. Po.

13 PY. Dhe ndërkohë që i afrohem bombardimit të NATO-s, kemi  
14 edhe masakrën e Reçakut, në janar, apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Edhe pse Milosheviqi u përpoq të thoshte që ky ishte në  
17 fakt një operacion të cilin e kishte bërë UÇK-ja, kishte  
18 fotografi që u bënë gjerësisht nga mediat ndërkombëtare, apo  
19 jo? Të asaj që ne pamë nga masakra e Reçakut, të cilën e pamë  
20 të transmetuar në të gjithë botën?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe për këtë arsye pati shumë ndërkombëtarë që shkuan të  
23 inspektonin vendngjarjen.

24 PË. Po.

25 PY. Dhe ndërkohë që autoritetet serbe nuk lejuan Prokurorin e

1 TPNJ-së që shkonte atje. E dinit këtë?

2 PË. Po.

3 PY. Pra, pengesa që iu bë TPNJ-së për hetimin, atëherë  
4 ndoshta mund të thoni që kjo ishte dhe arsyeja se pse kjo  
5 masakër bëri që SHBA-ja të merrte masa për ndërhyrje.

6 PË. Kjo ishte ajo pika që i bëri ata që të ndërhynin.

7 PY. Sepse Madeleine Albright në fakt tha atëherë që ishte  
8 arma që i duhej Uashingtonit pikërisht për NATO-n që të  
9 ndërhynte.

10 PË. Çoi në përpjekjen e fundit për ta zgjidhur krizën në  
11 formë politike që kishte çuar tek Rambujeja në Paris. Dhe  
12 fakti që Milosheviqi nuk bindte dakord dhe nuk ra dakord për  
13 kushtet në Paris.

14 PY. Dhe përveçse po i dëbonin njerëzit me forcë edhe me anën  
15 e frikës, ju a e dinit që forcat serbe po organizonin edhe  
16 trena në mënyrë që në formë sistematike të transportonin  
17 shqiptarë etnikë të Kosovës që t'i çonin civilët në kufi?

18 PË. Unë e kam marrë vesh këtë pasi kishte filluar fushata e  
19 bombardimit.

20 PY. Mijëra e mijëra njerëz u detyruan që të kalonin zonat e  
21 konfliktit ose në këmbë ose në automjetet e tyre, ose të  
22 organizuar nga trupat serbe ose të ruajtur prej tyre, është e  
23 saktë kjo?

24 PË. E saktë është.

25 PY. Duke lënë pas shtëpitë në të cilat në një të ardhme të

1 afërm nuk do të ktheheshin dot kurrë, sepse nuk kishin asgjë  
2 të gjallë tek e cila të ktheheshin, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. A mund të na tregoni pak për procesin e identitetit dhe  
5 pastrimet, përveç pastrimit etnik, a është e saktë që ata që u  
6 kaluan u detyruan të kalonin kufij të, atyre u merrnin edhe  
7 dokumentet e identifikimit, madje edhe targat e makinave?

8 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Është një pyetje e përbërë,  
9 kundërshtoj.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e pranoj.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim]

12 PY. A është e vërtetë kjo?

13 PË. Po.

14 PY. Pra, është e vërtetë që në fakt edhe certifikatat e  
15 pronësisë që iu morën u shkatërruan dhe u bënë përpjekje edhe  
16 për regjistrin civil, atë të lindjeve, pra. Ky quhet pastrim i  
17 arkivave.

18 PË. E kam dëgjuar këtë.

19 PY. Dhe kur u bë e qartë që NATO-ja po përgatitej për të  
20 ndërhyrë, atëherë Seselj, që ishte i dyti të themi në komandë  
21 pas Milosheviqit, kur u tha pra që NATO-ja do të ndërhynte në  
22 formë të drejtpërdrejtë, dhe u tha që "shqiptarët e Kosovës  
23 nuk do të ekzistonin më kurrë"? E mbani mend këtë shprehje?

24 PË. Nuk e mbaj mend.

25 PY. A e dini që kur filloi bombardimi i NATO-s, Serbia mbylli

1 kufirin me Shqipërinë, Malin e Zi, dhe Maqedoninë që  
2 shqiptarët e Kosovës që kishin mbetur në Kosovë të mos arrinin  
3 dot të largoheshin dot nga Kosova?

4 PË. E di që u mbyllën kufijtë, i mbyllën kufijtë.

5 PY. Dhe për rrjedhojë, qytetarët nuk mund të dilnin nga  
6 Kosova.

7 PË. Por njerëzit dolën nga Kosova.

8 PY. Pasi u mbyllën kufijtë?

9 PË. Ju sapo thatë përpara disa minutash që dhjetëra mijëra  
10 shqiptarë u larguan dhe kaluan në Shqipëri, Maqedoni, Mal të  
11 Zi, nëpërmjet kufijve.

12 PY. Por pasi u mbyllën kufijtë, si u interpretua kjo nga  
13 Uashingtoni? Pra, në fakt nuk bëhej më e mundur kalimi i tyre  
14 në kufi?

15 PË. Nuk e di, se unë nuk isha në Uashington.

16 PY. Sepse kjo ishte periudha e fushatës më intensive kundër  
17 civilëve në Kosovë, apo jo?

18 PË. Mënyra se si e kuptonim, si e kishim kuptuar ne, dhe unë  
19 flisja me telefon satelitor me një sërë komandantësh zonash,  
20 në mënyrë që të merrja sa më shumë informacion në lidhje me  
21 situatën brenda vendit. Dhe Clark, komandant i forcave të  
22 NATO-s ishte tmerrësisht i interesuar edhe për -- për këtë dhe  
23 për aspektet humanitare.

24 Dhe, unë kisha përshtypjen që fushata serbe ishte  
25 intensive, fushatë për të larguar shqiptarët nga provinca e

1 Kosovës. Ishte intensive, dhe e vazhdueshme, dhe që vazhdoi  
2 gjatë gjithë periudhës së bombardimit.

3 PY. Dhe në një fjali, çfarë lidhje ka kjo me dëshminë që keni  
4 dhënë ju për pritshmërinë e Pentagonit që pasi të hynte KFOR-  
5 it dhe njerëzit të ktheheshin në Kosovë, ata mund të ishin të  
6 justifikuar të hakmerreshin kundër fqinjëve të tyre serbë?

7 PË. Nuk e kuptoj pyetjen tuaj, të jem i singertë në fakt.

8 PY. Në rregull, atëherë. Do të kaloj tek diçka tjetër.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në këto pesë minuta të fundit  
10 kohë që na kanë mbetur, le të shfaqim një video të asaj  
11 periudhe. Në fakt të datës 10 prill, dy javë pasi kishte  
12 filuar bombardimi, në luginën e Baicës, ku kemi refugjatë, një  
13 kolonë refugjatësh që kalon nga Baica në Vuçak dhe në malet e  
14 Berishës. Është një video me dy minuta kohë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, një  
16 sekondë.

17 Për këtë dëshironi të flisni, Prokuror?

18 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Po, patjetër, sepse nuk jam  
19 i qartë për çfarëdo lloj pyetjesh që do bëhen.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Sepse dua të pyes nëse njeh  
21 dëshmitari dikë në video.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në lidhje me  
23 kë? Ju prisni që të shihni klientin tuaj atje?

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,

1 atëherë.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë, ju lutem nëse mund të  
3 shfaqim në ekran videon DKV01212 [Sipas përkthimit], ju lutem.  
4 PY. Është në fakt një video e shkurtër dhe pyetja do të jetë  
5 nëse njihni ndokënd në atë video që do të shikoni. Në fakt  
6 nëse mund të identifikoni z. Veseli. Dhe kjo ka të bëjë edhe  
7 me përgjigjet që ju keni dhënë për të identifikuar z. Veseli.  
8 Pra, janë dy javë pasi NATO ka filluar bombardimin.

9 Dhe që të jemi të qartë, siç e thashë edhe më herët, këtu  
10 kemi një kolonë që shkon nga -- refugjatësh që shkon nga Baica  
11 në Vuçak, është në perëndim, pra drejt maleve.

12 PË. Në perëndim të cilës zonë? Thatë Gjakovë?

13 PY. Jo, Gllogovc. Në fakt është në veri të Malishevës. Duke u  
14 drejtuar drejt maleve.

15 PË. Në rregull.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull. Dhe nuk ka as, nuk ka  
17 transkript. Dhe videoja nuk ka zë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
19 [Përkthim] Këtë video nuk do ta shfaqim për publikun.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull.

21 [Luhet videoincizimi]

22 "Sot është 8 prill 1999..."

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, të mos kemi  
24 fare zë për videon, në fakt.

25 [Luhet videoincizimi]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] A është e mundur që të kthehemi  
3 tek minutazhi 02:00 dhe ta mbajmë aty të fokusuar në ekran  
4 videon. 02:00, nëse mund kalojmë pak më përpara derisa të dalë  
5 individit në ekran. Ja ku është.

6 PY. Dhe besoj që ju mund të konfirmoni tashmë që ai është z.  
7 Veseli, apo jo? Meqenëse jeni takuar.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka mundësi  
9 që të dëshmojë dëshmitari dhe jo ju z. Emmerson?

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sepse  
12 dëshminë po e jepni ju, z. Emmerson.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pyetja është a e njeh dëshmitari,  
14 a e sheh që është z. Veseli.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pyetja është shumë e thjeshtë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja është  
18 sugjestionuese.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po ja, është e qartë që është z.  
20 Veseli në ekran.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do që ta  
22 parafrazosh pyetjen apo nuk do ta bësh fare pyetjen?

23 Atëherë do ta bëj unë pyetjen.

24 A sheh ndokënd që njeh në ekran?

25 Z. EMMERSON: [Përkthim]

1 PY. A është kjo ajo lloj skene që ju keni parë apo jo?

2 PË. Jo.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] A mund të kem kohë për të bërë dy  
4 pyetje që për shkak të kundërpjetjeve që bëri z. Emmerson?

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
6 [Përkthim] Në lidhje me çfarë?

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Në lidhje me pjesën e një  
8 deklaratë që u diskutua në seancë private. Kështu që më duhet  
9 që përgjigjen t'jua jap në seancë private.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dy pyetje?

11 Z. ROBERTS: [Përkthim] Dy pyetje e gjysmë. Dhe prandaj do  
12 t'ju lutesha të kalonim në seancë private.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në  
14 seancë private.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25



Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 105

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Tashmë jemi në seancë

24 publike.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni ndonjë

1 pyetje tjetër për të bërë, z. Prokuror?

2 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Po, në fakt kam, dhe nuk e  
3 di nëse mund t'i bëjmë këto pyetje pas pushimit të drekës, dhe  
4 besoj që do të kërkoj vetëm 15 minuta kohë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më duket e  
6 arsyeshme kjo gjë, kështu që fillojmë pushimin e drekës që  
7 tani dhe do të rikthehemi në orën 14.30.

8 Z. TULLY: [Përkthim] Thjesht për t'ju informuar,  
9 Gjykatës, që edhe unë do të kem nevojë për dy minuta kohë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

11 Jo, jo, jo.

12 Mund të largoheni.

13 Jo, nuk e di.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully,  
16 fjala për ju. Dhe jemi në seancë publike.

17 Z. TULLY: [Përkthim] Në seancë publike jemi? Mirë, s'ka  
18 gjë.

19 Atëherë, nëse mund të kërkoj leje nga Trupi Gjykses që ne  
20 të na lejohet që përgjigjen që kemi dhënë ditën e hënë, të  
21 kemi mundësi të japim informacion shtesë sot. Një dokument i  
22 cili ka numrin ERN 120266-120267, nga dhjetori i vitit 2021 në  
23 janar të vitit 2022. Dhe në fakt ne si Mbrojtje nuk na është  
24 thënë më parë, por na u dha dje dita pasi kishim dhënë  
25 përgjigjen tonë sipas afateve të caktuara gjyqësore. Është një

1 dokument prej dy faqesh dhe ka të bëjë me një kontakt ndërmjet  
2 ZPS-së dhe një anëtari, një familjari të dëshmitarit tjetër të  
3 radhës.

4 Ne nuk e kemi patur këtë më parë, kemi dhënë argumentet  
5 tona, parashtrimet tona, por për mendimin tonë, kjo ka të bëjë  
6 me një nga ato aludime që bëhet në atë rast. Dhe në mënyrë  
7 specifike ka të bëjë me faktin që mbështet argumentet,  
8 parashtrimet tona të Mbrojtjes në lidhje me z. Selimi. Dhe do  
9 të ishte relativisht e lehtë sepse është më pak se dy faqe në  
10 fakt. Dhe nëse mund t'ju sjellim në dy orët në vijim. Dhe ne  
11 nuk do të përsërisim asnjë nga ato parashtrimet që kemi bërë  
12 në dosje.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta  
14 dorëzoni deri në fund të ditës së sotme apo nesër?

15 Z. TULLY: [Përkthim] Besoj se deri sot do ta kryejmë këtë  
16 punë.

17 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] A mund t'ju japim përgjigje  
18 pas pushimit të drekës?

19 Z. TULLY: [Përkthim] Për mendimin tonë, ky është  
20 klasifikuar si një nga ato dokumente të rregullit 102(3) dhe  
21 ne besojmë që është e gabuar kjo.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

23 Z. TULLY: [Përkthim] Pra, ne mendojmë që meqenëse është  
24 dorëzuar si pjesë e rregullit 102(3) ne mendojmë që është e  
25 gabuar dhe duhet të kemi mundësinë që ta ofrojmë atë shtesë,

1 por do ta shikojmë dhe kjo nuk ka të bëjë në fakt me çështjen  
2 e gjykimit që kemi pasur përpara këtij rasti. Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z.

4 Ferdinandusse, mund të jepni koment në lidhje me këtë çështje  
5 menjëherë pas pushimit të drekës, dhe do të marrim vendimin  
6 përkatës. Ndërkohë seanca shtyhet deri në orën 14.30.

7 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

8 --- Seanca rifillon në orën 14.30

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z.

10 Ferdinandusse, keni ndonjë përgjigje sa i takon kërkesës së z.  
11 Tully?

12 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Nëse  
13 kundërpërgjigjet lidhen me aspektet që u trajtuan atëherë ne  
14 nuk kemi kundërshtime.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
16 çaktivizuar]

17 Me sa kuptoj nuk ka kundërshtime nga palët e tjera,  
18 atëherë kërkesa juaj për shtimin deri nesër pas përfundimit të  
19 orareve të punës.

20 Z. TULLY: [Përkthim] Edhe sot mund ta përfundojmë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, jo do ta  
22 lemë për nesër kur të mbarojë orari zyrtar.

23 Faleminderit.

24 Në rregull le të vijë dëshmitari në --

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,  
2 Dëshmitar.

3 Z. Byrnes, urojmë të keni pushuar ndopak.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit, por a mund të them  
5 diçka?

6 Ju kërkoj falje. Po përpiqesha të kontaktoja z. Emmerson  
7 se doja t'i thoja të fliste pak më ngadalë dhe në fakt misioni  
8 u përmbush me sukses. Faleminderit.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në fakt unë s'kam më pyetje për  
10 dëshmitarin, kështu që i shkoi dëm.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
12 Z. Ferdinandusse, pyetjet shtesë.

13 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit.

14 Pyetje vijuese nga z. Ferdinandusse:

15 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim]

16 PY. Dëshmitar, kam disa pyetje të tjera për ju. E di që ka  
17 qenë një ditë e gjatë. Pyetjet e mia kanë nevojë për përgjigje  
18 të shkurtra dhe pyetja ime e parë ka lidhje me takimin që keni  
19 pasur ju me z. Thaçi.

20 Më dëgjoni mirë?

21 PË. Po, mirë ju dëgjoj.

22 PY. Të hënën, avokati ju tha, ju foli për pozitën e z. Thaçi;  
23 ju tha - më falni - që më 28 tetor 1998 ka qenë hera e parë që  
24 jeni takuar me të. Dhe pasi ju bëri disa pyetje lidhur me këtë  
25 takim të parë ju tha:

1 "Pra, përshtypja juaj sa i takon rolit të z. Thaçi në UÇK  
2 është bazuar në takimet që keni pasur me të në fund të tetorit  
3 dhe në fillim të nëntorit. A është kështu?"

4 Përgjigja juaj ishte:

5 "Po, përshtypjet e para, kështu i pata".

6 Ju kujtohet?

7 PË. Po.

8 PY. Në deklaratën që i keni dhënë ZPS-së, ju keni thënë që e  
9 keni takuar Hashim Thaçin shkurtimisht pasi kishit shkuar në  
10 Kosovë në gusht në 1998. A ju kujtohet kjo?

11 PË. Jo, nuk më kujtohet.

12 PY. Atëherë unë po ju lexoj çfarë thuhet në atë paragraf.

13 "Shkurtimisht pasi mbërrita në Kosovë, në gusht 1998, u  
14 takova me Hashim Thaçin. Nuk e kisha idenë se kush ishte  
15 asokohe dhe ai nuk u prezantua as me emër në ato momente, por  
16 me kalimin e kohës në vjeshtën e '98 autoriteti i tij u bë  
17 diçka me e njohur..."

18 PË. Po, kështu ka qenë. Faleminderit.

19 PY. Ju po na thoni tani që për herë të parë e keni takuar z.  
20 Thaçi në fund të tetorit?

21 PË. Po. Më kujtohet çfarë i kam thënë ZPS-së dhe është e  
22 saktë.

23 PY. Pra, do jua bëj edhe një herë pyetjen: Në dëshminë tuaj  
24 po thoni që për herë të parë e keni takuar z. Thaçi në gusht  
25 të 1998 apo e keni takuar më vonë?

1 PË. Në gusht, pak pasi kisha mbërritur, por e theksova që unë  
2 nuk e njihja se kush ishte dhe ai as nuk u prezantua.

3 PY. Faleminderit. Një çast, ju lutem.

4 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

5 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Pyetja e radhës lidhet me Jakup Krasniqin. Avokati i z.  
7 Krasniqi ju pyeti për dallimin mes të moderuarve, grupit të  
8 moderuarve dhe radikalëve në UÇK. Dhe ju u pajtuar me atë që  
9 të moderuarit kërkonin që të kishin një pozitë, domethënë të  
10 ishin një grup i unifikuar dhe të kishin kontakte me LDK-në  
11 dhe ju u pajtuat me të se ju e kishit identifikuar z. Krasniqi  
12 si një nga personat që i përkiste grupit të të moderuarve. Ju  
13 kujtohet kjo?

14 PË. Po, më kujtohet.

15 PY. Në rregull. Do ju tregoj një botim të 15 tetorit 1998.

16 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Dhe për këtë i lutem  
17 Sekretares së Gjykatës të nxjerrë në ekran materialin 043677  
18 Ssipas përkthimit] si në anglisht edhe në shqip.

19 PY. Faleminderit. A mund ta lexoni? Ose më ndryshe.

20 PË. Mund ta lexoj në ekran, po.

21 PY. Atëherë të shohim diçka këtu. Në fillim thotë që është  
22 ekskluzive për Zërin e Kosovës, zëdhënësi dhe përfaqësuesi  
23 politik i UÇK-së, lexon sipër.

24 PË. Po.

25 PY. Titulli: "UÇK-ja përmes mekanizmave të saj ligjor e

1 ekzekutiv do të veprojë sipas ligjeve të luftës". Po i lexoj  
2 rreshtat e parë dhe po citoj:

3 "Është fatkeqësi, është për të ardhur keq që kjo luftë e  
4 lavdishme e këtij shekulli e zhvilluar në këto troje hasi në  
5 sy të verbër e veshë të shurdhër të subjekteve tona politike  
6 të intelektualëve dhe profesionistëve, të rrahagjoksëve të  
7 shumtë të 'Kurrizëve', 'Qafave', 'Dorave' - më falni -  
8 'Dubrovnikëve' të kryeqendrës sonë, të barakave tjera të vogla  
9 e mjerane kur veprimtarët mjeranë kalojnë javë, muaj dhe vite  
10 për të mashtruar popullin liridashës".

11 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër, ju  
12 lutem, në anglisht. Po ju lexoj diku në mes të faqes.

13 PY. Dhe citoj:

14 "Shkurtimisht, sipas shpëtimtarëve të kombit që deshën të  
15 krijonin LDK-në, UÇK-ja plasi si një flluskë dhe pse të mos  
16 jetë fajtorë për gjakun që derdhet në vendet tona dhe krimet  
17 që po bën Milosheviqi. Kush tjetër veç UÇK-së që nuk respektoi  
18 jurisprudencën, rrugën e famshme të Titos, Rugova për shkak të  
19 agjentëve të UDB-së. Pra, - më falni - krimineli Millosheviq  
20 është fajtor, kush tjetër veç UÇK-ja, thonë ata, e cila nuk  
21 vazhdoi durimin famëmadh të ish-titistit 'mendjendritësit'  
22 nëpërkëmbësit Rugova, i cili për hir të një rezidence të një  
23 suite përcjellëse dhe ish-dubashëse dhe me një çmim në pritje  
24 të Nobel për Paqe është gjithherë i gatshëm ta sakrifikojë  
25 lirinë e pavarësinë e Kosovës, gjithnjë duke i premtuar



1 popullit naiv lirinë dhe demokracinë bibilike, qiellore të  
2 Jezus Krishtit.”

3 Thotë:

4 “Ka disa intelektualë në vendin tonë që po luajnë një rol  
5 kot për popullin tonë në kafetë e vogla dhe nuk po marrin  
6 asnjë lloj vendimi dhe nuk janë të gatshëm ta sakrifikojnë  
7 sikur sadopak për lirinë e Kosovës dhe pavarësinë e saj.”

8 E keni parë ndonjëherë këtë artikull gazete përpara,  
9 Dëshmitar?

10 PË. Jo, nuk e kam parë ndonjëherë.

11 PY. Kjo që ju lexova a ju përputhet apo nuk përputhet me  
12 përshtypjet që kishit ju, sa i takon përpjekjeve të z.

13 Krasniqi për të mbështetur një pozicion të bashkuar shqiptar?

14 PY. Jo, nuk përputhet.

15 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar  
16 Gjykatës. Kërkoj që të pranohet ky dokument në provat  
17 gjyqësore.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
19 Ka kundërshtime?

20 Z. ELLIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, u lexuan, më  
21 fal, janë marrë vendime të tjera në çështje të tjera gjyqësore  
22 kur pretendohet se janë përdorur fjalët e të akuzuarit në të.  
23 Por dëshmitari thotë që s’e ka parë ndonjëherë më parë këtë  
24 artikull dhe nuk e kuptoj se çfarë mund të thotë ai në lidhje  
25 me këtë artikull. Dhe nuk mund të vërtetoj, unë nuk mund të

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese nga z. Ferdinandusse

Faqe 114

1 flas për përmbajtjen e tij.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
3 pranohet sipas rregullës 138.

4 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim]

5 PY. Dëshmitar, prisni një sekondë.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Materiali ERN 043867 -  
7 043867, shqip dh anglisht marrin versionin e provës, marrin  
8 numrin e Provës Materiale P1096.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
10 Vazhdoni.

11 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim]

12 PY. Ditëve të fundit na keni dhënë shumë informacione; na  
13 keni dhënë shumë informacione si e keni kuptuar ju zhvillimet  
14 dhe organizimin e UÇK-së në 1998 në 1999. Dje folët për faktin  
15 që po përpigëshit të krijonit një tablo të UÇK-së dhe sot po  
16 ashtu përmendët faktin që duhet të lidhnit të gjitha pjesëzat  
17 e ndryshme për të krijuar një mozaik. Dhe për të kuptuar  
18 përfundimet tuaja që keni ndarë me ne këto dy ditë do doja të  
19 flisnim për informacionin që ka qenë, ka ekzistuar në Kosovë  
20 në atë kohë.

21 Pyetja ime është kjo: A keni parë ndonjë urdhëresë me  
22 shkrim nga Shtabi i Përgjithshëm në 1998 apo dhe në 1999?

23 PË. Përçiptazi më kujtohet që kemi parë disa përkthime në  
24 anglisht që ishin urdhëresa të UÇK-së, por ama nuk më kujtohet  
25 përmbajtja e tyre.

- 1 PY. Në 1998 apo në 1999?
- 2 PË. Kur kam qenë atje. I bie dhe 1998 dhe 1999.
- 3 PY. Nuk ju kujtohet se çfarë kishte përmbajtja?
- 4 PË. Jo, nuk më kujtohet përmbajtja.
- 5 PY. A keni parë ndonjë komunikim me shkrim nga Shtabi i
- 6 Përgjithshëm drejtuar zonave në 1998 apo 1999?
- 7 PË. Jo, me sa më kujtohet.
- 8 PY. A keni parë ndonjë komunikim me shkrim nga zonat drejtuar
- 9 Shtabit të Përgjithshëm në 1999, në 1999?
- 10 PË. Po thoni me shkrim?
- 11 PY. Po.
- 12 PË. Jo, atëherë.
- 13 PY. A keni qenë dëshmitar në ndonjë mbledhje mes Shtabit të
- 14 Përgjithshëm dhe zonave në 1998 apo në 1999?
- 15 PË. Jo.
- 16 PY. A ju ka thënë ndokush 1998 apo në 1999 që Jakup Krasniqi
- 17 kishte një funksion tjetër pranë UÇK-së përveç faktit që
- 18 ishte zëdhënës i UÇK-së dhe anëtar i drejtorisë politike?
- 19 PË. Jo.
- 20 PY. Gjatë kohës në Kosovë, a ju ka thënë dikush që Shtabi i
- 21 Përgjithshëm i UÇK-së ka ekzistuar që para verës së 1998?
- 22 PË. Singerisht nuk më kujtohet. Unë e di që...
- 23 PY. Më falni, më falni.
- 24 PË. Jo, jo, nuk më kujtohet.
- 25 PY. Dhe gjatë kohës në Kosovë a ju tha ndokush që UÇK-ja ka

1 pasur Shtab Qendror apo Shtab të Përgjithshëm përpara 1998?

2 PË. Kjo është një pyetje shumë e nuancuar, por përgjigja ime  
3 është, po.

4 PY. A ju kujtohet kush ju ka thënë ju që Shtabi i  
5 Përgjithshëm, më falni, UÇK-ja ka pasur Shtab të Përgjithshëm  
6 apo Shtab Qendror përpara 1998?

7 PË. Nuk më kujtohet konkretisht. Më vijnë disa personave në  
8 mendje, por tani nuk më kujtohet konkretisht.

9 PY. Po ju rifreskoj kujtesën se kur jua kam bërë unë këtë  
10 pyetje javën e kaluar dhe për këtë e kam fjalën, për  
11 materialin që është zbardhur në 120250, paragrafi 10, ju  
12 thatë:

13 "Asnjëherë s'e kam dëgjuar termin 'Shtab Qendror i UÇK-  
14 së'".

15 PË. Po, kështu është.

16 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit të nderuar  
17 Gjykatës. Kaq pyetje kisha për këtë dëshmitar.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
19 Barthe ka disa pyetje.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Po kam edhe unë disa pyetje në vijim  
21 të pyetjeve të Prokurorit, por nëse dëshironi mund ta bëj dhe  
22 pasi të mbarojnë Gjykatësit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në lidhje me  
24 çfarë?

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Në lidhje me pyetjet.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 117

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me cilat  
2 pyetje?

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Për dokumentin që iu tregua  
4 dëshmitarit nga *Zëri i Kosovës*, dokumentin e ri.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
6 Ju lutem, shkurtimisht.

7 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis:

8 Z. ELLIS: [Përkthim]

9 PY. Dëshmitar, ju treguan një dokument, më saktë një artikull  
10 nga *Zëri*, *Zëri i Kosovës*, *Zëri*. Por *Zëri* dhe *Zëri i Kosovës*  
11 ishte një gazetë, ishte një gazetë tjetër që botohej, botohej  
12 jashtë vendit dhe më konkretisht në Zvicër?

13 PË. Nuk më kujtohet. E di që botohej në Prishtinë.

14 PY. *Zëri* dhe *Koha Ditore* ishin të Prishtinës. Kështu?

15 PË. Po, kështu.

16 PY. Ju artikullin s'e kishit parë ndonjëherë përpara sa ta  
17 tregonte Prokuroria e për rrjedhojë s'keni pas mundësi ta  
18 diskutoni përmbajtjen e këtij artikulli me z. Krasniqi?

19 PË. Po, kështu është.

20 PY. Ju nuk e dini nëse janë fjalët tamam fjalët që ka  
21 përdorur ai apo se si u përcollën fjalët e tij në gazetë në  
22 atë format, kështu?

23 PË. Po, kështu.

24 PY. Dhe ju s'keni nga ta dini nëse ky artikull qarkullonte në  
25 Kosovë në tetor të 1998, kështu?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 118

1 PË. Po, kështu.

2 PY. Sa i takon periudhës kohore, të paktën nga vera e 1998 ka  
3 pasur disa ofensiva serbe, intensive?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe në veçanti nga fundi i gushtit a ju kujtohet që UÇK-  
6 së i morën dhe bastionin e Kleçkës, serbët?

7 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Unë s'po e kuptoj ku do dali  
8 Avokati me kundërpjetjet e veta.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë lidhje  
10 ka Kleçka këtu?

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Po përpiqem ta vendos artikullin në  
12 kontekst për periudhën kohore kur ka dalë ky artikull.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

14 Z. ELLIS: [Përkthim]

15 PY. Në atë kohë ka pasur artikuj të propagandës serbe ku  
16 thuhej që UÇK-ja ose ishte mundur ose ishte gati duke u  
17 mundur; a ju kujtohet kjo?

18 PË. Po.

19 PY. Më 15 tetor 1998, nëse ju kujtohet, ka qenë menjëherë pas  
20 shkurtimisht pas marrëveshjes Holbrooke-Milosevic e cila çoi  
21 në një armëpushim, ju kujtohet kjo?

22 PË. Cila ishte data?

23 PY. 15 tetor 1998 ka qenë data.

24 PË. Po më duket se ka qenë 30 tetor marrëveshja.

25 PY. Sidoqoftë, 15 tetor, sidoqoftë ka qenë pas ofensivës së

1 madhe serbe ku artikulli thotë se UÇK-ja u mund.

2 PË. Po, kështu është.

3 PY. Dhe sigurisht që në këto momentet pritet që zëdhënësi  
4 duhet të kundërpërgjigjet, të ndihmojë të ngrejë moralin e  
5 vendit, të inkurajojë ndërkombëtarët ta mbështesin UÇK-në apo  
6 jo?

7 PË. Po, kjo është afërmendsh.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim edhe një herë artikullin në  
9 ekran, ju lutem. Është me numër 043867. Faqja e dytë. Do t'ju  
10 lexoj një fragment këtu, por duhet të shkojmë më poshtë.

11 PY. "Jo vetëm UÇK-ja nuk është shkatërruar nga ofensivat e  
12 vazhdueshme të armikut, por u bë edhe më e fortë, më e  
13 organizuar profesionalisht, më e zgjeruar, më e përcaktuar për  
14 të ecur, më e ngritur, më e vendosur për të ecur në rrugën e  
15 pakthyer të lirisë, pavarësisë dhe demokracisë".

16 Tani Dëshmitar, ju keni folur gjatë këtyre ditëve; na  
17 keni treguar; na keni bërë vlerësimin se si ka qenë UÇK-ja në  
18 momente të caktuara kohore. Sigurisht që është një ekzagjerim  
19 të thuash më 15 tetor që UÇK-ja ishte më e fortë, më e  
20 organizuar, më e vendosur, a pajtoheni me mua?

21 PË. Po, pajtohem.

22 PY. Do t'ju tregoj diçka në faqen e fundit që është edhe  
23 faqja e tretë. Pjesa ku thuhet:

24 "Të gjithë ata që kanë detyrime financiare përfshirë  
25 burime financiare dhe materiale, pa hezitim t'i kryejnë

1 obligimet e tyre për luftën, për të ardhmen e kombit e të  
2 atdheut”.

3 Kjo është një thirrje për mbështetje për UÇK-në apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe ashtu përmendet në fund fare, thuhet:

6 “... Përndryshe UÇK-ja përmes mekanizmave të saj ligjor  
7 dhe ekzekutiv ...”.

8 Me sa keni dijeni ju, Dëshmitar, më 15 tetor nuk është se  
9 UÇK-ja kishte një mekanizëm ligjor apo ekzekutiv?

10 PË. Jo, kështu është.

11 PY. Domethënë, po, pajtoheni me mua?

12 PË. Po, pajtohem me ju.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam më pyetje.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Gjykatësi Barthe.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

17 Pyetje nga Trupi Gjykses:

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar. Jam  
19 këtu. Shpresoj se më dëgjoni.

20 PË. Po, ju dëgjoj.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Byrnes, kam  
22 disa pyetje lidhur me ato që i keni thënë ZPS-së gjatë  
23 intervistës në 2018, 2019 dhe 2020. Dhe për këtë qëllim unë do  
24 doja të shihnim deklaratën tuaj me shkrim për të parë nëse  
25 mund të na ndihmoni që ta kuptojmë më mirë dëshminë tuaj në



1 disa raste.

2 PË. Patjetër.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

4 Sekretare e Gjykatës, ju lutem vendosni në ekran provën  
5 materiale, më falni, P01066 dhe shkojmë në paragrafin 23 dhe  
6 24 të këtij materiali. Faleminderit.

7 Z. Byrnes, mund ta lexoni nëse, nëse keni nevojë. Për ta  
8 kuptuar se çfarë i keni thënë ZPS-së. Por unë po e lexoj  
9 paragrafin 23. Ju i keni thënë ZPS-së dhe unë po citoj:

10 "Kur ne takuam komandantët e UÇK-së në terren ata ishin  
11 të rezervuar në lidhje me identifikimin e njësive të tyre.  
12 Shpesh komandanti u referohesh me pseudonime sesa me emra të  
13 plotë."

14 Dhe në paragrafin 24 lexon si në vijim:

15 "UÇK-ja kishte telefona satelitorë. Përfundimisht KDOM-i  
16 i SHBA-së mori telefona satelitorë. Ne i përdorëm këto  
17 telefona për të organizuar vizitat me UÇK-në. Ndonjëherë të  
18 organizuara dhe më parë dhe veçanërisht për të koordinuar  
19 vizitat e nivelit të lartë me ndërkombëtarët."

20 Z. Byrnes, tani unë dua të kuptoj, së pari, ku dhe kur e  
21 keni parë apo keni vërejtur që UÇK-ja kishte telefona  
22 satelitorë, në qoftë se ju kujtohet?

23 PË. I vetmi episod që më kujtohet që më vjen ndërmend ka qenë  
24 goxha kohë më pas dhe ka qenë kur z. Krasniqi, më duket se ka  
25 qenë një takim në Likovc, më duket 13 janar të 1999 ku u bë

1 marrëveshja për shkëmbimin e të burgosurve. Z. Krasniqi dilte  
2 në një dhomë më vete dhe fliste në telefon satelitor me një  
3 person tjetër që i jepte kushtet e marrëveshjes, i përcillte  
4 kushtet e marrëveshjes.

5 Tani nga e dinim ne se i kishin këto telefonat  
6 satelitorë, e dinim se kishin përdorur telefonat tanë  
7 satelitorë për t'i kontaktuar ata me telefonat e tyre  
8 satelitorë. Sepse ju e dini që telefonat satelitorë janë me  
9 numra specifikë. Por kjo është hera e parë që më kujtohet të  
10 kem parë një të tillë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kjo në fakt do të kishte  
12 qenë edhe pyetja ime e dytë. Në paragrafin 57 të deklaratës ju  
13 thoni që komandantët e zonës, dhe e konfirmuar edhe sot, thatë  
14 që kishin radiomarrëse, telefona satelitorë, telefona celularë  
15 dhe ju keni thënë që para se të shkonit ju në Kosovë i kishin  
16 ata dhe ju keni mbërritur më 12 gusht të '98. Dhe pyetja ime  
17 është kjo: Nga e dini ju, ku e bazoni ju njohurinë që ata  
18 paskan pasur telefona satelitorë që para gushtit?

19 PË. Nga e dinim ne që komandantët e zonave apo që UÇK-ja i  
20 kishte?

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të dyja palët.

22 PË. Sa u takon radiove ne e dinim, sepse hynin ekipet tona në  
23 zona që kontrollonte UÇK-ja, gjenim postblloqe ku kishte  
24 ushtarë të UÇK-së dhe na ndalonin dhe verifikonin të dhënat  
25 tona, na kërkonin letërnjoftimet. Më pas ata me radiodore

1 komunikonin me një person tjetër në zinxhirin komandues për  
2 t'u thënë që ka ardhur një patrullë e KDOM-it dhe KDOM-i donte  
3 që të hynte në zonë që të takonte një person apo çfarëdo  
4 qoftë. Dhe atyre sigurisht që ju nevojitej leje nga  
5 komandantët që të na lejonin që të kalonim nëpër postblloqe.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po për telefonat satelitorë?

7 Ju thatë se ju e dinit që më përpara që ata i kishin këta  
8 telefona, që para se të mbërrinit në Kosovë. Cila ka qenë  
9 baza? Ku e bazuat këtë njohuri?

10 PË. Nuk më kujtohet.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk ka problem. Tani do të  
12 doja të kalonim te paragrafi 26 të deklaratës suaj. Këtu  
13 flisni për takime me Gjeneralin Sreten Lukic, që ishte kreu i  
14 ministrisë, i MUP-it serb, të forcave policore në Prishtinë.

15 "Dhe ju keni thënë se shpesh ai më ankohej për  
16 veprimtaritë e UÇK-së. Ishim të detyruar t'i hetonim më tej  
17 ankesat e tij; shpesh ankesat lidheshin me vrasjen apo  
18 zhdukjen e serbëve; përpiqeshim t'i gjenim këto persona të  
19 zhdukur dhe të organizonim lirimin e tyre, aty ku ishte e  
20 mundur."

21 Z. Byrnes, këta serbë ishin e pjesë e forcave të  
22 armatosura apo bëhet fjalë për civilë?

23 PË. Bëhet fjalë për civilë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni ndonjë informacion  
25 nëse këta civilë në kohën e arrestimit apo zhdukjes merrnin

1 pjesë në konfliktin e armatosur?

2 PË. Jo, nuk e kam këtë informacion. Por më duhet të them  
3 diçka, këto ishin pretendime. Kishte pretendime nga UÇK-ja në  
4 ato raste, në ato, të paktën për aq kohë sa kishim ne mundësi  
5 të identifikonim ndonjë njësi të UÇK-së që kishte rrëmbyer në  
6 fakt serbë. Nuk ka qenë gjithmonë kështu. Por kur ishim, në  
7 ato raste që ishim në gjendje ta vërtetonim që në fakt civilë  
8 serbë, X, Y ishin në duart e një njësitit të caktuar të UÇK-së  
9 atëherë në këto raste përpiqeshim të siguronim lirimin e tyre.  
10 Sigurisht që ata gjithmonë pretendonin se këta civilët ishin  
11 të armatosur dhe kanë qenë pjesë e konfliktit me UÇK-në dhe se  
12 ishin armiq të UÇK-së. Dhe më lejoni të shkoj dhe diçka  
13 tjetër.

14 Policia serbe ka shpërndarë shumë armë; u kanë shpërndarë  
15 shumë armë civilëve serbë për vetëmbrojtje. Si për shembull,  
16 në pjesën ku qëndronte KDOM-i në atë hotelin, motelin ku  
17 qëndronte KDOM-i të gjithë pronarët e këtij moteli kishin  
18 automatikë të cilat ua kishte dhënë policia. Edhe fqinjët e  
19 tyre madje. Edhe për shembull, një të shtunë mbrëmje ndodhte  
20 që shtinin me automatik thjesht për të festuar, për dasma, për  
21 festa, për ditëlindje, shtinin me armë. Ishin të pranishëm,  
22 ishte krejt normale në gjithë vendin.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që të jem pak i qartë për  
24 këtë. UÇK-ja apo anëtarët e UÇK-së që ua kanë thënë këtë gjë,  
25 a ju thanë po ashtu se këta serbë apo civilë ishin të

1 armatosur apo se merrnin pjesë aktivisht në luftime?

2 PË. Ata na thonin që ishin të armatosur.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pra, këto  
4 ankesa që vinin nga Gjenerali Lukic, sipas hetimeve tuaja të  
5 paktën ishin pjesërisht të vërteta. Domethënë me fjalë të  
6 tjera që civilët ishin në duart e UÇK-së në atë kohë.

7 PË. Po, ka pasur disa incidente. Më lejoni t'ju shtoj  
8 gjithashtu që udhëzimet që kisha marrë si nga Uashingtoni dhe  
9 nga ambasadori ynë në Beograd ishin të tilla që ne duhej të  
10 bashkëpunonim me Gjeneralin Lukic dhe me policinë dhe të bënim  
11 sa të mundeshim, në mënyrë të tillë që të ndihmonim situatën.  
12 Dhe në mënyrë të tillë që të siguronim lirin e personave të  
13 ndaluar, pra, të serbëve të ndaluar në këtë rast.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Po sa i takon  
15 pretendimeve të Gjeneralit Lukic që serbët civilë janë vrarë.  
16 Sa të vërteta ishin këto? A konstatuat ju me vërtetësi që disa  
17 prej këtyre njerëzve të paktën ishin vrarë?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Le të kalojmë në paragrafin  
20 28. Znj. Sekretare, do ju kërkoja të kalonim në paragrafin 28  
21 që është faqja pasuese e dokumentit që kemi në ekran. Në këtë  
22 paragraf juve flisni që keni shpenzuar kohë për të gjurmuar  
23 shqiptarë të Kosovës që ju thoni që ishin zhdukur. Dhe thoni  
24 që incidente të tilla shpesh raportoheshin nga anëtarët e LDK-  
25 së. Pra, KDOM-it ose juve, zakonisht incidente të tilla ia

1 raportonin anëtarëve të LDK-së. Në më pas ju thoni që Shtetet  
2 e Bashkuara besonin se udhëheqja e UÇK-së mund t'i adresonte  
3 incidente të tilla si këto kur ata kryheshin nga vendasit. Më  
4 tej ju thoni që:

5 "Në shtator ose tetor [Sipas përkthimit] të 1998 e kam  
6 ngritur çështjen e vrasjeve brenda shqiptarëve në trojkë dhe  
7 thoni që UÇK-ja e ka mohuar që kjo gjë të kishte ndodhur dhe  
8 ata e mohuan prerazi", thoni ju, që kjo kishte ndodhur.

9 Pyetja për juve është kjo: A është e vërtetë që udhëheqja  
10 e UÇK-së nuk e ka trajtuar incidentet e zhdukjes së  
11 shqiptarëve të vrarë në veçanti anëtarë të lartë të LDK-së dhe  
12 që UÇK-ja përpara trojkës, të paktën, e ka mohuar  
13 kategorikisht që kjo të kishte ngjarë në shtator apo në nëntor  
14 të 1998. Kjo është dëshmia juaj dëshmitar?

15 PË. Po. Deri në masën që trojka përfaqësonte udhëheqësit e  
16 UÇK-së, po, kjo ka ndodhur. Ata e mohonin kategorikisht të  
17 kishte, të kishin ndodhur gjëra të tilla. Nuk e di nëse kjo  
18 është përgjigje ndaj pyetjes tuaj apo jo?

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, po, por thjesht po ju  
20 prisja që të përfundonit për të qenë i qartë lidhur me këtë  
21 pikë.

22 Për pyetjen e radhës do i kërkoja Sekretares që të na  
23 paraqesë paragrafin 38 të deklaratës që dëshmitari i ka dhënë  
24 ZPS-së.

25 Z. Byrnes, në paragrafin 38, sa për t'ju përmbledhur, ju

1 thoni se z. Limaj, fillimisht, ishte rezistent ndaj  
2 respektimit të marrëveshjes së tetorit dhe kam përshtypjen që  
3 këtu e keni fjalën për marrëveshjen Holbrooke-Milosevic apo  
4 jo? Dhe më tej thoni që fillimisht kishit menduar se Limaj  
5 ishte komandant i një zone, por më vonë zbuluat se ai nuk  
6 ishte.

7 "Roli i tij", sipas jush, "ishte pak misterioz, por ai  
8 ishte qartësisht në krye të zonës së Malishevës, prej nga edhe  
9 ishte vetë ai".

10 "Dhe së fundi", vazhdoni, "Nën presin nga Mike Dean dhe  
11 Nick Turnbull nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, Limaj  
12 respektoi kushtet e marrëveshjes ..."

13 Z. Byrnes, na e shpjegoni pak nga e dini ju që Shtabi i  
14 Përgjithshëm i UÇK-së kishte ushtruar trysni mbi z. Limaj?  
15 PË. Sepse ne kemi folur me Shtabin e Përgjithshëm; kemi folur  
16 me trojkën lidhur me këtë çështje. Në veçanti me z. Bashota me  
17 të cilin kemi pasur kontakte të vazhdueshme gjatë kësaj  
18 periudhe dhe për këtë çështje konkrete dhe z. Bashota na tha  
19 specifikisht këtë që unë kam shprehur te kjo pjesë.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju ka thënë gjithashtu z.  
21 Bashota ose dikush tjetër që Shtabi i Përgjithshëm e bëri z.  
22 Selimi që të respektonte, z. Limaj, më falni, që të  
23 respektonte marrëveshjen e tetorit?

24 PË. Po. [Sipas përkthimit]

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull, vazhdojmë më

1 poshtë me deklaratën e dhënë për ZPS-në te paragrafi 42, ju  
2 lutem.

3 Në paragrafin 42 e më poshtë ju bëni konstatime lidhur me  
4 Shtabin e Përgjithshëm, mënyrën e organizimit të Shtabit të  
5 Përgjithshëm dhe ndërmjet të tjerave ju thoni që Shtabi i  
6 Përgjithshëm kishte 7 zona, kishte dhe një Shtab të  
7 Përgjithshëm. Thoni më tej që besonit se Shtabi i Përgjithshëm  
8 i UÇK-së deri në nëntor të '98 ishte i përbërë nga gjashtë  
9 departamente, përkatësisht departamenti politik, i  
10 informacionit, logjistikës, policisë, drejtësisë dhe  
11 operacioneve.

12 Çfarë keni dashur të thoni kur keni thënë "departamenti i  
13 informacionit"? E kishit fjalën për departamentin e  
14 marrëdhënieve me publikun, për departamentin e zbulim-  
15 kundërzbulimit, nuk e di, na e shpjegoni pak, Dëshmitar, çfarë  
16 keni dashur të thoni?

17 PË. E kisha fjalën për marrëdhëniet me publikun, kur kam  
18 thënë departamenti i informacionit.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull, faleminderit.  
20 Znj. Sekretare, na kaloni tani tek prova materiale P1069, më  
21 konkretisht faqet 075323, paragrafi 7. Besoj se e kemi shfaqur  
22 disa herë këtë paragraf gjatë këtyre tri ditëve të fundit të  
23 dëshmisë suaj përpara Trupit Gjykses, Dëshmitar.

24 Në këtë paragraf thuhet që:

25 "Vetë Shtabi i Përgjithshëm është relativisht jokohorent,



1 sepse është gjithmonë në lëvizje e sipër dhe sepse anëtarët e  
2 tij shumë rrallë takohen me njëri-tjetrin. Po ashtu thuhet që  
3 pjesa kryesore e Shtabit të Përgjithshëm aktualisht është  
4 jashtë shtetit, por pritet që të kthehet në Kosovë në fund të  
5 këtij viti, sipas burimeve të UÇK-së. Disa prej anëtarëve të  
6 Shtabit të Përgjithshëm pretendojnë që ka një shef të Shtabit  
7 të Përgjithshëm, megjithatë, nuk thonë se kush është ky person  
8 që është përgjegjës për Shtabin e Përgjithshëm. Megjithatë, ne  
9 kemi qenë në gjendje që të identifikojmë disa anëtarë të  
10 Shtabit të Përgjithshëm. Këtu përfshihet Hashim Thaçi, shef i  
11 drejtorisë politike të Shtabit të Përgjithshëm; Rexhep Selimi,  
12 që është drejtor politik i zonës së Drenicës dhe ndoshta shef  
13 i drejtorisë për inteligjencën të Shtabit të Përgjithshëm ose  
14 drejtorisë së informimit ...”

15 Besoj se e keni konfirmuar disa herë se pretendimi që z.  
16 Selimi ishte drejtor ose shef i shërbimit inteligjent brenda  
17 Shtabit të Përgjithshëm ishte prezumim i gabuar; këtë e keni  
18 thënë disa herë besoj apo jo? E konfirmoni këtë, Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A jeni në dijeni të faktit  
21 që UÇK-ja në atë kohë, domethënë, në '98 ose më konkretisht në  
22 nëntor të '98 sikurse e keni shpjeguar në paragrafin 42 të  
23 deklaratës tuaj, kishte një drejtor të inteligjencës brenda  
24 Shtabit të Përgjithshëm?

25 PË. Nuk e kujtoj këtë. Por, megjithatë, në atë pikë ne

1 mendonim që kishte një lloj strukture ose njësie që merrej me  
2 pjesën e inteligjencës.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Znj.

4 Sekretare, na kaloni, ju lutem, tani te prova materiale  
5 075336. Shfaqeni në ekran nëse mundeni. Është teksti i një  
6 kabllogrami që mban datën 4 shkurt 1999 tek faqja 340. Mendoj  
7 që e kemi parë edhe më herët këtë dokument. Është shfaqur edhe  
8 nga ekipet që ju bënë pyetje gjatë kundërpvetjeve të tyre.

9 Tek paragrafi i dytë i faqes që keni përpara. Thuhet:

10 "Informimi/inteligjencë:", dhe thoni më tej që, "Nuk kemi  
11 qenë në gjendje që të identifikojmë se kush ishte shefi i  
12 inteligjencës ose informimit."

13 Pyetja për ju është kjo: Akoma këtë përgjigje keni?  
14 Domethënë, që deri në këtë pikë juve nuk e dini se kush ishte  
15 shefi i shërbimit të inteligjencës ose zbulim-kundërzbulimit  
16 brenda Shtabit të Përgjithshëm në atë kohë?

17 PË. Doni të thoni në qoftë se e di përgjigjen mbi bazën e  
18 informimit, informacionit që kam marrë më vonë apo atëherë?

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, çfarë dini më pas.

20 PË. Mbi bazën e shumë burimeve të tjera të cilat unë kam  
21 mësuar, domethënë, nga zyrat e UÇK-së apo nga njerëz të tjerë  
22 që e njihnin mirë UÇK-në, mënyrën e strukturimit të tyre. Me  
23 sa kam mësuar më vonë, Kadri Veseli ishte shefi i njësisë së  
24 zbulim dhe kundërzbulimit të UÇK-së.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po thoni që e keni mësuar

1 këtë më vonë apo jo?

2 PË. E kam mësuar këtë gjë më vonë, pasi kishte përfunduar  
3 konflikti dhe kur NATO-ja ishte në Kosovë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. Byrnes, për një çështje të lidhur me këtë që sapo  
6 trajtuam që nuk është se e kemi ende të qartë neve, anëtarët e  
7 Trupit Gjykses. A mund të na thoni që në atë kohë, pra, në  
8 vitin 1998 apo në 1999, a keni pasur ndonjë dijeni personale  
9 se ku ka qenë z. Veseli në vitin 1999 e në vijim ose çfarë  
10 bënte ai që prej asaj kohe? Pra, ku ka qenë ai në 1998 dhe  
11 1999?

12 PË. I vetmi informacion që kishim ne lidhur me z. Veseli  
13 ishte që ai ishte në Shqipëri. Ne nuk e dinim se çfarë  
14 përgjegjësish kishte z. Veseli. Kishte fjalë që qarkullonin,  
15 megjithatë, pavarësisht kësaj ne nuk është se kishim asnjë  
16 lloj informacioni konkret që mund të, mund ta përcaktonim me  
17 saktësi se çfarë përgjegjësish dhe çfarë detyrash kishte z.  
18 Veseli.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë, përveç këtyre  
20 fjalëve që qarkullonin, ju nuk e dinit fare se me çfarë merrej  
21 ai në Shqipëri në qoftë se ishte në Shqipëri z. Veseli në atë  
22 kohë?

23 PË. Po, e vërtetë është kjo.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

25 Kalojmë te paragrafi tjetër i faqes pasuese të deklaratës

1 që i keni dhënë ZPS-së. Pra, paragrafi 43.

2 Ndërkohë, dokumentin që e keni në ekran mund ta hiqni,  
3 Sekretare.

4 Z. Byrnes, sipas procesverbalit që ekziston për dëshminë  
5 që i keni dhënë ZPS-së, në paragrafin 43 ju thoni, i keni  
6 thënë Prokurorisë që z. Thaçi ka thënë që z. Demaçi ishte në  
7 Prishtinë ose "Z. Demaçi ishte zëdhënësi i Prishtinës, por  
8 ndërkohë nuk është se i ka dhënë atij asnjë lloj autoriteti  
9 politik". Mbështetur në atë çfarë keni thënë, të paktën në  
10 procesverbal, ju thoni më tej që "Demaçi kishte një rol të  
11 vogël".

12 E para, a ju kujtohet t'ia keni thënë këtë Prokurorisë?  
13 PË. Po, më kujtohet.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni, a ju  
15 kujtohet se kur, ku dhe në çfarë konteksti e ka bërë z. Thaçi  
16 këtë koment? Pak a shumë domethënë, në çfarë viti, në qoftë se  
17 mund të na thoni ose në çfarë konteksti e ka dhënë këtë  
18 informacion z. Thaçi?

19 PË. Do të mundohem të jem i shkurtër në përgjigje. Sikurse e  
20 thashë edhe më herët mendoj se e kam parë z. Thaçi pesë a  
21 gjashtë herë përpara se z. Thaçi të largohej nga Kosova për në  
22 perëndim. E kam parë diku nga mesi i nëntorit. Më kujtohet që  
23 në një pikë kam përshtypjen që para sesa të largohej z. Thaçi  
24 për në perëndim, ai më tha se z. Demaçi ishte zëdhënësi i tyre  
25 në Prishtinë, por zëdhënësi i UÇK-së ose për Shtabin e

1 Përgjithshëm të UÇK-së në nivelin e lidërshipt të UÇK-së  
2 ishte z. Krasniqi. Për të qenë i sigurtë me ju, unë dhe Nick  
3 Turnbull, Komandanti i KDOM-it evropian nuk e morëm vesh  
4 asnjëherë se çfarë donte të thoshte kjo. Domethënë se si këto  
5 dy role ishin të ndryshme nga njëra-tjetra dhe në fakt çfarë  
6 roli luante z. Demaçi. Nuk ishte e qartë për neve se çfarë  
7 roli, çfarë detyre kishte z. Demaçi që thuhet që ishte  
8 zëdhënësi i Prishtinës krahasimisht me zëdhënësin e Shtabit të  
9 Përgjithshëm.

10 Sikurse e dini Demaçi drejtoi grupin e rebelëve ndaj  
11 marrëveshjes së Rambujesë, dhe siç e dini Thaçi dhe pjesa  
12 tjetër që ishin negociatorë në Rambuje ishin në Francë dhe  
13 besoj që kjo ngjarje e çoi në ekstremet e veta marrëdhënien  
14 ndërmjet Demaçit dhe Thaçit. Por z. Thaçi ishte shumë kritik  
15 ndaj z. Demaçi dhe komentet përkatëse të bëra prej tij dhe si  
16 rezultat z. Demaçi u tërhoq nga UÇK-ja.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për të qenë i qartë ky  
18 koment është bërë në '98, domethënë që në nëntor të '98 apo  
19 jo?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë i takon përpara  
22 Rambujesë?

23 PË. Kështu më kujtohet mua.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet se çfarë donte  
25 të thoshte z. Thaçi kur tha "që kishte rol të vogël"? Rol të

1 vogël në krahasim me kë? A mund, ju kujtohet gjë lidhur me  
2 këtë?

3 PË. Thjesht më kujtohet që tha që luan një rol të vogël.

4 Mënyra se si e kuptova unë këtë gjë dhe kjo më kujtohet, ishte  
5 që mos i kushto shumë vëmendje atij. Kështu e mora unë  
6 kuptimin e kësaj shprehjeje.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull, faleminderit.

8 Do i kërkoja Sekretares të kalonim në paragrafin 50.

9 Në paragrafin 50 të procesverbalit me shkrim që i keni  
10 dhënë ZPS-së, Dëshmitar, ju flisni për z. Thaçi që ishte,  
11 sipas jush, sipas procesverbalit që ishte identifikuar "si  
12 anëtar i lartë i Shtabit të Përgjithshëm i UÇK-së, por që nuk  
13 ishte identifikuar me emër". Nuk kishte thënë kush ishte me  
14 fjalë të tjera. Ndërkohë që ju flisni për një takim më të  
15 hershëm në gusht në Likovc. E përmendët dhe më herët në  
16 deklaratën tuaj këtë takim. Megjithatë, thoni që:

17 "Deri në nëntor ju vutë re që Thaçi dominonte diskutimet  
18 ku në një rast ku ka qenë i pranishëm dhe Rexhep Selimi".

19 Thoni, keni thënë më përpara që më herët ju ishte krijuar  
20 përshtypja që Rexhep Selimi ishte drejtuesi kryesor.

21 Pyetja ime për ju është kjo: A vutë re, kur keni qenë në  
22 këtë takim, në fillim të gushtit në Likovc, a vutë re ndonjë  
23 vend paraburgimi apo ndonjë person të paraburgosur atje? Se  
24 kam përshtypjen që thatë të hënën që patë një ahur aty dhe që  
25 kishte disa të burgosur, të ndaluar aty?

1 PË. E keni fjalën për fillimin e gushtit?

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jo, po ju pyes juve; unë nuk  
3 e di.

4 PË. Nuk më kujtohet. Kjo ka ndodhur 25 vite të shkuara. Nuk  
5 më kujtohet të kem parë ndonjë të burgosur serb në Likovc. E  
6 shoh, mbase e kam thënë gabim. Nuk e di por ka pasur raste kur  
7 kishte njerëz jashtë që ishin që mund të na ishin dukur si të  
8 burgosur serbë por normalisht ata ishin thjesht bujq ose  
9 fshatarë që mund të ishin marrë. Ju kërktoj ndjesë. Nuk mund të  
10 kujtoj dot asgjë më tepër lidhur me këtë. Ju kërktoj ndjesë për  
11 këtë.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk ka problem.

13 Ju thatë më tej që z. Sylejman ose "Sulltan" Selimi siç i  
14 thoni juve, ka qenë gjithashtu i pranishëm në takim. Thatë  
15 gjithashtu që ky ishte një person që nuk është se foli shumë  
16 në atë takim. Thatë që nga ditari personal ju mund të shikoni  
17 që në gusht të '98 keni hedhur një shënim aty që nga ora  
18 "12.00 keni qenë në Likovc dhe e keni fjalën për datën 18  
19 gusht të '98". Ka qenë ditë e martë. Mund ta shikoni këtë në  
20 fund të faqes, paragrafi 50.

21 A ju kujtohet se ku ekzaktësisht, në çfarë godine, në  
22 çfarë ndërtese jeni takuar me z. Rexhep Selimi dhe Sylejman  
23 Selimin?

24 PË. Thatë 12 gusht?

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jo, thashë 18 gusht, ora

1 ishte 12.00. Mendoj që me 12 e keni pas fjalën për kohën  
2 besoj.

3 PË. Atë ditë kur jam takuar me të dy personat me mbiemrin  
4 Selimi ka qenë në Likovc, më kujtohet kjo.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet se ku jeni  
6 takuar me të?

7 PË. Në Likovc.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirë, në rregull në Likovc,  
9 por në çfarë vendi, në çfarë ndërtese jeni takuar me të?

10 PË. Ju kërkoj ndjesë. Nuk më kujtohet kjo.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet të keni parë  
12 një stacion policie në Likovc?

13 PË. Aty ishte, aty ishim në stacionin e policisë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni parë gjithashtu edhe  
15 një qendër shëndetësore ose spital në Likovc?

16 PË. Çfarë?

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Një spital ose qendër  
18 shëndetësore?

19 PË. Spital, qendër shëndetësore? Nuk më kujtohet, nuk e di.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni parë apo a keni  
21 dëgjuar që z. Rexhep Selimi t'i jepte urdhra ushtarëve të  
22 tjerë ose anëtarëve të tjerë të UÇK-së; ju kujtohet kjo gjë?

23 PË. Jo.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë nuk ju kujtohet  
25 fare?



1 PË. Jo, nuk më kujtohet.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull.

3 Kalojmë te paragrafi 59.

4 Z. Byrnes, në paragrafin 59 ju thoni, të paktën sipas  
5 procesverbalit, të intervistës me ZPS-së që ju krijua  
6 "përshtypje se njëfarë kohe policia ushtarake filloi të  
7 raportonte Shtabit të Përgjithshëm më shumë, sesa komandantëve  
8 të zonës", dhe ju thoni se ju menduat se Sabit Geci ishte në  
9 krye të policisë ushtarake, "megjithëse ai ishte plagosur  
10 rëndë në tetor". Kam përshtypjen që e keni fjalën këtu për  
11 tetorin e '98 apo jo, Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në seancën përgatitore me  
14 Prokurorinë, e kam fjalën konkretisht në Shënimin Përgatitor  
15 numër 1, ju thoni që nuk ju kujtohet se kur ju krijua  
16 përshtypja që policia ushtarake filloi t'i raportonte Shtabit  
17 të Përgjithshëm dhe jo komandantëve të zonës dhe doja t'ju  
18 pyesja se çfarë informacioni shërbeu si bazë e kësaj  
19 përshtypje tuajës? Se nga ju krijua kjo përshtypja? Është  
20 krijuar mbështetur në këtë çfarë keni thënë në këtë paragraf?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur keni parë për herë të  
23 parë policinë ushtarake në Kosovë ose anëtarë të policisë  
24 ushtarake në Kosovë; kur ka ndodhur kjo?

25 PË. Është e vështirë ta kujtoj këtë. Veçanërisht për shkak të

1 faktit se kishim takime të rëndësishme, për shembull, kishim  
2 takimin e nëntorit. Nuk më kujtohet data konkretisht, por më  
3 kujtohet që kemi pasur një takim në nëntor, pasi ishte krijuar  
4 MVK-ja ne negociuam lirimin e disa gazetarëve serbë, nëse nuk  
5 gabohem. Gazetarët u dorëzuan, na u dorëzuan ne, pra, ose më  
6 saktë iu dorëzuan Gjeneral Walkerit në Dragobil. Kishte shumë  
7 ushtarë të UÇK-së atje, grupe të mëdha të ushtarëve të UÇK-së  
8 atje. Dhe ne në përfundim i referohemi atyre si grupet e  
9 posaçme të sigurisë ose forcat e ndërhyrjes për mbrojtjen e  
10 personave shumë të rëndësishëm. Dhe mbaj mend që e kemi pyetur  
11 z. Bashota që kush janë këta persona dhe ata thanë që është  
12 policia ushtarake e UÇK-së që ishin persona që ofronin  
13 mbrojtje, domethënë, mbrojtje për personave shumë të  
14 rëndësishëm dhe liderët, personat që kishin një hierarki të  
15 caktuar, ishin në majë të hierarkisë me e thënë me fjalë të  
16 tjera. Pra, këta ishin personat që ofronin mbrojtje.

17 Këto ishin ato lloj situatash ku ne kemi parë për herë të  
18 parë policinë ushtarake. Kaq më kujtohet.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, z. Bashota ju tha juve  
20 që këta ushtarë ishin nga policia ushtarake e UÇK-së, kështu?  
21 PË. Po.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni vënë re ose a keni  
23 parë ndonjë uniformë, ndonjë element konkret, ndonjë stemë,  
24 ndonjë gjë tjetër që ju çoi në prezumimin që UÇK-ja kishte një  
25 polici ushtarake më vete?

1 PË. Jo, nuk më kujtohet. Megjithatë, ajo çfarë mund të them  
2 është që unë nuk kam parë personel të UÇK-së me uniforma të  
3 caktuara. Ndërkohë disa prej anëtarëve të ekipit tonë e kanë  
4 bërë, i kanë parë domethënë pjesëtarët e UÇK-së me uniforma të  
5 caktuara gjatë patrullimeve, por unë personalisht nuk i kam  
6 parë me uniforma specifike.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Le të kalojmë te paragrafi  
8 67. Ky paragraf lidhet me pyetjen time të radhës.

9 Z. Byrnes, në këtë paragraf ju thoni se keni mësuar më  
10 vonë nga shtypi dhe gjatë bisedave me njerëzit se Jakup  
11 Krasniqi kishte "një marrëdhënie të tensionuar", thoni ju, me  
12 z. Thaçi. Dhe që keni mësuar më vonë se marrëdhënia me  
13 komandant Remin dhe Thaçin, herë ishte mirë e herë ishte keq.

14 Pyetja për ju është kjo: Sipas asaj që ju mësuar nga  
15 bisedat me njerëzit dhe nga shtypi, cila ishte arsyeja që  
16 marrëdhënia e z. Krasniqi dhe z. Thaçi ishte e tensionuar?

17 PË. Nuk e di.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull.

19 Vazhdojmë me paragrafin e radhës. Ky paragraf, kjo pyetje  
20 ka të bëjë me paragrafin 69. Në paragrafin 69 ju thoni, dhe  
21 besoj që e keni konfirmuar dhe gjatë dëshmisë në gjyq që e  
22 keni parë Hashim Thaçin për herë të fundit gjatë konfliktit në  
23 Kosovë në mes të nëntorit të '98. Thoni më tej se besoni se ai  
24 u largua nga Kosova në të njëjtin muaj. Më poshtë në të  
25 njëjtin paragraf ju thoni që e keni takuar disa herë z. Thaçi

1 në nëntor të '98.

2 A e dini ju se ku ka shkuar apo ku ka qëndruar z. Thaçi  
3 kur u largua nga nëntori i '98? Ju të hënën thatë që është  
4 larguar në perëndim, a mund të na thoni diçka më tepër  
5 konkrete se ku ka shkuar z. Thaçi dhe ku ka qëndruar ai gjatë  
6 kësaj periudhe?

7 PË. Me aq sa kuptonim ne nga burimet e UÇK-së ishte që ai  
8 ishte në Evropën perëndimore, por asnjëherë nuk na thonin  
9 asgjë më tepër sesa kaq, asnjë lloj informacioni më konkret  
10 sesa kaq.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini në qoftë se z.  
12 Thaçi ka qenë gjatë gjithë kohës jashtë Kosovës nga mesi i  
13 nëntorit të '98 deri në shkurt të '99?

14 PË. Këtë përshtypje kisha unë. Nuk e konfirmoj dot me  
15 saktësi; nuk e them dot me saktësi, por këtë përshtypje kishim  
16 ne. Ne nuk e kemi parë më atë asnjëherë gjatë kësaj periudhe  
17 deri kur e pamë në Rambuje.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E thashë gabim periudhën,  
19 por e kisha fjalën nga nëntori '98 deri në shkurt të '99.

20 Më jepni një moment, ju lutem.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do  
22 bëjmë pushim për 15 minuta siç kemi bërë edhe ditët e tjera.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të dilni  
25 nga salla. Asistentja do t'ju ndihmojë, do t'ju nxjerrë nga

1   salla.

2                               [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
4   çaktivizuar]

5           Do bëjmë pushim për 15 minuta.

6                               --- Seanca ndërpritet në orën 15.30

7                               --- Seanca rifillon në orën 15.45

8           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistente, ju  
9   lutem sillni në sallë dëshmitarin.

10                              [Dëshmitari vijon dëshminë]

11           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, z.  
12   Byrnes, Gjykatësi Barthe ka ende disa pyetje për ju.

13           DËSHMITARI: [Përkthim] Jam gati.

14           GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Byrnes.

15           Atëherë, Sekretarja e seancës a mund të kalojmë te  
16   paragrafi 72 i deklaratës së dëshmitarit dhënë ZPS-së.

17           Z. Byrnes, do të përpiqem që të tregohem sa më shkurt në  
18   pyetjet e mira dhe t'i bëj ato sa më shumë që të jetë e  
19   mundur. Dhe këtu në këtë paragraf kam një pyetje të shkurtër.  
20   Ndoshta pyetja ka nevojë për një përgjigje më të gjatë nga ana  
21   juaj, megjithatë, do ta shohim. Në paragraf flitet për një  
22   takim tjetër që keni patur nga ai i datës 28 tetor 1998. Një  
23   takim i cili ju ka mbetur në mendje, thatë ju, sepse z. Thaçi  
24   hyri në një diskutim të gjerë e të gjatë për ideologjinë dhe  
25   për filozofinë politike. Një takim i cili zgjati për disa orë.

1 Dhe pyetja ime është a mund të na bëni një përmbledhje  
2 ose të na përshkruani se çfarë tha z. Thaçi? Cila ishte  
3 ideologjia e tij, apo filozofia e tij politike?

4 PË. Më falni, po qesh pak.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po që të na krijoni një ide.

6 PË. Më vjen keq, por nuk kam për t'ja arritur dot aspak t'i  
7 përgjigjem kësaj pyetjeje. Më falni po t'ju them të drejtën e  
8 vetmja gjë që mbaj mend ishte një gjë që kishte të bënte me  
9 marksizëm-leninizmin. Dhe unë në universitet kisha si temë  
10 kryesore pikërisht studimet për Bashkimin Sovjetik, në fakt  
11 për Rusinë, dhe kisha shërbyer në ambasadën tonë në Moskë për  
12 rreth shtatë vite, kështu që kisha goxha njohuri në lidhje me  
13 këtë temë apo me këtë filozofi. Kështu mbaj mend që diskutimi  
14 ka qenë në lidhje me këtë çështje. Por se çfarë tha z. Thaçi  
15 konkretisht dhe nëse ai e konsideronte veten marksist-leninist  
16 nuk e mbaj mend aspak, t'ju them të drejtën, dhe ju kërkoj  
17 ndjesë për këtë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Okej, nuk ka problem.

19 Faleminderit.

20 Atëherë të shikojmë paragrafin 79 të deklaratës tuaj dhe  
21 ndoshta do t'ju ndihmojë për të kujtuar. Pra në paragrafin 79  
22 ju flisni për LPK-në ose një "burim tjetër të anëtarësimit të  
23 LPK-së e cila doli nga një grup marksist-leninist domethënë  
24 sipas Hoxhës. Dhe ky krah politik pa një mundësi për të  
25 ribashkuar tokat shqiptare, trojet shqiptare ndërsa dëbonte

1 serbët dhe drejtuesit kryesorë të këtij grupi ishin Xhavit  
2 Haliti, Azem Syla, Ali Ahmeti, Thaçi, Kadri Veseli dhe Adem  
3 Grabovci.”

4 A ju kujtohet -- a e mbani mend ta keni thënë këtë gjë?  
5 Ose këtë keni dashur të thoni dhe atëherë pra, ose tani që  
6 thatë për marksizëm-leninizmin?

7 PË. Po. Por nëse mund të shtoj ka patur edhe dallime ndërmjet  
8 vetë grupit. Kemi kohë që unë ta shtjelloj këtë çështje dhe  
9 t’ju jap ndoshta edhe një anekdotë të shkurtër?

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, patjetër.

11 PY. E mbaj mend që në fakt më bëri shumë për të qeshur një  
12 gjë që ndodhi në Rambuje dhe Xhavit Haliti, të cilin për herë  
13 të parë e takoja atje më ftoi për drekë dhe të dy së bashku --  
14 ishim pra vetëm ne me njëri-tjetrin në drekë. Dhe ai foli  
15 goxha gjatë për aspiratat e UÇK-së.

16 Dhe mbaj mend në mënyrë konkrete dhe të veçantë, që ja ku  
17 isha unë një diplomat amerikan, në fakt diplomat i nivelit të  
18 lartë, dhe ai po më tregonte aspiratat e UÇK-së dhe që këto  
19 aspirata ishin për të ribashkuar trojet shqiptare, që do të  
20 thotë Shqipërinë dhe Kosovën, dhe që të krijohej një sistem në  
21 Kosovë që, për shembull, do të merrte sistemin e Enver Hoxhës  
22 në Shqipëri. Dhe e mbaj mend që desh vdiqa së qeshuri kur e  
23 dëgjoja këtë që thoshte sepse nuk kisha patur asnjë përvojë të  
24 tillë më parë në jetën time. Kurrë më parë në të gjithë  
25 karrierën time ku një palë, pala tjetër në fakt të më hapej

1 kaq tërësisht dhe ndershmërisht të më tregonte atë që besonte.

2 Ishte e jashtëzakonshme.

3 Po ja që Haliti përfaqësonte njërin kah të LPK-së që  
4 ishte pro një sistemi sipas modelit të Hoxhës pra për Kosovën.  
5 Pra, përveç natyrisht çlirimit të Kosovës nga kontrolli  
6 serbëve, po ta kthente në diçka si modeli i Hoxhës. Por, po e  
7 lë me kaq.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe shkurtimisht në fjalimin  
9 që patët me z. Thaçi foli edhe ai për bashkimin me Shqipërinë,  
10 nëse e mbani mend?

11 PË. Jo, nuk e mbaj mend. Jo, t'ju them të drejtën nuk mbaj  
12 mend dhe kurrë, në bisedat që kemi pasur qoftë në formë  
13 private të dy apo me të tjerë, kurrë nuk ka thënë kur jemi  
14 takuar dhe në Kosovë që të ketë folur për ribashkimin me  
15 Shqipërinë.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A mund të  
17 kalojmë tani tek paragrafi 110. Në këtë paragraf z. Byrnes --  
18 PË. Cili paragraf ishte?

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Është paragrafi numër 110,  
20 ku thuhet

21 "Në atë kohë, në shtator 1998, unë nuk është se e kisha  
22 shumë idenë se kush ishte Hashim Thaçi, përtej faktit që  
23 besoja se ai ishte në drejtorinë politike të zonës së  
24 Drenicës. Sidoqoftë, viktimat e Qirezit e dinin se kush ishte  
25 ai sepse ai kishte qenë i përfshirë në lëvizjen studentore.



1 Kështu që bazuar në rrëfimet e tyre ai ishte aty dhe ishte e  
2 qartë ishte në krye.

3 Pyetja ime për ju është kjo: Si e dini ju që ishte e  
4 qartë për viktimat e Qirezit që z. Thaçi ishte në krye?  
5 PË. Sepse ma thanë ata. Gjergj Dedaj dhe Krasniqi, Agim  
6 Krasniqi. Ata më thanë që urdhrat i jepte ai, që ai drejtonte  
7 operacionin, punën.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe në paragrafin tjetër  
9 numër 111, ju thatë që "ndalimi i këtyre politikanëve të  
10 opozitës në Qirez ishte një incident i madh dhe që për  
11 mendimin tim u drejtua nga Shtabi i Përgjithshëm". Pyetja ime  
12 për ju është se përse mendoni ju që ishte Shtabi i  
13 Përgjithshëm i UÇK-së që ishte i përfshirë apo që e kishte  
14 drejtuar Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ndalimin e opozitarëve  
15 të Qirezit? Pra, ku e bazoni ju këtë gjë që keni thënë? Kjo  
16 ishte pyetja ime.

17 PË. Unë pranova mendimin që z. Thaçi ishte drejtori i politik  
18 në Shtabin e Përgjithshëm dhe që për rrjedhojë ai me ç'duket  
19 drejtonte operacionin në Qirez dhe për këtë arsye ishte një  
20 operacion që drejtohej nga Shtabi i Përgjithshëm si pjesë, në  
21 një mënyrë, e konfliktit politik që ishte gjithnjë e më shumë  
22 në rritje ndërmjet UÇK-së nga njëra anë dhe LDK-së nga ana  
23 tjetër.

24 Dhe ky konflikt, nëse mund të vazhdoj edhe pak, ky  
25 konflikt apo përplasje në fund të fundit kishte të bënte me

1 atë se kush do të qeveriste Kosovën pasi të kishin dëbuar  
2 serbët nga Kosova.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Edhe një herë atëherë kjo  
4 është një gjë që juve jua thanë viktimat e Qirezit?

5 PË. Jo. Kjo ishte analiza ime. Ky ishte mendimi im.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë, ky ishte gjykimi  
7 juaj.

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë të  
10 kalojmë te paragrafi 150.

11 Në paragrafin 150 thuhet, ose më saktë ju shpjegoni  
12 faktin që në tetor 2016 z. Thaçi u përpoq që t'ju jepte një  
13 çmim, të cilin ju e refuzuat. Dhe ju thoni që:

14 "Pak pasi arrita në Kosovë, mora një telefonatë nga zyra  
15 e Thaçit. Ata më pyetën nëse do të doja të vija në zyrën e tij  
16 dhe të flisja me të."

17 Dhe pas takimit me Thaçin unë e kuptova, të paktën sipas  
18 procesverbalit, e kuptova kërkesën e tij, si një përpjekje për  
19 të më influencuar.

20 Pyetja ime çfarë çmimi ishte ky, për çfarë ishte ky çmim?

21 PË. Për atë që ai e mendonte që ishin shërbimet që unë kisha  
22 bërë për Kosovën.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Çfarë çmimi ishte që ju  
24 ofrua juve?

25 PË. Nuk e kuptova pyetjen.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Çfarë çmimi ishte, apo çfarë  
2 ishte?

3 PË. Ishte një farë medaljeje, diçka e tillë. Nuk e kuptova  
4 fort mirë.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po ju e refuzuat?

6 PË. Po, e refuzova sepse kisha qenë në situata të tilla një  
7 apo dy herë më parë dhe për këtë arsye mendova që ishte një  
8 mundësi për ndikuar tek unë. Ndoshta ishte diçka shumë e  
9 thjesht, thjesht për të treguar mirënjohjen ndaj meje, por,  
10 thjesht nuk doja të isha në atë lloj situatë.

11 Por, i thashë ama se në rast se dëshironte të bënte një  
12 çmim të tillë a të jepte një medalje të tillë, atëherë këtë do  
13 të duhet ta bënte për anëtarët e KDOM-it amerikan, pra jo  
14 shefit. Dhe i thashë gjithashtu që në Shtetet e Bashkuara të  
15 Amerikës ne kemi ato që i quajmë medalje nga presidenti, pra  
16 kur presidenti i jep disa medalje të tilla, dhe unë vetë kam  
17 qenë, për shembull, në ushtri dhe presidenti jep çmime të  
18 tilla. Unë kam qenë marin dhe e di këtë gjë. Për shembull, ose  
19 në rast se nuk jep një medalje jep diçka tjetër për të  
20 shprehur faktin që janë mirënjohës për shërbimet që ke kryer.  
21 Dhe kështu nuk do të ishte diçka që do të jepte ndonjë -- do  
22 të kishte ndonjë ndikim ose do të merrte diçka prej meje. Do  
23 të ishte më e drejtë që personat që punuan për mua ishin të  
24 gjithë ata që e bënë përpjekjen tonë në fund të fundit të  
25 suksesshme. Të gjithë ne së bashku.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju kuptova, dhe në rast  
2 se ju kuptova është që qëllimi mund të kishte qenë shumë i  
3 vërtetë dhe i sigurtë, por gjithsesi ju vendosët ta refuzonit  
4 atë apo jo?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Megjithatë,  
7 unë -- faleminderit për durimin, por unë kam edhe disa pyetje  
8 të tjera përreth dy ngjarje.

9 PË. Patjetër.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam dy ngjarje të cilat ju i  
11 keni shpjeguar në fakt në deklaratën tuaj të ZPS-së dhe janë  
12 shpjeguar në paragrafët 115 deri në paragrafin 122.

13 Dhe për këtë i kërkoj Sekretares së seancës që për të  
14 mbrojtur dëshmitarët të kalojmë në seancë private.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 156

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thjesht për t'ju dhënë

25 kontekstin z. Byrnes të gjitha pyetjet e mia do të fokusohen

1 tek përfshirja juaj personale apo kolektive në lirimin e të  
2 ndaluarve të UÇK-së.

3 Me sa kuptoj unë ju keni qenë i përfshirë në shtatë raste  
4 ku janë liruar të ndaluar që kanë qenë nën arrestim nga UÇK-  
5 ja. Unë do t'i jap në rend kronologjik që ta kuptojmë. Ka qenë  
6 13-15 deputetët në Qirez. Kanë qenë dy gazetarët e Tanjug-ut,  
7 Dobricic dhe Radosevic. Kemi pastaj dy veprimtarët e UÇK-së  
8 [Sipas përkthimit] z. Desku dhe z. Kastrati. Numër katër është  
9 inspektori i policisë, Goran Zbilic. Pastaj është bërë  
10 shkëmbimi i tetë të burgosurve, tetë me nëntë të burgosur apo  
11 të ndaluar. Rasti gjashtë, janë pesë të moshuarit serbë dhe  
12 rasti shtatë, sipas meje janë këta druvarët, druvarët ose dy  
13 vëllezërit Savelic.

14 Pyetja ime e parë është kjo: A ka pasur ndonjë rast  
15 tjetër që unë nuk e përmenda ku ju të keni qenë i përfshirë në  
16 lirimin e ndonjë personi të ndaluar prej UÇK-së?  
17 PË. Nuk më kujtohet.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani këto shtate raste që  
19 përmenda unë a pajtoheni me mua që kanë qenë në zona, në  
20 regjione të ndryshme të Kosovës, si Drenica, Llapi, Prizreni,  
21 Shala, Nerodima, Malisheva dhe Pashtriku? Pajtoheni me mua?

22 PË. Besoj se po. Nuk është se e kam listën përpara, po ma  
23 merr mendja që keni të drejtë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'i marrim dhe rast pas  
25 rasti.

1 PË. Në rregull. Pajtoheni me mua që këto shtatë raste kanë  
2 qenë të shtrira në një periudhë kohore prej gjashtë, shtatë  
3 muajsh duke filluar nga shtatori 1998 dhe fundi i shkurtit,  
4 fillimi i marsit 1999?

5 PË. Shohim rastet në rend kronologjik dhe fillojmë me  
6 Qirezin. A ju kujtohet që ju thanë që Agim Krasniqi dhe Gjergj  
7 Dedaj ishin marrë në pyetje dhe ishin akuzuar për tradhti? Ju  
8 kujtohet kjo

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet kush ua ka  
11 thënë? A është e vërtetë që ka ardhur ky informacion nga z.  
12 Deda apo z. Krasniqi vetë?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Keni dijeni nëse ndonjë  
15 nga këta dy persona ka qenë i përfshirë në një aktivitet  
16 tradhtie?

17 PË. Duhet përkufizuar pak këtu "tradhtia, veprimtari apo  
18 aktivitete tradhtie". Por, kjo ka qenë një akuzë e UÇK-së. Nga  
19 pikëpamja ime, jo ama. Ata kanë qenë të angazhuar në  
20 veprimtari normale politike. Promovonim partitë e tyre  
21 politike.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fakt mbase me këtë i  
23 dhatë përgjigje pyetjes time të radhës dhe ju pyeti edhe  
24 Gjykatë Barthe për këto. Por sipas jush cila ka qenë arsyeja  
25 apo arsyet e vërteta për ndalimin e tyre, dhe siç ju kanë

1 thënë në rrahjen e këtyre personave?

2 PË. Fillimisht UÇK-ja asnjëherë nuk na i ka thënë arsyet për  
3 ndalimin e tyre. Të paktën me sa më kujtohet mua. Besoj se ka  
4 qenë në kuadër të mosmarrëveshjes politike që kishte UÇK-ja me  
5 LDK-në. UÇK-ja po përpigëj të shtrinte influencën e vet në  
6 këto zona.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Na thatë në dëshminë tuaj  
8 dhe kjo është e pasqyruar në provën materiale 1066, në  
9 paragrafin 105. Ju thatë pra se kishit kontaktuar udhëheqjen e  
10 UÇK-së në mënyrë që të siguronit lirimin e këtyre personave. A  
11 ju kujtohet tani cilin keni kontaktuar për këtë qëllim?

12 PË. E keni fjalën e rastit të 13 deputetëve?

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

14 PË. Është -- duhet se Sokol Bashotën, se ai ishte pika jonë e  
15 kontaktit.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në deklaratën tuaj në  
17 paragrafin 107 ju thoni se ju ka marrë dikush në telefon nga  
18 UÇK-ja dhe ju ka thënë se deputetët do të liroheshin. Ju  
19 kujtohet kjo?

20 PË. Po, më kujtohet.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet se kush ju  
22 mori në telefon?

23 PË. Jo, nuk më kujtohet.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë të themi,  
25 a mund të prezumojmë që mund të ketë qenë një anëtar i trojkës

1 apo mund të ketë qenë një person tjetër?

2 PË. Mund të ketë qenë dikush tjetër.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të hënën iu bënë disa  
4 pyetje lidhur me informacionet që keni marrë nga Agim Krasniqi  
5 dhe Gjergj Dedaj kur u takuat me ta. Dhe ju thatë që i keni  
6 takuar disa ditë pas lirimit. Ju kujtohet kjo linjë pyetjesh?

7 PË. Ishin pyetjet e mia.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, avokat. Një avokat,  
9 një nga avokatët iu pyeti për këtë takim që kishit patur me  
10 z. Krasniqi dhe z. Dedaj shkurtimisht pas lirimit të tyre. A  
11 ju kujtohen këto pyetje?

12 PË. I kam bërë unë këto pyetje se nuk po ju kuptoj.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë po ju pyes ju, a ju  
14 kujtohet që iu bëri një nga avokatët e Mbrojtjes pyetje të  
15 tilla në fillim të kësaj jave?

16 PË. Po, e mbaj mend.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këto takime që keni pasur  
18 ju shkurtimisht pas lirimit të z. Krasniqi dhe Dedaj, kanë  
19 qenë -- bëhet fjalë për këtë takim ku z. Dedaj të tha që e  
20 kishin rrahur dhe ju tha se z. Thaçi ishte përgjegjës për këtë  
21 operacion. Në këtë takim ka ndodhur?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe po në këto takime ka  
24 thënë z. Krasniqi se ishte rrahur dhe ishte marrë në pyetje  
25 nga z. Thaçi?



1 PË. Po, Agim Krasniqi këtë më tha.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk dua të t'i them unë  
3 fjalët sesi duhet t'i përdorësh ti, po iu bënë disa pyetje për  
4 ditarin tuaj ku hidhnit takimet edhe ju dhatë një përgjigje në  
5 lidhje me këtë, po unë dua të sigurohem që transkripti e ka  
6 zbardhur tamam atë që keni thënë ju.

7 Dhe pyetja ime është kjo: Sipas jush, kjo, ky ditar është  
8 një listë shteruese e të gjitha takimeve që keni pasur ju apo  
9 e pranoni mundësinë që ka të ngjarë që disa nga takimet që  
10 keni pasur mund të mos jenë hedhur në atë ditar?

11 PË. Kjo e fundit.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani diçka që keni thënë  
13 në seancën përgatitore me Prokurorinë, ju i keni thënë që kur  
14 jeni takuar me z. Dedaj shkurtimisht pak lirimit ai kishte  
15 frikë prej shpagimit nga UÇK-ja, frikë prej hakmarrjes - më  
16 falni - nga UÇK-ja. Ju kujtohet?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jua shpjegoi pse?

19 PË. Nuk donte që ta rrihnin prapë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju po ashtu thatë që sipas  
21 të paktën shpjegimit që dhatë ju, apo deklarata jua ishte që  
22 sipas jush kjo nënkuptonte që z. Dedaj dhe po e citoj "Donte  
23 të mbetej gjallë". A mund të na e shpjegoni çfarë keni dashur  
24 të thoni me këtë?

25 PË. Po në thelb nuk donte që t'i përsëritej edhe një herë e

1 njëjta -- të kishte të njëjtën përvojë.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me anëtarë të UÇK-së?

3 PË. Po, me anëtarët e UÇK-së.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju po ashtu thatë që sipas  
5 z. Krasniqi pas mosmarrëveshjes z. Thaçi kishte kërkuar ndjesë  
6 për atë që i kishte ndodhur dhe besoj se ju keni thënë që kjo  
7 ka ndodhur pas konfliktit. A mund të na e shpjegoni se çfarë  
8 rrethanash jua tha këtë z. Krasniqi ju?

9 PË. Më kujtohet që ka ndodhur pasi jemi kthyer në Kosovë. Pas  
10 marrëveshjes së Kumanovës ne u kthyem në Kosovë.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thjesht për një sqarim, a  
12 mund të na konfirmoni që Agim Krasniqi ishte një person i  
13 afërt me Presidentin Rugova?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dua t'ju tregoj disa  
16 dokumente që lidhem me këtë incident dhe t'ju bëj disa pyetje.  
17 I pari, dokumenti i parë është prova materiale P158. Ju lutem  
18 që të shfaqet në ekran. Faleminderit. Në anglisht është në  
19 faqen e dytë. Shqipja në të djathtë.

20 Ju lutem, lexojeni me gjysmën e dytë të faqes tek titulli  
21 "Njoftim për shtyp ..." Lexojeni.

22 PË. E lexova.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Siç mund ta shihni nga  
24 dokumenti pretendohet që është një kumtesë e Drejtorisë së  
25 Policës Ushtarake të UÇK-së. Mban datën 23 shtator 1998. Dhe

1 është botuar në gazetën Zëri i Kosovës më 1 tetor 1998. Tani  
2 unë dua të fokusoheni në veçanti tek fjalia e parë në këtë  
3 dokument që thotë:

4 "Duke u bazuar në të dhënat e Shërbimit Informativ të  
5 UÇK-së, më 20 shtator 1998, rreth orës 12:15 polica e UÇK-së  
6 arrestoi 13 sindikalistë edhe është vendosur në thonjëza  
7 "institucionalistë", përfaqësues të partisë në fshatin e  
8 Qirezit në Drenicë, për sjelljen e tyre dhe propagandën e  
9 luftës, për dorëzimin e armëve dhe për statusin politik të  
10 Kosovës në - më falni - anti-luftë çlirimtare propagandë ata  
11 në terren po zhvillonin për dorëzimin e armëve dhe për një  
12 zgjidhje të përkohshme të statusit politik të Kosovës në  
13 kuadër të Serbisë."

14 A e keni parë ndonjëherë më përpara këtë dokument?

15 PË. Jo, është hera e parë.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime është kjo:

17 Çfarë efekti do të kishin akuza apo pretendime të tilla për  
18 institucionalistë, anti-luftë çlirimtare, përçarës partiakë  
19 grupar [Sipas përkthimit] mbi këta persona. Pra, çfarë efekti  
20 do të kishte mbi këta persona?

21 PË. Efekt mbi kë?

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, personat që ishin  
23 objekt i këtyre akuzave, në këtë rast 13 parlamentarët,  
24 deputetët?

25 PË. Duhet të pyesni ata, me sinqeritet. Unë nuk kam ide.

1 Sigurisht që nuk u ka pëlqyer një gjë e tillë.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është një dokument tjetër  
3 që dua të citoj. Është prova materiale P304. Është po ashtu  
4 deklaratë e Drejtorisë së Policisë Ushtarake të UÇK-së e 4  
5 nëntorit, botuar te gazeta Koha Ditore ku flitet sërish për  
6 këtë dokument.

7 Dhe thuhet:

8 "Drejtoria e UÇK-së, Shërbimi i Zbulimit ka të dhëna,  
9 zotëron të dhëna për veprimtaritë e tyre," flas për  
10 veprimtaritë e këtyre deputetëve "kundër luftës që bën UÇK-ja  
11 për liri".

12 Dhe thuhet se:

13 "Këta persona kanë shpërndarë propagandë për dorëzimin e  
14 armëve në përputhje me Selman Biniqin nga fshati i Bajës dhe  
15 Sylejman Hoxhën [Sipas përkthimit] të cilët janë ekzekutuar  
16 nga UÇK-ja, dhe në bashkëpunim me Presidiumin e UÇK-së [Sipas  
17 përkthimit] Agim Krasniqi -- LDK-së, më falni, Agim Krasniqi  
18 që UÇK-ja e njeh si një person që mbulon -- që ka -- që kryen  
19 operacione kundër UÇK-së dhe ka filluar një nismë apo një lloj  
20 politike për autonominë e Kosovë."

21 Pyetja ime është kjo: Nga përvoja që keni ju në Kosovë  
22 dhe tensionet që na përshkruat më herët, sipas jush çfarë  
23 pasojash do të kishin akuza të tilla mbi personat në fjalë?  
24 Dhe kur them "personat në fjalë" e kam fjalën për këta 13  
25 deputetët që u liruan?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 165

1 PË. Po mendoj se do të jenë ndjerë të kërcënuar nga akuza të  
2 tilla.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A përputhet kjo me atë që  
4 ju tha z. Dedaj kur tha se kishte frikë nga hakmarrja?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit  
7 për durimin. Do të shihemi nesër paradite.

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
10 z. Byrnes. Mbaruam për sot, do të shihemi nesër. Nuk po ju  
11 premtoj kur.

12 Keni ndonjë kundërshtim të fillojmë në orën 10.00 nesër?

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Oh, shkëlqyer atëherë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Je shumë --  
15 ishe shumë bindës në atë kërkesën tënde.

16 Mirë z. Byrnes, shihemi në orën 10.00.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Gruaja ime -- gruas do t'i bëhet  
18 kur të dëgjojë kur unë kam aftësi bindëse.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
20 Mos harroni që nuk duhet të flisni me askënd jashtë sallës së  
21 gjyqit për dëshminë. Mund të largoheni tani.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nesër  
25 fillojmë në orën 10.00.

1 --- Seanca mbyllet në orën 16.32

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25